

Rrugat e Arbërit



www.rrugearberit.com

GAZETË E PAVARUR. NR. 12 (116). DHJETOR 2015. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

AKTUALITET

Bulqiza, vendi ku bashkëjetojnë skamja dhe luksi

NGA EDISON BALLA - FAQE 4

REPORTAZH

"Dibër moj, ku u lind Stërmilli"

NGA MEVLUD BUCI - FAQE 7

HISTORI

Udhëtimi i Mjedës në vendlindjen e Pjetër Budit

NGA HAMDË HYSUKA - FAQE 14

RECENSION

Ballanca, shkrimtari brilant i krahasueshëm vetëm me vetveten

NGA MEXHIT PRENÇI - FAQE 11

2015: Deklaratat për Rrugën e Arbrit



Nga nënshkrimi i memorandumit deri te finalizimi i marrëveshjes; nga deklaratat për tenderin në shkurt 2015 deri te vështirësitë e negocimit. Premtimet në fushatën për zgjedhjet vendore, ligji i miratuar, vështirësitë e negocimit me kompaninë kineze. Të gjitha deklaratat në lidhje me këtë çështje nga kryeministri Edi Rama, kryetari i Parlamentit Ilir Meta dhe ministrat Edmond Haxhinasto, Shkëlqim Cani dhe Arben Ahmetaj

FAQE 2-3

profil

Haxhi Myftari, bletërritësi më i mirë në Shqipëri



Vitin e kaluar, ku shumë bletërritës gati dështuan, Haxhiu ia doli mbanë pa asnjë problem. Parku i tij me 400 koshere rrezaton forcë, bukur, prodhim dhe besim për të ardhmen. Tek e shihja atë mes koshereve të parkut, më ngjante me një gjeneral që drejton ushtrinë në mënyrë perfekte. Dhe jo pak, por 400 koshere për nga 70 mijë bletë secila (në verë), 28 milion bletë, si ushtarë që marrin urdhra prej tij e punojnë për të. Ai kalon i qetë në rreshtat e koshereve. Mizëri tufa blete i kalojnë pa e prekur. Me instiktin që vetë Zoti ua ka dhënë ato e njohin prijësin e tyre.

NGA OSMAN XHILI - FAQE 5

etnografi

Veshja e krahinës së Sofraçanit dhe Grykës së Madhe

Veshja ruan karakterin kombëtar të një populli, por ka ndryshime të pjesshme nga një krahinë në tjetrën dhe në kohë të ndryshme. Veshja ndryshon nga meshkujt te femrat, ndryshon sipas moshave si dhe ka pësuar ndryshime në periudha kohe të ndryshme. Burrat fillimisht vishnin fustane me pala, këmisha me mëngë të gjata të punuara me fije leshi në rashbuej. (Krahina jonë rashbuajt i quan vegjë). Ky lloj stofi quhej qashë dhe punohej nga leshi i deles. Veshja për burra dhe për gra ndahet në veshje të brendshme dhe të jashtme. Për burrat, në veshje të brendshme bëjnë pjesë këmisha dhe të mbathurat. Këto fillimisht punoheshin prej leshi, më vonë filluan të punoheshin prej fije pambuku, pëlhurë e bardhë. Këmisha kishte një rreth të ngushtë, që rrethonte qafën.

NGA XHELAL ROÇI - FAQE 20-21

10 sportistët më të mirë për vitin 2015

Bashkia e Dibrës dhe Sport Klub "Korabi" nderojnë kontributorët. Premtojnë mbështetje për futbollin

FAQE 12-13



KNAUF

Bashkëpunon me komunitetin

www.knauf.al

Edi Rama, 12 qershor 2013: “Ky është një projekt kombëtar, është një projekt shumë i rëndësishëm jo vetëm për ju, por është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë. Është një projekt që nuk garanton thjesht lëvizjen, nuk shkurton lëvizjen thjesht, po garanton një zhvillim për një territor të tërë që tani është jashtë hapësirës së zhvillimit dhe është një projekt që për ne hyn te projektet strategjike që ne do ta çojmë përpara me shumë vullnet”.



Gazetë e pavarur.
Nr. 12 (116). 1 - 31 Dhjetor 2015

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës. Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më datë 20 të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRIJTE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:

Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:

Sashenka NDREKA
Hysen LIKDISHA
Abdurahim ASHIKU

Kontribuan për këtë numër:

Osman XHILI
Edison BALLA
Mevlud BUCI
Hamdi HYSUKA
Mexhit PRENÇI
Xhelal ROÇI
Selman MEZIU
Zabit LLESHI
Mehdi DEMA
Sakip CAMI
Fatmir ZHUZHI
Melsi Tafa
Ahmet KAMBERI
Ilmi DERVISHI
Aqif ADEMI
Hasan PASHA
Renato TOTRAKU

Fotoreporter: Fehmi Lleshi

Arkivi i gazetës është ME pagesë në faqen e internetit www.rrugearberit.com.

Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.

Paftimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.

Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:

Raiffeisen Bank
Rrugë e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:

Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603

E-mail: rrugearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Nga **BUJAR KAROSHI**

2015, VITI I PREMTIMEVE

Një vit më parë, kryeministri Edi Rama njoftonte përmes rrjeteve sociale nga Beogradi, ku merrte pjesë në Samitin ekonomik mes Kinës dhe vendeve të Evropës Juglindore, se: “U nënshkrua memorandum i bashkëpunimit me Chinese Exim Bank për hapjen e një kantieri projektesh në Shqipëri me financime kineze. Projekti i parë që do të çelë siparin e një epoke të re bashkëpunimi mes Shqipërisë e Kinës do të jetë Rrugë e Arbërit, e cila do të nisë vitin e ardhshëm”. Por që prej atëherë, ndërsa pritej muaj pas muaj të nisnin punimet, asgjë nuk ka ndodhur, përveç deklaratave kontradiktore të muaj pas muajshme nga ministrat e qeverisë, kryesisht të atij të Ekonomisë dhe Transportit.

Gjatë këtij viti lajmet për Rrugën e Arbrit kanë qenë të vazhdueshme në median qendrore dhe lokale, por pavarësisht optimizmit të herëpashershëm, sidomos pas miratimit të ligjit të posaçëm më 16 prill 2015, asgjë nuk ka ndodhur në terren. Ndërsa premtimeve se ky proces do të jetë transparent për publikun kanë qenë një dështim i plotë. Që prej miratimit të ligjit, gjithçka në këtë drejtim ka rezultuar me mungesë informacioni dhe me një padëshirë të madhe për të dhënë hollësi rreth procesit.

Premtimet e dhjetorit të 2014-ës të Kryeministrit Rama dhe Ministrit Haxhinasto kanë rezultuar një premtim i parealizuar. Ndërsa deklarata e Ministrit Ahmetaj se një tender për këtë proces do të zhvillohet në shkurt ishte një gënjeshtëri me këmbë të shkurtra.

Në muajin prill Parlamenti Shqiptar u investua në një ligj të posaçëm për këtë çështje, me anë të të cilit synonte të shkurtojte procedurat për një fillim sa më të shpejtë të punimeve, por edhe kjo nuk bëri të mundur që puna të niste brenda vitit. Sipas ligjit, brenda dhjetorit ky proces duhej të kishte përfunduar, por të paktën publikisht nuk ka asnjë informacion. Burime të gazetës muaj pas muaji kanë deklaruar se bisedimet nuk po ecnin mirë. Kjo në fillim kishte të bënte me mungesën e një projekti final, por më pas u përkthye në rritje të koston financiare, ndryshe se çfarë ishte deklaruar më parë.

“Për këtë segment 28.7 miliardë është vlerë e projektit e përllogaritur nga ARRSH, ndërkohë që kompania kineze ka paraqitur një vlerë rreth 25% më të ulët”, do të deklaronte Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës Edmond Haxhinasto në Komisionin e Ekonomisë dy ditë para miratimit të ligjit më 16 prill 2015. Por tani, në fund të vitit, Ministri nuk preferon të japë shifra, pasi duket se ato dukshëm janë të ndryshme nga çfarë është thënë në fillim të 2015-ës. Ai deklaroi se “pavarësisht përpjekjeve tona për të arritur një konkluzion dhe një marrëveshje koncesionare me një ofertë që kemi nga një kompani kineze, kur të konkludojmë siç duhet në shifra në vlera për financimin e kësaj rruge do të vijmë këtu dhe do të themi e kemi konkluduar”.

Gjatë muajve të fundit të vitit është folur edhe për një tërheqje të Exim Bank nga financimi, por qeveria nuk e ka pohuar, por as nuk e ka kundërshtuar këtë informacion. Përkundrazi, gjatë muajit nëntor, Kryeministri Rama dhe homologu i tij kinez kanë biseduar sërish për këtë çështje.

“Një tjetër moment i bashkëbisedimit ishte finalizimi i negociatave për të filluar punimet në Rrugën e Arbërit”, shkruante në njoftimin për shtyp zyra e Kryeministrit shqiptar.

Në prill, Ministri i Transporteve kishte deklaruar se “Fillimi i punimeve në Rrugën e Arbërit, pritet të jetë në 2016-ën dhe parashikohet të përfundojë brenda 3 viteve”. Kjo deklaratë atëherë u prit me pesimizëm, por tani kur viti ka ikur, në qoftë se do të rezultojë i vërtetë, do të jetë një lajm i mirë. Ndryshe do të regjistrohet si gënjeshtër më e gjatë e vitit.

Por gjatë këtij viti nuk kanë munguar edhe premtimet me lugën bosh, madje edhe skenat groteske me vepra imagjinare nuk kanë munguar. Një ish kryetar bashkie i thurte hosana Kryeministrit gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet vendore. “Doja ta falënderoja Kryeministrin Rama së bashku me ministrat e tij për mbajtjen e të gjitha premtimeve të bëra

Premtimet e dhjetorit të 2014-ës të Kryeministrit Rama dhe Ministrit Haxhinasto kanë rezultuar një premtim i parealizuar. Ndërsa deklarata e Ministrit Ahmetaj se një tender për këtë proces do të zhvillohet në shkurt ishte një gënjeshtër me këmbë të shkurtra.

Në prill, Ministri i Transporteve kishte deklaruar se “Fillimi i punimeve në Rrugën e Arbërit, pritet të jetë në 2016-ën dhe parashikohet të përfundojë brenda 3 viteve”. Kjo deklaratë atëherë u prit me pesimizëm, por tani kur viti ka ikur, në qoftë se do të rezultojë i vërtetë, do të jetë një lajm i mirë. Ndryshe do të regjistrohet si gënjeshtër më e gjatë e vitit.

Në prill, Ministri i Transporteve kishte deklaruar se “Fillimi i punimeve në Rrugën e Arbërit, pritet të jetë në 2016-ën dhe parashikohet të përfundojë brenda 3 viteve”. Kjo deklaratë atëherë u prit me pesimizëm, por tani kur viti ka ikur, në qoftë se do të rezultojë i vërtetë, do të jetë një lajm i mirë. Ndryshe do të regjistrohet si gënjeshtër më e gjatë e vitit.

në fushatën elektorale; Për uljen e moshës së pensionit; hapjen e thellësisë së pusit dhe premtimin më kryesor, ndërtimi i Rrugës së Arbrit. Kështu që, Kryeministrit, aktualisht, nuk kemi se çfarë i kërkojmë, përderisa të gjitha premtimet e bëra në fushatë i ka mbajtur në një kohë rekord...”.

Në fakt, tani është koha t’ia kërkojmë përditë Kryeministrit dhe qeverisë së tij premtimin. Jo vetëm se është një premtim për qarkun e Dibërës, por se është edhe një aks i rëndësishëm rrugor, siç ka thënë edhe vetë gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2013.

“Ky është një projekt kombëtar, është një projekt shumë i rëndësishëm jo vetëm për ju, por është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë. Është një projekt që nuk garanton thjesht lëvizjen, nuk shkurton lëvizjen thjesht, po garanton një zhvillim për një territor të tërë që tani është jashtë hapësirës së zhvillimit dhe është një projekt që për ne hyn te projektet strategjike që ne do ta çojmë përpara me shumë vullnet”.

2015: DEKLARATAT MBI RRUGËN E ARBËRIT NGA POLITIKANË DHE QEVERTARË

Edmond Haxhinasto, 6 Dhjetor 2014: “Jemi në fazën përmbyllëse të negociatave për një marrëveshje koncesionare për realizimin e segmentit kryesor të Rrugës së Arbërit.”

Edi Rama, 16 dhjetor 2014: “U nënshkrua memorandum i bashkëpunimit me Chinese Exim Bank për hapjen e një kantieri projektesh në Shqipëri me financime kineze. Projekti i parë që do të çelë siparin e një epoke të re bashkëpunimi mes Shqipërisë e Kinës do të jetë Rrugë e Arbërit, e cila do të nisë vitin e ardhshëm”.

Edmond Haxhinasto, 15 dhjetor 2014. “Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit me Chinese Exim Bank për hapjen e disa projekteve në Shqipëri me financime kineze. Projekti i parë i këtij bashkëpunimi mes Shqipërisë e Kinës do të jetë Rrugë e Arbërit, i cili do të nisë vitin e ardhshëm”.

Arben Ahmetaj: 6 Janar 2015: Në fushën e transporteve risi është ndërfaqja e koncesioneve për ndërtim, mirëmbajtje, operimi i akteve kryesore rrugore me qëllim përmirësimin e sigurisë rrugore. Dua të përmend dy projekte që janë tashmë duke u përpunuar si kontraktime publik-privat; një është ndërtimi i segmentit të rrugës së Arbrit, që besoj do të jetë risi e fund dimrit, pra besoj në fund të shkurtit do të jetë në tenderim...”

Edmond Haxhinasto, ATSH, 29 Janar 2015: Kompania kineze China State Construction engrg.corp.ltd do të ndërtojë Rrugën e Arbërit. Kjo u bë e ditur për ATSH-në nga burime nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës. Një ditë më parë, vet ministri i Transportit, Edmond Haxhinasto, tha se punimet për ndërtimin e rrugës së Arbërit, konsideruar si rruga e dytë e rëndësishme në vend pas Rrugës së Kombit, do të nisnin brenda muajit prill. “Besoj se brenda muajit prill do miratojmë ligjin përkatës për akordimin e kontratës së Rrugës së Arbërit kompanisë kineze, e cila paraqiti ofertën”, tha ministri. Ende nuk janë bërë publike detaje të ofertës së paraqitur nga kompania kineze China State Construction.”

Edmond Haxhinasto, 20 mars 2015: “Kemi dërguar një pr/ligj në parlament për tu miratuar. Pr/ligji do të jetë i veçantë duke qenë se kompania kineze i ka mundësitë financiare”

Edmond Haxhinasto, 14 prill 2015: “Për këtë segment kjo vlerë që unë ju thashë sot, 28.7 miliard, është vlerë e projektit e përllogaritur nga ARRSH, ndërkohë që kompania kineze ka paraqitur një vlerë rreth 25% më të ulët”.

Edmond Haxhinasto: 14 prill 2015: Kjo rrugë nuk parashikon taksim. Rrugë e Arbërit është një nga projektet e parashikuara nga qeveria aktuale. Fillimi i punimeve në Rrugën e Arbërit, pritet të jetë në 2016-ën dhe parashikohet të përfundojë brenda 3 viteve.”

Arben Ahmetaj, 16 Prill 2015: “Do të duhet të theksohet këtu se projekti që kompania kineze ka sjellë, është një projekt i cili do të negociohet. Ajo që ne sjellim këtu është kërkesa për të filluar një procedurë të veçantë, për shkak të natyrës së veçantë të financimit, në formën e partneriteti publik privat, për 27 kilometra patjetër super të vështirë nga ana teknike dhe gjeografike. Sa do të jetë kostoja? Sa transparente do të jetë? Besoj se ky Parlament dhe institucionet e tjera kanë mundësi ta ndjekin gjatë procedurës së negociatës.... Nga ana financiare dhe nga ana teknike është një projekt që patjetër jo vetëm duhet mbështetur dhe promovuar por, për mendimin tim, do të duhet të shtyhet më tej për të kapur patjetër kufirin me Maqedoninë”.

Edmond Haxhinasto, 16 Prill 2015: “Po diskutojmë këtu sot miratimin e procedurës së veçantë të Rrugës e Arbërit, vepër e cila ka filluar në vitin 2007 dhe sot jemi në realizimin 50% të kësaj rruge, ndaj mbetet një angazhim i yni për ta realizuar këtë segment të rëndësishëm të rrjetit tonë rrugor... Absolutisht do të jetë një proces plotësisht transparent, prandaj po sjellim këtë ligj në Parlament dhe po kështu do jetë dhe procesi i diskutimit të termave final të kontratës, të cilat do të sillen në parlament për tu miratuar. Por mund të them se transparencën në Shqipëri edhe duhet të konfirmohet dhe fakti është që e kemi nisur me transparencë të madhe, pasi planifikimi nga propozimi që na ka ardhur është si vlerë për kilometër shumë më e ulët se ajo që është aplikuar deri më sot, besoj nuk është e dhënë e pakët... E përsëris, se kosto është më e ulët se ajo që është realizuar deri më sot për këtë vepër konkrete... Taksimi i kësaj rruge potencialisht do të vijë vetëm si rezultat i konkluzioneve të Strategjisë së Taksimit të Rrugëve kur të përfundojë studimi. Pra nuk është e vërtetë që ne kemi parashikuar një taksë për këtë rrugë, për ta ndërtuar këtë rrugë me taksat e qytetarëve.”

16 Prill 2015: Miratohet ligji nr. 41/2015 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës koncesionare/ppp, me objekt ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Rrugës së Arbrit, ndërmjet shtetit shqiptar dhe shoqërisë “China State Construction Company”

Arben Ahmetaj: 23 Maj 2015: “Tek infrastruktura, mos harroni që në bazë të ligjit të ri të koncesioneve, ju keni mundësi të vini të ndërtoni me risk totalisht të mbuluar koncesione për të ndërtuar rrugë apo segmente autostradash. Rasti i kompanisë kineze, konsorciumit kinez që ka marrë Rrugën e Arbrit, është një rast spektakolar. Ne kemi ndërtuar një formulë shumë të thjeshtë, një formulë fituese që është

EDI RAMA, 27 nëntor 2015: "...finalizimin sa më parë të negociatave financiare për të nisur punimet në Rrugën e Arbrit..." EDMOND HAXHINASTO, 7 dhjetor 2015: ...Një deputet tha që nuk është hedhur asnjë qindarkë, por janë 15 milion dollarë që janë hedhur në 2 vite në Rrugën e Arbrit. 75 milion që nga fillimi i saj, dhe akoma kemi një segment 27 kilometra, të papërfunduar..."

2015: Deklaratat për Rrugën e Arbrit


Nga nënshkrimi i memorandumit deri te finalizimi i marrëveshjes; nga deklaratat për tenderin në shkurt 2015 deri të vështirësitë e negocimit. Premtimet në fushatën për zgjedhjet vendore, ligji i miratuar, vështirësitë e negocimit me kompaninë kineze. Të gjitha deklaratat në lidhje me këtë çështje nga kryeministri Edi Rama, kryetari i parlamentit Ilir Meta dhe ministrat Edmond Haxhinasto, Shkëlqim Cani dhe Arben Ahmetaj

DEKLARATAT NE FOTO


RRUGA E ARBITRIT FRUTI I PARË I NJË EPOKE TË RE

Frutuar para një viti që

U nënshkrua mbrehtë memorandumit i bashkëpunimit me Chinese Exim Bank për hapjen e një kantieri projektesh në Shqipëri me financime kineze. Projekti i parë që do të çelë siparin e një epoke të re bashkëpunimi mes Shqipërisë e Kinës do të jetë Rrugja e Arbrit, e cila do të nisë vitin e ardhshëm.



Mesazhi Transportit dhe Infrastruktura Edmond Haxhinasto inspekti cilën e adresoi nga reperi në ndërtim, në zonën e ndërimit të vendit, bashkë me grupin...



Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit me Chinese Exim Bank për hapjen e disa projekteve të Shqipërisë me financime kineze. Përfaqësuesit bashkëpunues të Shqipërisë dhe Kinës në Rrugën e Arbrit. U nënshkrua memorandumit të bashkëpunimit...

PARTNERITETI ME KINËN NË RRUGËN E PROJEKTEVE KONKRETE

Dje në Paris, gjatë takimit me Presidentin Xi Jinping dhe me Kryeministrin Li Keqiang, Takimi me Presidentin për të Dëgjuar vizione të t'j shfaqur për ndërtimin me Kinën, 15 vendeve të Europës Qendrore e Lindore dhe Bashkimit Europian si i t'ri, si edhe për t'përfundimin e mëtejshëm të ekspeditës të projektit për rrugën e Arbrit. Takimi me kryeministrin për të diskutuar shtetërisht e projektet e bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Kinës, siç është edhe përfundimi i negociatave financiare për të nisur punimet në Rrugën e Arbrit, përfundim i madh i bashkëpunimit për Parisin Industrial në Zonën e Ekonomisë të Durrësit, ku prezantohet...



Shkëlqim Cani, kryeministri i Shqipërisë, me kryeministrin Li Keqiang të Kinës në Parisin Industrial në Zonën e Ekonomisë të Durrësit, ku prezantohet...

Tuneli i parë rrugës së Arbrit, që është financuar në këto 18 muaj, tashmë i përfunduar dhe ku po punohet... sistemin e ndërtimit: rëndësia urbane e hapësirave publike të qytetit janë investime, të cilat, sipas kryeministrit, do të çelë siparin e një epoke të re bashkëpunimi mes Shqipërisë e Kinës do të jetë Rrugja e Arbrit, e cila do të nisë vitin e ardhshëm.

...është ndërfaqja e koncesioneve për ndërtim, mirëmbajtje, operim i akteve të kontraktimit publik-privat; një është ndërtimi i segmentit të rrugës së Arbrit, që besoj do të jetë nisur e fundimit, pra besoj në fund të shkurtit do të jetë në tenderim dhe projekti tjetër është ai i mirëmbajtjes së rrugës Durrës-Morinë. Ka një sërë rrugësh të reja të cilat do të konsiderohen dhe do të hidhen në treg për një kontraktim publik-privat.

"win-win" për shtetin shqiptar, për qytetarët shqiptarë, por edhe për kompanitë".¹² Shkëlqim Cani, Bulqizë, 8 Qershor 2015: Nga vjeshtë fillon rruga e Arbrit me tunelin e dytë, shumë më i gjatë se ky dhe me urën e Vashës që është shumë e lartë dhe një nga veprat e rralla në Shqipëri. Ky është premtimi kryesor që ne kemi dhënë për gjithë qarun e Dibrës.¹³ Edi Rama, Bulqizë, 8 Qershor 2015: "...me këtë tunel jepet edhe mesazhi shumë i qartë për gjithë Dibrën, që rruga e Arbrit nuk është

më një fantazmë elektorale që shfaqet vetëm nëpër fushata, por është një realitet mbi të cilin ne po punojmë fort. Kemi siguruar edhe financimin për pjesën më të vështirë, me një kompani ndër më të mëdhatë e Kinës.¹⁴ Ilir Meta, Bulqizë, 13 qershor 2015. "Ne kemi treguar se nuk bëjmë rrugë dhe nuk hapim rrugë thjeshtë për fushata elektorale dhe nuk i lëmë rrugët, rrugëve. Në vjeshtë fillon dhe do të përfundojë Rrugja e Arbrit, ajo që do ta lidhë Bulqizën me Tiranën për 40 minuta në mënyrën më komode, duke i dhënë

fund izolimit historik të gjithë kësaj treve të jashtëzakonshme".¹⁵ Shkëlqim Cani, 9 Korrik 2015: (duke folur për ligjin e konsencionit ne dogana) ...Ne kemi llogaritur vetëm 5% rritje në vit. Diferenca është për kursim; Kursimi është sa për t'u ndërtuar "Rrugja e Arbrit"! Jo 100 milionë, por është e sigurt se do t'u kursejmë shqiptarëve edhe 400 milionë euro!¹⁶ Arben Ahmetaj, 16 Korrik 2015: Po u marr shembull rrugën e Arbrit. E kishim dot rrugën e Arbrit me ato resurse financiare? Nuk e

kishim dot. Atëherë çfarë do ti thuhej popullit të Dibrës? Ne nuk kemi para, ti gjej rrugë e kalo në rrugë. Jo. Atëherë hyn në një invencion me koncesionarin e mundur, i cili është një kompani kineze që financon. Financon dhe ta sjell rrugën për tre vjet dhe ti e paguan për 15 apo 20 vite. Çfarë është ky? Ky është një partneritet publik privat i shëndetshëm. Ky është invencion ky është partneritet, që sjell një shërbim nga kalendat greke, ja sjell sot qytetarit. Kjo është detyrë e qeverisë dhe kjo është përgjegjshmëri kur bëjmë debat për koncesionet.¹⁷ Edmond Haxhinasto: 4 Shtator 2015: "Jemi në një komunikim të vazhdueshëm me kompaninë kineze që ka marr zyrarisht kontributin tonë në informacion dhe studime. Kompania Kineze është duke përgatitur ofertën përfundimtare që do të negociohet brenda 60 ditëve siç e kërkon ligji. Ne jemi në pritje. Brenda shtatorit ajo duhet të vijë dhe pastaj janë edhe 60 ditë të tjera negociimi". (Intervista e Ministrat Haxhinasto për gazetaren Ilva Tare)¹⁸ Edmond Haxhinasto, 3 nëntor 2015: "Siç e dini, për sa i takon Rrugës së Arbrit, është bërë një ligj i cili ka përcaktuar një procedurë të veçantë për trajtimin e kësaj vepre. Grupi i punës është ngritur që para dy muajsh. Ka pritur dhe konsulencën ndërkombëtare të domosdoshme, për këto lloj kontratash, për kompleksitetin dhe rëndësinë që ato kanë. Besoj që me përfundimin e procesit të përzgjedhjes së Konsulencës, që u bë para pak ditësh, grupi i punës do të rizgjodhet për të vlerësuar edhe ai me transparencë të plotë dhe gjithashtu nëse kjo ofertë e kompanisë kineze ka interes publik. Me të përfunduar vlerësimin grupi i punës, edhe atë vlerësim do t'juja vëmë në dispozicion që ta studioni, ta shikoni, gërmë më gërmë."¹⁹ Arben Ahmetaj: 27 Nëntor 2015: Rrugja e Arbrit është në negociatë akoma. Negociata është në nivel të avancuar. Ka debate teknike shumë të rëndësishme dhe mund të them që po vazhdon diskutimi në nivel teknik për rrugën e Arbrit.²⁰ Edmond Haxhinasto, 2 dhjetor 2015: Për rrugën e Arbrit mund t'ju them që "po" edhe ky është një projekt i cili ka pikëpyetjet e veta shumë të rëndësishme. Pavarësisht përpjekjeve tona për të arritur një konkluzion dhe një marrëveshje koncesionare me një ofertë që kemi nga një kompani kineze, kur të konkludojmë së duhet në shifra në vlera për financimin e kësaj rruge do të vijmë këtu dhe do të themi e kemi konkluduar.²¹ Edmond Haxhinasto, 7 dhjetor 2015: Një shembull tjetër që dua të ndalem, është Rrugja e Arbrit. Një deputet tha që nuk është hedhur asnjë qindarkë, por janë 15 milion dollarë që janë hedhur në 2 vite në Rrugën e Arbrit. 75 milion që nga fillimi i saj, dhe akoma kemi një segment 27 kilometra, të papërfunduar. Sepse kushton shumë ky segment sa gjithë rrugët e tjera, rreth 200 milion dollarë, dhe për këtë po negociojmë me kinezët! (Fjala e Ministrat Haxhinasto në Parlament për Buxhetin 2016)²² Edi Rama, 27 nëntor 2015: "...finalizimin sa më parë të negociatave financiare për të nisur punimet në Rrugën e Arbrit..."²³

BURIME
1 <http://www.transporti.gov.al/al/newsroom/lajme/ministri-haxhinasto-inspektive-ne-uren-e-matit-burrel-dhe-tunelin-e-qafebullit-bulqize>
2 <https://www.facebook.com/media/set/?set=a.10152596110271523.1073742454.138734771522&type=3>
3 <http://www.transporti.gov.al/al/multimedia/foto-galeri/nenshkrimi-i-memorandumit-te-bashkepunimit-me-chinese-exim-bank-per-hapjen-e-disa-projekteve-ne-shqiperi-me-financime-kineze-dote-jete-rruga-e-arbrit-i-cili-do-te-nise-vitin-e-ardhshem>
4 <http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/partneriteti-publik-privat-risja-e-vitit-2015-idete-e-biznesit-nje-ndihmese-madhe-per-pemiresimin-e-procesit>
5 <http://www.ata.gov.al/china-state-construction-engrg-corp-ltd-do-te-ndertoje-rrugen-e-arbrit-216747.html>
6 <http://www.oranews.tv/vendi/shqiperia-e-bullgaria-duan-korri-dorin-e-8-haxhinasto-kinezet-kane-fondet-per-rrugen-e-arbrit/>

7 <http://www.oranews.tv/vendi/rruga-e-arbit-pd-jo-dhënies-me-koncesion-me-procedure-te-vecante/>
8 <http://www.transporti.gov.al/al/newsroom/lajme/ministri-haxhinasto-ne-komisionet-e-kuvendit-per-projektligjin-e-posacem-per-dhënien-me-koncesion-te-ndertimit-te-rruges-arberit>
9 <http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/rruga-e-arbit-ministri-ahmetaj-me-kosto-me-te-ulet-se-ne-2007-afon-trevat-shqiptare-mes-tyre-dhe-me-rajonin>
10 <http://www.transporti.gov.al/al/newsroom/fjalime/haxhinasto-procesit-per-rruga-e-arbit-plotesisht-transparent-veprat-e-rendises-kombetare-te-mos-politizohen>
11 <http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/ligje/ligj-nr-41-2015-per-percaktimin-e-procedure-se-vecante-per-negocimin-dhe-lidhjen-e-kontrates-koncesionare-ppp-me-objekt-ndertimin-operimin-mirembajtjen-dhe-menaxhimin-e-rruges-arbit-ndermjet-shtetit-shqiptar-dhe-shoqerise-china-state-construction-company>

12 <http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/ministri-ahmetaj-me-bizneset-shqiptare-te-diaspores-eshte-koha-te-investoni-ne-shqiperi>
13 <http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/bulqiza-poshkon-ne-drejtimitin-e-duhur>
14 <http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/bulqiza-poshkon-ne-drejtimitin-e-duhur>
15 <http://www.ata.gov.al/meta-ne-bulqize-ne-vjeshte-fillon-dhe-do-te-perfundoje-rruga-e-arbit-276838.html>
16 <http://www.financa.gov.al/al/njoftime/fjalime/cani-jo-100-milione-por-eshte-e-sigurt-se-do-tu-kursejme-shqiptarëve-edhe-400-milione-euro>
17 <http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/fund-ndertimin-operimin-mirembajtjen-dhe-menaxhimin-e-rruges-arbit-ndermjet-shtetit-shqiptar-dhe-shoqerise-china-state-construction-company>

18 <http://www.transporti.gov.al/al/newsroom/intervista/intervista-e-ministrat-haxhinasto-per-gazetaren-ilva-tare>
19 <http://www.transporti.gov.al/al/newsroom/inspektimi-ministrat-transportit-dhe-infrastruktura-z-edmond-haxhinasto-ne-drejtorene-rajonale-te-sherbimeve-te-transportit-tirane>
20 <http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/shpenzimet-kapitale-te-projektbuxhetit-2016-ministri-ahmetaj-ne-komisionin-parlamentar-te-ekonomise>
21 <http://www.oranews.tv/vendi/rruga-e-arbit-haxhinasto-rezon-deklarata-e-rames/>
22 <http://www.transporti.gov.al/al/newsroom/lajme/fjala-e-ministrat-haxhinasto-ne-parlament-per-buxhetin-2016>
23 <https://www.facebook.com/media/set/?set=a.1015337540166523.1073742874.138734771522&type=3>

Në Bulqizë sot të pasurit po bëhen çdo ditë e më shumë të pasur, ndërsa të varfërit po zgjerojnë çdo ditë e më shumë "ngrehinën e skamjes ekonomike".

Bulqiza, vendi ku bashkëjetojnë skamja dhe luksi

Nga EDISON BALLA

Bulqiza, e njohur ndryshe si "qyteti i minatorëve" është sot, pa më të voglin dyshim, qyteza më e pasur në Republikën e Shqipërisë. Duke u bazuar në treguesin e GDP-së (Produkti i përgjithshëm bruto), i cili mat të ardhurat totale të ekonomisë së një shteti, në bazë të statistikave të nxjerra nga agjensitë shtetërore ekonomike, llogaritet që në një vit të zakonshëm financiar sektori minerar realizon plot 20 % të GDP-së. Ne e dimë shumë mirë se ku është më shumë e përqendruar pasuria minerare, pra në minierën e Bulqizës. Paradoksi që të vret sytë dhe zemrën në këtë zonë mineral-mbajtëse është "pabarazia sociale" në shifra galopante, ku 5 % e popullsisë dominon dukshëm në pasuri dhe pushtet mbi asetin më të madh lokal dhe kombëtar, pra mbi mineralin e kromit.

Në Bulqizë sot të pasurit po bëhen çdo ditë e më shumë të pasur, ndërsa të varfërit po zgjerojnë çdo ditë e më shumë "ngrehinën e skamjes ekonomike". Për shumë persona që e njohin Bulqizën nga jashtë nëpërmjet medias, mendojnë se kjo është një "tokë e bekuar" duke u nisur nga sasia e madhe minerare që mbart kjo tokë. Unë mendoj ndryshe. Për mua kjo pasuri është bekim për të pasurit dhe mallkim për të varfërit... Të pasur që rrinë nëpër kafenet e shtrenjta të qytetit, të varfër që luftojnë me vdekjen për të nxjerrë kafshatën e gojës. Të pasur që lëvizin me makina të shtrenjta, të varfër që nuk i mbajnë as këmbët nga lodhja e skajshme. Të pasur që mendojnë se ku do ti investojnë milionat e ardhshëm që do nxjerrin nga galeritë dhe të varfër që mendojnë nëse e nesërmja do ti gjejë sërish gjallë apo jo. Ja pra për ju që nuk e dini kjo është Bulqiza, kjo është toka e të kamurve, kjo është toka ku jeta vlen sa një ditë se mbase ditën tjetër mund të ngelesh thjesht një kujtim në memorien e atyre që të duan.

Problemi është që në këtë "tokë të bekuar" të varfërit, mesa duken, janë të kënaqur me statusin dhe gjendjen e tyre. Ato madje janë aq të kënaqur sa që kur flet me to për të "padronët e kromit", thonë vetëm fjalë të mira, sepse për to, të "hash djersën" e dikujt dhe të shuash etjen me gjakun e punëtorëve qenka zotësi. Duke iu referuar cilësisë dhe sasisë së mineralit që nxirret nga galeritë e Bulqizës, rezultojnë që kjo minierë të renditet e para në Evropë dhe e treta në botë. Me një pasuri të tillë minerare, ajo që të bën përshtypje është gjendja haptazi jo logjike midis miliona tonë krom që kanë dalë nga Bulqiza e kthyer në miliona euro pasuri, dhe nga ana tjetër gjendja e keqe e jetesës së komunitetit.

Sipas raporteve të dala nga sektorët kundër krimin ekonomik pranë Policisë së Shtetit, të publi-



Ndryshe nga çfarë ndodh në vendet e tjera mineralmbajtëse, në vendet e zhvilluara ose në zhvillim siç jemi ne, në raste të ngjashme me ne, kur ka pasur keqadministruar të aseteve të tyre, ata janë ngritur në revolta, duke mbrojtur të drejtën e tyre dhe ndaluar shfrytëzimin barbar të pasurive...

kuar edhe në një artikull në gazetën e përditshme "Shekulli", bëhet me dije fakti që "të fortët" ose siç shumë i quajnë "padronët e kromit", kanë lidhje të ngushta me hallkat ligjzbatuese dhe insitucionet më të larta të shtetit, lidhje këto që i përdorin për të justifikuar milionat e nxjerra dhe për tregtimin në rrugë dhe me mënyra informale të kromit. A është kjo vallë kapja e institucioneve që veprojnë në kuadër të sektorit minerar? Edhe për sa kohë "të paudhët" do vazhdojnë të sundojnë mbi këtë sektor kaq potencial dhe jetik për ekonominë lokale dhe kombëtare? Ndryshe nga çfarë ndodh në vendet e tjera mineral-mbajtëse në vendet e zhvilluara ose në zhvillim siç jemi ne, në raste të ngjashme me ne, kur ka pasur keq-administruar të aseteve të tyre, ato janë ngritur në revolta duke mbrojtur të drejtën e tyre dhe ndaluar shfrytëzimin barbar të pasurive.

Por, në Bulqizë ndryshe nga shembujt e vendeve të tjera, ku banorët kanë sjellë "pran-

verën" për vendet e tyre, këtu mesa duket askush nuk do t'ia dijë për gjendjen në të cilën ndodhet komuniteti, ose të paktën këtë kanë lënë të kuptohet. Heshnja është pohim. Që nga viti 2001, vit në të cilin në Bulqizë iu dha leja e parë minerare një firme koncensionare italiane e njohur si DARFO, e deri më sot, pavarësisht kalvarit të gjatë të vuajtjeve dhe talljes me pasurinë publike, askush nuk e ka ngritur zërin për të dalë në mbrojtje të të drejtave të tyre legjitime dhe për ti dhënë fund sistemit barbar dhe bandidesk që është instaluar me rrënjë në Bulqizë. Në të tilla rrethana, ku heshnja ka përthithur çdo zë, ka mblyllur çdo gojë, ka pllakosur çdo buzëqeshje dhe ka demoralizuar çdo të ri, unë arrij të konceptoj dy arsye të forta që kanë sjellë këtë "heshnje të çeliktë": ose ne jemi komuniteti më i lumtur në botë dhe unë akoma se kam kuptuar ose ne i druhami më shumë pasojave që mund të vijnë nga ngritja e zërit në kërkim të së drejtës tonë sesa

humbjes së jetës në "skutat e galerisë".

Mos ndoshta fakti që të gjithë heshim përballë një mizorie të tillë moderne, nënkupton që ne jemi të gjithë të kënaqur? Ne nuk mund të jem kurrë të kënaqur, akoma më keq të lumtur përballë një situatë ku të rinjve u ka humbur perspektiva, fëmijëve u është vjedhur e ardhmja, familjeve që kanë humbur të dashurit e tyre u është tharë loti e shumë të tjerëve u është marrë edhe jeta.

Mos harroni, ato ishin dikur prindër, të tjerë ishin vëllezër për dikë tjetër e shumë të tjerë ishin bij të një familje që sot vajtojnë dhe fajësojnë kromin si fatkeqësinë e humbjes së djemve të tyre. Nga gjithë këto që kemi parë, dëgjuar e përjetuar akoma zgjedhin heshjen. Apo mos vallë temperaturat e ulëta te punës në minierë u kanë ftohur edhe zemrën?

Shumë mendojnë se nuk kemi kohë që të humbim me përpjekje që mund të rezultojnë të dështuara në këtë drejtim. Duke heshur dhe duke mos ngritur zërin për të drejtat e minatorëve, ne u japim të drejtë atyre që kanë "vjedhur" pasurinë dhe shpresën që të vazhdojnë ta bëjnë këtë edhe në të ardhmen. Por nëse ne nuk e ngremë zërin për minatorët e sotëm, ne duhet ta bëjmë këtë gjë për fëmijët e tyre...

Rrëshket masivi i kromit - humb jetën 27-vjeçari Renato Alimani



Renato Alimani, 25 vjeç, humbi jetën jashtë galerive të minierës së Bulqizës më 27 dhjetor 2015.

Alimani ishte një punëtor i ngarkim-shkarkimit të kromit, dhe vdekja, sipas deklaratës së kompanisë ACR ka ardhur si pasojë e pakujdesisë.

Policia po heton rastin dhe nuk ka dalë me një konkluzion paraprak.

Burime nga vendngjarja thonë se një rrëshkitje e masivit të kromit e ka zënë poshtë 25-vjeçarin Alimani. Ai punonte në transportin e jashtëm tek shkarkimi i kromit.

Bëj pajtimin tënd me



përmes emailit

<rrugaearbërit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:

Në Shqipëri: 600 lekë.

Në Europë: 10 Euro.

Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Haxhiu është shumë korrekt në punën me bletën. Ai e di se sa më të forta hallkat e këtij procesi aq më solid gjithë zinxhiri, aq më i mirë rezultati final.

Haxhi Myftari, bletërritësi më i mirë në të gjithë Shqipërinë

Nga OSMAN XHILI

Miqësinë me bletën Haxhi Myftari nga Maqellara e Dibrës e ka nisur që 40 vjet më parë. Bile ai vetëm e ka forcuar këtë miqësi, pasi gjyshi i tij Dalipi, ishte marrë me bletën thuajse vazhdimisht. Teknika e asaj kohe nuk dilte dot mbi ekzekutimin e bletëve të koshit primitiv për të marrë mjaltin.

Haxhiu dhe gjenerata e tij, e kuptonin se duhej ndryshuar njëherë e mirë kjo procedurë makabre. Nuk mund të shpërblehej kështu një krijesë aq e dashur tek Zoti dhe njerëzit, me një produkt aq me vlera, si mjalti.

"Zoti yt i dha instikt bletës: Ndërto shtëpi nëpër kodra, nëpër drunj dhe nëpër kulmet që ata i ndërtojnë. Nga barqet e tyre del lëng (mjalti), ngjyra e te cilit është e ndryshme dhe në të cilin ka shërim për njerëz!" (Kur'ani).

Haxhiu i ri nuk e dinte këtë ajet, por në mënyrë intuitive iu drejtua punës me bletën. Të gjitha ëndrrat dhe dëshirat e tij konvergonin në një pike, dhe djaloshi u nis drejt saj, pa u ndalur më.

Në fillim me koshat e tij, dhe pastaj me ato të pyjores, ai fiton eksperiencën, që duke u bashkuar me teorinë e librave që lexonte, do bëheshin armë e fuqishme drejt suksesit.

Atëherë ishte më lehtë, tregon Haxhiu. Pak koshere ne zonë, pak sëmundje, shumë mjaltë. Mban mend një vit të mbarë, kur verës, gati çdo ditë vesonte pak shi dhe në një koshere mori 70 kg mjaltë.

Tani pak më vështirë, por sidoqoftë, ai di të përshtatet. Vitin e kaluar, ku shumë bletërrites gati dështuan, Haxhiu ja doli mbanë, pa asnjë problem. Parku i tij me 400



Parku Haxhi Myftarit me 400 koshere rrezaton forcë, bukuri, prodhim dhe besim për të ardhmen.

Tek e shihja atë mes koshereve të parkut, më ngjante me një gjeneral që drejton ushtrinë, në mënyrë perfekte.

koshere rrezaton forcë, bukuri, prodhim dhe besim për të ardhmen. Tek e shihja atë mes koshereve të parkut, më ngjante me një gjeneral që drejton ushtrinë, në mënyrë perfekte. Dhe jo pak, por 400 koshere për nga 70 mijë bletë secila (në verë), 28 milion bletë, si ushtarë që marrin urdhra prej tij e punojnë për të.

Ai kalon i qetë në rreshtat e koshereve. Mizëri tufa blete i kalojnë pa e prekur. Me instiktin që vetë Zoti ua ka dhënë, ato e njohin prijësin e tyre. Atij i mjafton një shikim për të konstatuar cili kosh është me i fuqishëm, cili më i dobët, cili garanton me shumë e cili me pak, e atje ku nuk vëren shumë gjallëri, mban shënim për t'i hapur me pas.

Haxhiu është shumë korrekt në punën me bletën. Ai e di se sa më të forta hallkat e këtij procesi aq më solid gjithë zinxhiri, aq më i mirë rezultati final.

Kullota e pasur për bletën është për t'u marrë shumë në konsideratë. Vendi ku gjendet parku është vërtet i përsosur. Që në fillim të pranverës thanat e hershme me lulet e verdha, bëhen stacioni i parë pritës i bletëve. Ushqim e polen bashkë, duke i fuqizuar mjaft kosheret pak të lodhura nga

dimri. Më pas akacia. Haxhiu e vlerëson shumë këtë dru të dashur për bletën. Një dru i tillë i rritur mund të japë 12 kg mjaltë. Vitin e kaluar, bletërritësi mbolli 1000 rrënjë akacie tek zabeli i tij. Këtë vit mendon të mbjellë më shumë se aq. Sa vlera!?

Jo vetëm për bletën e mjaltin por dhe për ajrin, për erozionin, për rezerva drusore e mjedise tërheqëse. Një shembull vërtet për tu admiruar kur shumë njerëz po sakatojnë çdo ditë pyjet tona të mrekullueshme duke sfiduar ligjin e shtetit.

Haxhiu thotë se koshi i fuqishëm është çelësi i suksesit. Ndonëse i njeh shumë preparatet që përdoren tek bleta, shumë pak i praktikon. Në vjeshtë nuk i ka trajtuar për varratioze, pasi nuk kishte shenja të sëmundjes. Trajtimi i panevojshëm çorodit bletën dhe ul imunitetin e saj.

Hallkë tjetër e rëndësishme për të është puna me mbretëreshën. Jo më kot ajo ka një emër të tillë. Në një ditë pune ajo prodhon 1500-2500 vezë.

Ndaj ato duhet të jenë të reja, të fuqishme e pjellore. Çdo vit Haxhiu prodhon 150-200 mbretëresha që i fut në zgjoje sipas nevojave. Teknika të veçanta dhe një aparat special e bëjnë të mundur një gjë të tillë.

Këtë vit mund të prodhojë mbi 1 kg qumësht blete, aq i kushtueshëm në para dhe aq i vlefshëm në kurimin e sëmundjeve.

Haxhi Myftari është cilësuar si bletërritësi më i mirë në gjithë Shqipërinë. Sasia e koshereve dhe e mjaltit të prodhuar dëshmojnë një gjë të tillë.

Vitin e kaluar mori një çmim vlerësimi nga Ministria Bujqësisë. Ai prodhon afër 40 kv mjaltë. Ata që e kanë provuar njëherë mjaltin e tij, ua rekomandojnë atë shokëve e miqve. Në Tiranë, Durrës apo dhe në Itali ka shkuar mjalti i tij.

Shpesh merr pjesë në panairë apo simpoziume të ndryshme. Në Dibër, në Tiranë apo edhe në Maqedoni. Shkëmbejnë mes kolegësh eksperiencë e praktika pune. Haxhiu ka shumë për te treguar pasi ka akumuluar për një kohë të gjatë.

I them se ka dhe një borxh për të dhënë, zeqatin e mjaltit. Ai premtan se dhe këtë do ta bëjë në të ardhmen.

Pasioni i tij për bletën po ngjizet tek dy djemtë e tij, Denisi dhe Armandi, të cilët mendojnë ta çojnë më tej stafetën, që babai i tyre po u lë në dorë.



Haxhi Myftari është cilësuar si bletërritësi më i mirë në gjithë Shqipërinë. Sasia e koshereve dhe e mjaltit të prodhuar dëshmojnë një gjë të tillë. Vitin e kaluar mori një çmim vlerësimi nga Ministria Bujqësisë. Ai prodhon afër 40 kv mjaltë. Ata që e kanë provuar njëherë mjaltin e tij, ua rekomandojnë atë shokëve e miqve. Në Tiranë, Durrës apo dhe në Itali ka shkuar mjalti i tij.

Rrugat e Arbërit

aty ku fjalët nuk i merr era...



Bëj pajtimin tënd ose dhuro për gazetë me

përmes emailit
<rrugaearbërit@gmail.com>

Një kontribut vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Gazeta ofron faqet e saj për REKLAMA apo NJOFTIME të ndryshme për biznese dhe individë.
REKLAMA E PARË ËSHTË FALAS!



KREU PETICIONI AKTUALITET OPINION INTERVISTA KULTURE ARKIV KONTAKT NDIHMO EDHE TI

NUMRI I RI I GAZETES

Shpeshqorja e të nisë së parë ndërtimi i Rrugës së Arbërit

Merr versionin PDF ose kopjen print duke kontribuar vetëm me 50 lekë/muaj



Gazetën Rrugat e Arbërit mund ta gjeni edhe në internet në adresën www.rrugaearbërit.com, tashmë me disajn të ri. Faqja në web është kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rrugat e Arbërit" dhe lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër nga z. Agim Deva.

Kërkohen korrespondentë/menaxherë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Gazeta "Rrugat e Arbërit" kërkon korrespondentë dhe menaxherë zyrtarë për PESHKOPINË dhe DIBRËN E MADHE. Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të shkruajnë email në adresën rrugaearbërit@gmail.com ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Redaksia

Natyrë dhe njerëzit e Dibrës së Madhe janë si degët e një lisi. Ata kanë madhësinë e gjurmëve shekullore, kanë dritën e besatimit e të qëndresës, dritën e historisë.

“Dibër moj, ku u lind Stërmilli”

Nga MEVLUD BUCI

Etitulluam këtë shkrim me vargun e poetit të mirënjohur matjan, Basir Bushkashi. Në poezinë e këtij autori të titulluar “Dibër moj” botuar edhe në “Antologjinë e poezisë matjane” (f. 108), botuar nga poeti e studiuesi Hamdi Hysuka, Bushkashi bën pasqyrën e madhësisë e të fisnikërisë dibrane, sintezën e historisë, shpërfaq kabllot e kohërave, krenarinë dhe urimin për Dibrën.

Dikur për Dibrën shkrova një varg: / “Dibra e Madhe pikëllim nga larg”, / Tash Dibrës së Madhe i erdha në prag, / Në zemrat e njerëzve ndjej kaq fllad.

Vargje të cilat na japin jo vetëm emocion, por gdhendin frymëzimin poetik njerëzor e tepër human duke na pasqyruar thjeshtë të bukur lirizmin, dritën e shpirtit e të madhësisë...

Poeti Bushkashi, vazhdon himnin poetik:

Ndjej kaq fllad e ngrohtësi / Dhe vetja më duket më tepër njeri, / Na presin shokë, miq e poetë/ Dallgëzim i mallit na hedh përpjetë...

Frymëzimi, saktësimi i realitetit, përmallëzimi dhe shpirtbardhësia prej poeti human, bën që Basir Bushkashi, ta mbyllë këtë lirikë-filozofike me vargjet: Dhe qielli më ngjan më i dliër, / Se gjuha shqipe shtegton e lirë, /Dibër moj, ku u lind Stërmilli/ Të mbulofshin pranverat me lule prilli!

Nderim e krenari paç biri i Mallunxës së Matit, pendarti, liriku mjeshhtëror, fisniku i trevës së barutit Basir Bushkashi, vargje himn për Dibrën tonë, madhësi, vargje të cilat gdhend vetëm një pendë dhe një shpirt që ngjan me madhësinë e Dejës e të Koratës me bukuritë e Balgjajt e qëndresat e Stelushit e të Petralbës. Urime e penda dritë Basir Bushkashi!

SIKUR RRUGËTOJA ME HAKI SHAROFIN

Para sesa të përshkruaj vajtjen tonë në Dibër të Madhe kohët e fundit, desha të theksoj faktin sesi qysh nga Tirana e deri në Dibër sikur më shoqëroi i paharruari Haki Sharofi. Ky bir i shquar i trojeve të Stërmillit të Seid Nardjenit, Haxhi Vehbi Dibrës e Sherif Lëngut e deri tek i nderuari magjistër Rruzhdi Lata ka lënë gjurmë të paharruara prej atdhetari, historiani, dijetari, prej intelektualit të përkushtuar. Haki Sharofi na la si testament librin studimor e me shumë vlerë “Historia e Dibrës” (vëllimi I dhe II). “Historia e Dibrës” e Haki Sharofit, - shkruan midis të tjerave Prof. Dr. Hysni Myzyri – është komplekse. Aty përfshihen aspekte historike dhe etnografike, ekonomike e shoqërore, gjuhësore dhe administrative, fetare e kulturore dhe arrin deri të Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Autori e trajton Dibrën historikisht si sanxhak (prefekturë) në kohën e Perandorisë Osmane, me tri nënprefekturat e saj, të Rekës, të Dibrës së Poshtme (Peshkopisë) dhe të Matit, pavarësisht nga ndarja që u ka bërë atyre kufiri politik i vendosur nga Fuqitë e Mëdha më 1913 (f.4). Tek mbaj në duar librin e çmuar të Sharofit të paharruar mësojmë sesi autori ka mirëorganizuar librin në tri pjesë: 1) Lëvizjet e armatosura ose kryengritjet; 2) Lëvizjet politike; 3) Lëvizje të edukatës kombëtare e mësimi i



Gjatë prezantimit të librit kushtuar mësuesit Ismail Erebara në Dibër të Madhe.

gjuhës shqipe. Në libër pasqyrohet me qartësi e argumente sesi qeverisej Dibra në kohën e Turqisë, pleq më të përmendun për lashtësi, dhe 3 oxhaqet (Hysen Agolli, Kara Hasani dhe Xhil Aga) 7 teqet: e Peshkopisë, Dohoshishtit, Tominit, Brezhdanit, Borovjanit, Vranjtit dhe e Limjanit; 9 malet: Reçi, Dardha, Gryka e Muhurri, Luznia, Gryka e Vogël, Gryka e Madhe, Bulqiza dhe Katër Grykët (Selishta). Përshkrimi i Dibrës në kohën e Skënderbeut, kush ka qenë Skënderbeu, ç’thotë Gjon Muzaka, fortesat e Moisi Golemit, luftërat e Dibrës në kohën e Skënderbeut (si e pritën dibranët Skënderbeun), argumentet e Fan Nolit, zhvillimi i luftërave, qëndresa e më pas Dibra nën sundimin e turqve osmanli, ndërtimi i qytetit të Dibrës së Madhe, popullsia e qytetit, fiset para vitit 1912, kush ishin esnafët etj. Kur nisesh drejt Dibrës së Madhe s’ka sesi nuk të shoqëron e të përmallëzon edhe vepra e çmuar, testamenti i ndritur për brezat, “Historia e Dibrës” të cilën na e ka lënë atdhetari e dijetari Haki Sharofi.

MEXHIT CAPA I KA RRËNJËT NGA SHKREPAT E SELISHTËS SË KATËR-GRYKËVE

Pasi përfalemi me Mexhit Shaban Daçin së bashku me poetin e studiuesin Qazim Shehu e shkrimtarin Xhetan Strazimiri ulemi për pak minuta në lokal “Capa” në qendër të Dibrës së Madhe.

Kishim dëgjuar shumë për Mexhit Capën, pronarin e Ilixhave të Banishtit, njeriun e përkushtuar e human, organizatorin e nderuar, por vetëm sa këmbem pak fjalë në një telefonatë të përzemërt. Ai ndodhej përkohësisht në Shkup atë ditë. Pranë njerëzve me të cilët ai punonte mësuam shumë për provat e djersës e të atdhetarisë së Mexhit Capës. Ashtu sikurse shumë fise të Selishtës (Katër-Grykëve) edhe të parët e Mexhit Capës u vendosën në Dibër të Madhe. Me punë e shpirtbardhësi bëri emër, por kurrë s’e harron se ai burimin e ka nga shkrepat e Selishtës për të cilën epika historika shekullore thotë:

... Kjo Selishta gurë-kala /Luftë bakan burra e gra / I çon pasha për rixha: /Due udhë me kalue

/ Por rixhaja nuk iu shkue / Krajsën hutat t’u luftue... (populli)

Lum kush nuk i harron rrënjët, sepse vetëm kështu bleron gjithë jetën, kështu u ngjan lisave shekullore, të cilët kurrë nuk i përkulin fortunat. Mexhit Capa i Dibrës së Madhe ka në gen rrënjët prej shkrepave të Selishtës. Nderim paç Mexhi Capa!

DEFRIM METHASANI – FJALËDRITA...

Edhe fjala rrezaton, jep dritë. Drita e fjalës bën atë që thotë i madhi Dritëro “fjala gdhend gurin”. Fjala e Defrim Methasanit buron nga rrënjët e shpirtit të bardhë, nga urtësia e dashamirësia prej intelektualit, mësuesit të shquar e publicistit fjalëdritë. Para pak ditësh matematikani e studiuesi i talentuar i mësimdhënies së matematikës e mjeshhtëri i tregimeve alegorik Sabri Pira më tha: “Të lutem Mevlud, shkruaj pak radhë “Rrugës së Arbërit” për Shuaip Methasanin, sepse ai ka qenë kuadri që më ka dhënë dorën e ngrohtë në ditë të vështira”. Pasi e falënderova i thashë me dliëri: I shtrenjti Sabri, për Shuaipin nuk mbajnë peshën caqet e një shkrimi, por ai krahas drejtësisë e përkushtimit si intelektual ka rritur e edukuar fëmijë të vlefshëm e fjalëdritë. Këtë radhë do të gdhendin pak rreshta për të birin, Defrimin, i cili i ka gjurmët e përkushtimit në Sohodoll, Fushë-Çidhën, Lurë, Muhurr, Lurë e Katër-Grykë, si mësues e pedagog i shquar si veprimtar e organizator, por tashmë edhe gjurmë si publicist, si gazetar fjalëdritë. Ashtu sikurse i ati Shuaipi, i cili së bashku me Hajdar Gjapin, Qamil Ashikun, Dan Qamilin e të tjerë ecnin 5-6 orë në këmbë për një kafe të idhët, gjë e çmuar njerëzore kjo, që rrallë kush e ka, edhe Defrimi është i kudondodhur sot. Nga Jugu në Veri, në diasporë e gjetkë fjala e Defrim Methasanit rrezaton, ajo bleron fushave sportive, sallave të promovimit të vlerave kurdoherë gdhend, laton e përhap dritë. Edhe në Dibër të Madhe drejtoi mjeshhtërisht promovimin e librit “I përkushtuari”, të autorëve të mirënjohur Faik Xhani e Hatixhe Erebara kushtuar mësuesit Ismail Erebara. Intelektualë të tillë, siç

...Defrimi është i kudondodhur sot. Nga Jugu në Veri, në diasporë e gjetkë fjala e Defrim Methasanit rrezaton, ajo bleron fushave sportive, sallave të promovimit të vlerave kurdoherë gdhend, laton e përhap dritë. I thjeshtë si e vërteta, i dashur e i respektuar – Defrim Methasani – fjalëdrita...

thotë populli – kanë kulturë të leme e jo të bleme. Kulturë që buron nga geni i fisit në Sohodoll, nga përkushtimi në udhët e dijes, nga nderimi e dashuria për vlerat dibrane e mbarëkombëtare. I thjeshtë si e vërteta, i dashur e i respektuar – Defrim Methasani – fjalëdrita...

DRITË VLLAZËRIMI – DRITË HISTORIE...

Natyrë dhe njerëzit e Dibrës së Madhe janë vërtet sikurse degët e një lisi. Ata kanë madhësinë e gjurmëve shekullore, kanë dritën e besatimit e të qëndresës, dritën e historisë. Në sfond kurora e Kërçinit, e Velivarit, kurse në Verilindje Gryka e Radikës. Kanë ndryshuar kohët, sikur ka hijeshuar më fort natyrë e Dibrës së Madhe, njerëzit e saj fisnikë e bujarë.

Siç e tha midis të tjerash Defrim Methasani: “Tashmë na ndan vetëm dogana, jemi të bashkuar si krahët e një shqipton tek trupi i saj”.

Në këto anë madhështia sikur flet vetë, sikur të thërret për të kujtuar Grykën e Radikës vendin simbol ku u bë himni i historisë epika e qëndresës e vitit 1844: ... Hajredin Pasha po vjen Radikës, / Vallë ku janë malet e Dibrës?!

Kjo mbeti testmanet kushtrimi, testament që rrezaton dritë historike, dritë vëllazërimi e besatimi. Tek shikoj dy intelektualë të nderuar, shkrimtarin Lutfi Hanku e matematikanin Ismail Erebara që i kanë kaluar të 80-at, por kanë ardhur e përmallëzohen me Dibrën e Madhe, na duket se na përshëndesin ata që i bënë emër e dritë vëllazërimi Dibrës së Madhe, ata që janë në altarin e nderimit (të brezave bashkëkohësit e pasardhësit e Haki Stërmillit. Nderim e dritë Dibra e Madhe! Përsëri më bien ndërmend ato vargje zemre e krenarie legjitime të Eseninut matjan Basir Bushkashi: ... Dibër moj, ku u lind Stërmilli / Të mbulofshin pranverat me lule prilli...!

Pranverat e vëllazërimit, pranverat e lirisë rrezatojnë brezat e Dibrës së Madhe. Gjurmët e brezave, gjurmët e besatimit e të qëndresës janë monumenti i gjallë i historisë, krenari legjitime në brezni.

Lum kush nuk i harron rrënjët, sepse vetëm kështu bleron gjithë jetën, kështu u ngjan lisave shekullore, të cilët kurrë nuk i përkulin fortunat. Mexhit Capa i Dibrës së Madhe ka në gen rrënjët prej shkrepave të Selishtës. Nderim paç Mexhi Capa!



Nga cikli "Në Rodos mes dibranësh e rrëfjave për vendlindjen":
Me Njazi Zebin në Rodos mes dibranësh dhe rrëfjave me kolosë të lashtë dhe të rinj...

emigracion

Më ka mbet në shpirt dashuria e Katërgrykasve të Murrës

(Vijon)

Abdurahim Ashiku: Atëherë kalojmë nga Hurdhë Muhurri, hedhim mbi fytyrë një grusht ujë në Kroin e Zi, kalojmë rrugës këmbësore nëpër një pyll unikal thanash, ndalemi e pimë një kafë tek kulla e Buce dhe bëjmë vend në Lunarë ku milen ujërat e liqeneve të Kacnisë dhe Balgjajt për ti dhënë Murrës, degë e Drinit të Zi, ujin kristal...

Njazi Zebi: Udhëtim i bukur...

Çfarë është Lunara?

Lunara është qendra e Katër Grykëve të Murrës...

Po ta marr fjalën. Me Lunarën jam njoh në maj të vitit 1960. Mbaj mend një ndërtesë ku kishin zyrat lokaliteti i Katër Grykëve me kryetarin, sekretarin, ofiqarin e gjendjes civile siç quhej asokohe dhe të plotfuqishmin e ligjeve. Ndërtesa ishte e vendosur midis dy ujërave që takoheshin poshtë një ure që lidhte rrugën e vjetër Muhurr-Lis-Burrel. Në anën tjetër ishte një teqe që thoshin se bën mrekulli. Asokohe vetëm Qafë Murra kishte hyrë në kooperativë. Në qendër të saj, në shtëpinë e kulturës më ka ngelë në kujtesë një radio me vajguri...

Në Lunarë punova dhjetë vjet. Në shkollën e mesme jepja kiminë, botanikën, agrokiminë dhe biologjinë.

Shkolla e Lunarës ishte më ndryshe se ajo e Hurdhë Muhurrit. Kishte një kontingjent mësuesish shumë të përgatitur, të nivelit bashkëkohor, që meritonin jo vetëm për Lunarë por edhe më lart. Lunarë ishte qendra administrative por ishte në thonjëza sepse nuk ishte e banuar. Tash qendra e Katër Grykëve është Selishta.

Ditën e parë kur shkova në Lunarë, e kujtoj si sot...

U nisa nga Ushtelenca pasi mora emërimin. Ndërkohë kisha marrë një fletë për të vajtë në kamp e megjithatë, më 16 gusht kur duhet të paraqitesha në detyrë u detyrova t'i shes të dyja fletët e kampit. Ishim emëruar me gjithë gruan por ditën e parë shkova vetëm. Rrugës, për fat të keq, shoferët e asaj që bënin rrugën për dru e gurë nuk më njihnin dhe kujtonin se unë jam për të vajtë në Muhurr dhe nuk kishin pse ta ndalnin makinën. Ditën e parë e bëra në këmbë. Kisha vetëm 12 lekë në xhep. Kur shkova te klubi miku im, shoku im Demir Kica, drejtor shkollë në Selishtë, rrinte atje bashkë me familjen. Më haheshe bukë sepse isha i lodhur. Ishte vapë gushti. Asnjë makinë nuk më mori. Këmisha ishte bërë zi e përtej të zezës. Kur hyra tek klubi më takoj të marr një kamb kau të prerë copa-copa ashtu siç e prisnin atëherë. Unë mishin nuk e ha dhe kur i kërkova ta ndërrojë, sepse nuk kisha ta paguaj të dytën, kuzhinieri e përplasi derën e banakut si sinjal për ndash haje ndash ik.

Nga inati mora një raki aq sa bënte rakia, një raki frutash që të mbyste, nuk kisha pirë ndonjëherë si ajo raki.

Kur erdh Demiri, shkoi tek banaku dhe mori dy raki "peneste". Ndryshoi rakia e



drejtorit me atë të të panjohurit.

Nesërit pasdite u hap për herë të parë shkolla e mesme natën për punonjësit, një detyrim për njerëzit për mbajtjen e vendit të punës. Kur pashë, nxënës të shkollës së natës ishin edhe banakieri dhe kuzhinieri. I kam sot miq. Megjithëse nuk e morën shkollën ata e morën vesh se ishin për të mos e marrë. Njeri ishte Aqifi, tjetri ishte Aliu, tjetri ishte Haliti, rahmet pastë se pas vdekjes falet njeriu.

Ndërtova një laborator në Lunarë. Punova kaq mirë aq sa bëja jo më pak se 76 orë në javë. Si mund të bëjë një mësues 76 orë? Ja ta tregoj unë. Dy paralele viti i parë, dy paralele viti i dytë, kimia dhe botanika e viteve të para ishte tre herë njëra e dy herë tjetra dhe tre herë kimia, tre herë biologjia. Vazhdojmë me kiminë e biologjinë e viteve të treta 6 orë. Klasa e tretë tre herë kimi. Viti i katër agrokimi. Dhe shkolla e natës po të

njëjtat kushte. Të gjitha bashkë bëjnë 72 orë në javë. Nuk mora një herë të vetme shpërblim e vlerësim.

Më ka ngelë në shpirt dashuria e madhe e atij populli, kujdesi për mësuesit. Miniorët e minierës së kromit të Selishtës në malin e Balgjat ktheheshin nga miniera me "bukën e mësuesit" nën sqetull.

Më ka ngelë në shpirt dashuria pa kufij e njerëzve aq sa nuk e përshkruaj dot. Këta ishin Lice Rame, Kalie... Kujdeseshin për mësuesin. Kujtoj atë vend me shumë nostalgji. Unë në ato vite bëra një shtëpi në Ushtelencë dhe nuk mbet njeri, grua e burrë pa më ndihmuar duke prerë demë e trenë, duke qëruar pemët. Dhe unë shpesh herë nuk e njihja se kush ishin ata që më ndihmonin. Nuk mundem t'ia shpërblej atij vendi atë që ka bërë për mua.

Je marrë me studimin për florën e Katër Grykëve të Murrës...

Më ka ngelë në shpirt dashuria pa kufij e njerëzve të Kacnisëaq sa nuk e përshkruaj dot. Këta ishin Lice Rame, Kalie... Kujdeseshin për mësuesin. Kujtoj atë vend me shumë nostalgji...

Studimi për asosacionin bimor të Katër Grykëve, përjashtuar Selishtën se nuk pata mundësi, e kam bërë në 10.500 hektarë tokë që në kufirin ku ndahet me Matin, me Lurën dhe pjesën tjetër ku ndahet me Selishtën, Lukani, Qafë-Murra dhe Kacnia. Mu krijua mundësia nga komiteti i shkencës i rrethit të Dibrës, dikush u bë sebeb si rahmet pastë Fitim Dani. Mu dha e drejta që të mos e bëj me provime siç bënin mësuesit e tjerë, marrjen e kategorisë por të bëj një studim që lidhej me njohjen e bimësisë së asaj zone. Ndihma e parë ishte e lidhur me përvojën e një gjemani të cilën e përktheva për zgjedhjen e metodës. E dyta ishte ndihma e ZyberKabës, një inxhinier pyjesh, mik i cili më dha hartat e asaj zone. Një tjetër ndihmë nga Zaim Rina ka qenë harta e tokave të mbjella të cilat nuk i përmbledh studimi im, hartën pedologjike, studimet e tokave i kam marrë të gatshme. Nga stacioni meteorologjik në Peshkopi kam marrë të dhënat e temperaturave, reshjet, erën etj.

Shkollat e mesme bujqësore kishin disa orë praktikë në lëndët që jepen mësim. Unë shfrytëzoja orët e botanikës dhe për 5 vjet nxënësit e viteve të dyta si dy paralele më kanë ndihmuar me grumbullimin e këtyre bimëve. Më vonë, me çelësin e Mustaf Demirit, një ndër baballarët e botanikës shqiptare vazhdova të thellohem në studim.

Me këtë studim u jepja ndihmë zooteknikëve, barinjve për sasinë e bimëve që mund të trajtohen në atë zonë, ndihmoja njerëzit që merren me mbledhjen e bimëve mjekësore se cilët janë bimët dhe kur duhet të mblidhen. Ndihma specialistët e pyjeve për të njohur bimësinë e ulët në pyje dhe në kullota. Mikroklima e asaj zone nxjerr në pah edhe bimë endemike. Pingiupula, bimë insektengrënëse që mund të mbillet edhe në një vazo shtëpiake dhe të pastrojë mjedisin nga mushkonjat, mizat dhe insektet e tjerë.

Ai vend është shumë i bukur, me burime ujore pyje etj. arneni është bimë mjekësore.

Dhe kë do të vlerësosh më shumë për bukurinë e Katër Grykëve të Murrës; Lukanin me Pllajën ku mrijojnë delet dhe qengjat? Qafë Murrën me Manasdrinin që sheh si në pëllëmbë të dorës luginën e Matit? Selishtën me Pratin? Minierën ku nxirrej krom e ku katërgrykasit u bënë miniorë? Kacninë me liqenët e bukur fshehur mes gjelbërimit të natyrës?...

Nuk zgjedh dot. Njëra ia kalon tjetrës për bukuri e vlera. Megjithatë liqenët e Kacnisë, ku zhvillonim piknikë me nxënësit, kur të zbulohen plotësisht do të kenë zë më të fortë se liqenët e Lurës. Po të përcjell një fotografi fiksuar nga unë tri dekada më parë...

Kthehemi në Rodos. Kë do të takojmë sot...

Do të takojmë një Luznak që ka bërë emër si njeri i punës dhe dashamirësisë...

Vijon

**BASHKËPUNO ME REDAKSINË:
NJOFTO RASTIN ME TELEFON OSE EMAIL
DHE NJË GAZETAR I YNI DO T'JU NDIHMOJË
TA BËNI PROBLEMIN TUAJ PUBLIK.**

Mos ngurro! Duke bërë publike problemin tuaj, zgjidhja do të jetë më afër.
Shkruaj email: <rrugearberit@gmail.com> ose telefono: 069 20 68 603

Anekdota e muajit

Një politikan shkoi vizitë për krishtlindje, si gjithë kolegët e tij, në një familje të varfër myslimane.

- Gëzuar Krishtlindjet nanë, - i tha ai gjyshes së vjetër që rrinte pranë sobës.

- Faleminderit bir! Gzuar qofsh!

- Qeveria jonë, oj nanë, tha politikani, ka bërë gjëra të mira për këtë popull, sidomos për fshatin tuaj. Ne kemi në plan të ndërtojmë ujësjellësin dhe t'ua sjellin ujin e pijshëm në çdo shtëpi; pa do ndërtojmë rrugën dhe do ta shtrojmë me asfalt, do bëjmë edhe urën që ta keni më shkurt të shkoni në fshatin matanë lumit, do bëjmë një shkollë të re, edhe fillore edhe të mesme, do të ndërtojmë një treg të madh, ku ju të mos rropateni deri në qytet

për t'i shitur prodhimet bio, por të vijmë vetë tregtarët nga qyteti dhe t'ua blejmë këtu, do t'ju sjellim traktor që ju ti blini me tregti e të mos rropateni arave me shat në dorë, dhe në fund fare, do ndërtojmë një hidrocentral të vogël më ujin e lumit që keni këtu afër dhe atëherë kjo qeveri përfundimisht do t'ia japë dritë kësaj krahine. Se oj nanë, kjo qeveria, dhe unë personalisht, punojmë natë e ditë që edhe ju të moshuarit ti gëzoni dy ditë të bardha!

- Hë, si thua, - e nguci ai gjyshen ti thoshte dy fjalë!

- Rrofsh, mor bir, - tha gjyshja! Jarebi o Zot, çashtu si ju po mundoheni t'na i zbardhni ditët që na kanë mbetë, ashtu edhe Zoti jua zbardhet saj!

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Këtë muaj u ringjall debati për Veriun dhe Jugun. Problemi ishte se ata nga Alpet kanë zënë toka në bregdet, ndërsa këta të bregdetit nuk ua mban të zënë toka në Alpe, atje ku dielli del tre muaj në vit... Kështu që e akuzuan kryeministrin dhe PS se janë antiveriorë. Dhe këta bëjnë be e rufe se nuk janë aspak të tillë. Ama, stacionin e mikrobusave për Dibër ca kohë e nxorën jashtë unazës. Duheshin ndërruar dy urbanë për të shkuar, ndërsa po të shkoje me taksi ishte me shtrenjtë nga Skënderbeu në stacion, se sa nga stacioni në Peshkopi. Ndërsa tani, pasi i mbushën me gjoba si dhuratë për vitin e ri, i kanë futur në një stacion-kotec një nga një dhe u ndalojnë të qarkullojnë nëpër Tiranë...

Korabi e mbylli me sukses këtë vit. Nga kategoria e dytë u ngjit në të parën, ndërsa tani ka shpresa të kalojë në superiore. Ndashjen e fundit fituan në fushë ndaj Erzenit - kundërshtarët direkt, ndërsa e humbën në shkallët e stadiumi...

Iku dhe ky vit bosh për Rrugën e Arbrit. Na mbajti shpresa muaj pas muaji se fillon puna me sot e me nesër. Tani, si gjithmonë thuhet se paratë janë problem... Dhe të shkretat para, bëhen problem sa herë bëhet fjalë për rrugën, por pse paratë shkojnë lum për rryshfë e abuzime, nuk kujtohet kush. Po të kthenin hajdutët lekët që i marrin shtetit, do të kishte mbaruar edhe rruga dhe do binim rehat...

Si gjithmonë në këto vite, nuk ikën viti pa e marrë një kurban nga Bulqiza. Dhe këtë radhë një djalë të ri, jo brenda galerive, por jashtë,

në dritë të diellit. Dhe çudi, gurët e kromit nuk marrin asnjëherë nën vete ndonjë të kamur, vetëm të varfër dhe hallexhinj që punojnë për bukën e gojës....


Qeveria ka miratuar një moratorium 10 vjeçar për ndalimin e prerjeve në pyje. Në Bulqizë një fshat i tërë ka ditë në protesta, por askush nuk përpiqet ta ndalojë masakrën. Kanë bërë peticione, kërkesa, takime, ankesa por askush nuk u jep të drejtë dhe deri sa ligji të hyjë në fuqi, edhe pylli i tyre duhet të jetë zhdukur...

Sipas një statistike të botuar së fundmi, Dibra është rrethi ku vetëm 12 % e popullsisë kanë makinë, dhe 95% e tyre kanë makina të përdorura. Statistika nuk është e saktë, se ndryshe do të shkruhej që 90% e tyre kanë furgona që bëjnë çdo ditë rrugën katund-qytet dhe anasjelltas, sa për të harxhuar karburantin...

Dibra është zhytur në mjegull këtë fundviti. Fotografitë në rrjetet sociale tregojnë vetëm rë në luginë. Ministri Ahmeti tha se qeveria do t'ua japë turqve Skavicën. Kështu që mjegulla ka ardhur paradhënie...

Viti duket se u mbyll mirë për Radikën. Lajmet nga Europa thonë se qeveria e Maqedonisë duhet ta ndërpresë procesin, por lajmet nga terreni akoma nuk e konfirmojnë. Këto punët kundër popullit bëhen natën dhe veç kur të zgjohemi ndonjë ditë me ujin që mungon.

Tani në mbyllje po ju urojmë për Vitin e Ri! Ardhtë i mirë, me lajme të mira e me bereqet. Në qoftë se vjen si ky që po ikën, më mirë të mos vijë fare! Kujdes: Mos dil në ballkon a dritare momentet e ndërrimit të viteve. Nuk i dihet, në vend të fishekzjarrëve kalon ndonjë plumb...



AMBRA MEDA shkëlqeu në spektaklin "Dancing With The Stars Albania" transmetuar nga Vizion plus. Ajo zuri vendin e tretë në këtë spektakël pas një konkurimi 12 javor. Gjatë gjithë spektaklit Ambra, së bashku me partnerin e saj në spektakël, balerinin Jurgen Balla, ia dolën të merrnin simpatinë e publikut dhe vlerësimet maksimale të jurisë - në të shumtën e rasteve, duke treguar se sakrificat e saj gati dy-vjeçare ia vlejten. Ajo, pavarësisht se nuk doli fituese në këtë spektakël, e ka fituar betejën e saj, duke dhënë mesazhin se ëndrrat vazhdojnë.
Në foto: Gjatë një kërcimi me kampionin e botës në Kikkoks, Ismail Keta.

Ftesë për bashkëpunim

Gazeta "Rruga e Arbërit" në bashkëpunim me Botimet M&B ka në projekte për vitin e ardhshëm disa veprimtari dhe botime në fushën e kulturës, me vlera historike, kulturore dhe kombëtare për Dibrën dhe gjithë Shqipërinë.

Ftojme individë, shoqata apo institucione vendore të bëhen bashkërealizuese të këtyre projekteve.

Për më shumë informacion mund të shkruani në email **mmbotime@gmail.com**, **rrugaearbërit@gmail.com** ose mund të telefononi në numrin **069 20 68 603**. Faleminderit!

Librat e botuar nga Botimet M&B mund ti gjeni në Tiranë pranë librarisë së Shtëpisë Botuese M&B, në rrjetin e librarive "Adrion", si dhe në disa librari kryesore në Tiranë.
Në Peshkopi: Libraria "Fleta XXI", pranë Muzeut.
Në Durrës: Libraria "Dyrrah". Tel. 0694053353
Për porosi: tel. (04) 22 33 283 / 069 20 68 603
068 65 08 441 / 067 30 73 265
E-mail: <mmbotime@gmail.com>

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT

Të nderuar bashkëpunëtorë,

Për të pasur një bashkëpunim të suksesshëm, ju lutemi të keni parasysh disa kritere për materialet që sillni pranë redaksisë.

- Shkrimet duhet të jenë të daktilografuara, jo më shumë se 2000 fjalë (12000 karaktere, përfshirë hapsirat). Shkrimet duhet të përmbajnë shkronjat "ë" dhe "ç". Shkrimet me më shumë fjalë, do ti nënshtrohen procesit të redaktimit.
- Fotografitë për shkrimin duhet të jenë me diçitë dhe më emrin e fotografit.
- Materialet me karakter aktual dhe problematikë e ditës kanë përparësi botimi.
- **Materialet historike, recensat apo portretet, nuk do pranohen për botim, n.q.s. ato konstatohen se janë botuar në ndonjë media tjetër apo rrjete sociale.**
- Shkrimet duhet të jenë origjinale dhe të respektojnë të drejtat e autorit.
- Shkrimet duhet të sillen nëpër nëpërmjet Postës Shqiptare në adresën e gazetës, postës elektronike në e-mail <**rrugaearbërit@gmail.com**>, ose mund tu dorëzohen personave të autorizuar nga redaksia.
- **Shkrimet që janë jashtë platformës së gazetës, nuk botohen dhe redaksia nuk është e detyruar të japë shpjegime për çdo rast.**

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira për bashkëpunimin e deritanishëm.

Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën <**rrugaearbërit@gmail.com**>

Redaksia.

Ballanca mbetet uragani i pandërprerë që me siguri do të kishte shndërruar edhe më fort po të jetonte më gjatë.

veprimtari

Faik Ballanca, shkrimtari modern në diktaturë

Nga DIONIS XHAFA

Në Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë më 18 dhjetor 2015 mbahet ceremoni përkujtimore për "sfinskin" e letërsisë shqipe, i krahasueshmi me Migjenin, modernin në diktaturë, shkrimtarin Faik Ballanca. Mbi 200 pjesëmarrës, të gjithë familjarë, miq, të njohur dhe dashamirës u mbledhën bashkë për ta kujtuar Faikun, që siç e quanin ata njeriu që vendosi në qendër njeriun, që shkatërroi skematizmin e realizmit socialist dhe që la pas vepra që kurdoherë e zbardhin emrin e tij.

Në kumtesat e mbajtura në sallën "Aleks Buda" u fol tejet për veprat e Ballancës, i cili shënon edhe 70-vjetorin e lindjes, vit që nuk e arriti dot. Miq e të njohur e tregojnë Faik Ballancën si të rrëmbyer dhe të përflakur dhe që vulosi artin e vërtetë, atë me fytyrë njerëzore. Siç ishte vetë, ashtu ishin edhe personazhet e krijuara nga ai: të vuajtur, të harruar, me halle, me probleme, dhe të lënguar nga padrejtësitë e jetës së mundimshme. Siç shprehën edhe miqtë që e kishin njohur nga afër, akademikët që e kanë studiuar, Ballanca shkeli në territore të pashkelura të letërsisë shqipe. Ishte antikonformisti që nuk e duronte dot shtypjen e diktaturës, dhe se ndoshta prej kësaj trysnie vendosi edhe të ikë përpara kohe nga kjo jetë.

Faik Ballanca tregohet nga shokët se kishte guxim për liri prej djaloshi dhe se kishte qetësi dhe mendjemprehtësi prej një plaku të mençur. Aq i drejtë dhe i ndershëm, sa duket se tek ndershmeria që kishte qëndronte edhe tragjizmi i tij. Aq i pakompromistë kundër ambientit totalitar që e rrethonte, sa zgjodhi deri aktin ekstrem të vetëflimit. Ai ishte kundër heroizimit dhe mitizimit të figurave në diktaturë, kundër kultit të individit dhe kundër çdo lloj xhelati që derdhte vlerë kundër qënies njerëzore. Fundi i tij tragjik iu ngjan shumë fundeve të tilla të parakohshme të letërsisë shqiptare si Migjeni, apo në letërsinë e huaj, si shkrimtarët përgjithësisht ekzistencialistë. Sidoqoftë, Faik Ballanca ka arritur jo vetëm të shkruajë stilistikisht në mënyrë të arrirë, por ai edhe lexonte vepra që për kohën ishin herezi, gjithashtu edhe përthente. Ballanca mbetet një figurë kyçe e letërsisë shqiptare, që iku përpara kohe dhe në moshë të re, por se u fik me zjarr e dritë rrethuar dhe plot ndjeshmëri njerëzore. Ndërsa miqtë e tij sulmonin dhe "e kishin bërë copë e çikë" kapitalizmin, Ballanca jetonte me njeriun, me ndjenjat e tij.

Personazhet e Ballancës nuk janë mitikë, ata nuk janë të pavdekshëm. Përkundrazi, personazhet e tij dashurohen, kanë drama në jetë dhe kanë fate të kryqëzuara, duke përshkruar kështu njerëz të vërtetë, me ndjenja e halle. Ballanca kurrë nuk u përkul kundër pushtetit, por ishte rebel, iu kundërvu vijës së partisë dhe shpesh botoi edhe shkrime që dilnin jashtë kornizës së realizmit socialist. Një nga miqtë e tij dëshmon sesi Ballanca në



Kush është Faik Ballanca

Faik Ballanca ishte një gazetar dhe përkthyes shqiptar. Ai lindi në Tiranë në vitin 1945, dhe vdiq në vitin 1977.

Ai mbaroi Fakultetin Histori-Filologji në degën e gazetarisë dhe pas përfundimit të tij punoi në gazetën "Zëri i Rinisë" dhe në revistën "nëntori". Shëtitë gjithë trollin e Shqipërisë, herë si gazetarë, herë si alpinist, herë si vizitor, por nuk arriti asnjëherë të shkelë në trollin e lindjes së prindërve të tij në Dibër të Madhe. Tregimet e para nisi t'i botonte në vitin 1962. Nevoja për të lexuar edhe literaturë jashtë kornizave të socializmit realist ate e shtynë të mësoi gjuhë të huaja. Përktheu nga gjermanishtja, frëngjishtja dhe italishtja. Me krijimet e tij, Faik Ballanca arriti të krijonte personalitetin e tij të veçantë si shkrimtar, në saje të kulturës së gjerë, intuitës së hollë artistike dhe skrupulozitetit të tij krijues. Mirëpo, ndonëse ishte "i urtë", për sistemin ai u bë "i prapë" andaj për të mos përjetuar torturat Faik Ballanca vrau vetën, në vitin 1977. Përndryshe në këtë kohë në mënyrë kriminale iu sul diktatura të quajturit "grupi i të rinjve kundër vijës së partisë në art e letërsi". Suzana Selenica dhe Ahmet Golemi u arrestuan, u torturuan dhe pësuan tronditje të thellë psikologjike. U arrestuan Sadri Ahmeti, Pirro Kuqi, Zyhd Morava, u internuan Roland Gjoza, Namik Mane me akuzën e përbashkët: "agitacion e propagandë në art e letërsi".

Titujt e veprave

"Rrëmbimi" - 1970, "Pasdite të lagura" - 1971, "Katër orë larg shtëpisë- Shtigje me helm" - "I fundit" - 1972, "Letra anonime" - 1973, "Pritësit e rrufeve" - 1975, "Tregime të zgjedhura" - 1976, "Nomeja e largët" (roman) - 1989, 2015, "Kënga e fundit e Marko Boçarit" - 2002, "Mbama pak pallton, çun!" - 2003

tregimin "Njerka" nuk e paraqiste njerikën si figurë të ligë, sikundër paraqitej në përgjithësi nga regjimi, por shihte dramën e njerikës, se ajo kishte patur një fat tragjik më përpara dhe tashmë kjo njerikë kujdesej për fëmijët e bashkëjetuesit, duke u bashkuar me dramën e vuajtjes me familjen e re. Kjo njerikë ka lënë pas një jetë të stërmundimshme, plot halle dhe se është bërë bashkëjetuese e fatit të zi, që kanë edhe bashkëshorti i saj i ri dhe ushqen dashuri pa masë për fëmijët e bashkëshortit. Ballanca mbetet thjesht brilant, gati disident, që nuk shkoj në burg nga regjimi, por se nuk zgjodhi as lirinë e jetës në atë sistem. Ky është Ballanca me pak fjalë, shkrimtari, gjeniali, ai që solli diçka ndryshe, por mbi të gjitha njeriu me ndjesi.

Për Ballancën folën me rradhë miq të tijtë dhe persona që e kanë studiuar veprën e shkrimtarit dibran. Ata vunë theksin në faktin se Faiku kishte vendosur themele letërsie moderne shqipe dhe në kohë diktature. Një nga personat që folën tha se Ballancën e kishin nderuar edhe në vendlindjen e tij, të cilën Ballanca nuk e kishte shkëlur kurrë, në Dibër të Madhe.

Nasi Lera, mik i Faik Ballancës vlerëson se shkrimtari me origjinë nga Dibra kërkonte shpirtin e artit të vërtetë në kohën kur mungonte liria. Ai thekson se Faiku përveçse shkruante, arrinte edhe të përthente kolosë të shekullit të XX-të. Nasi Lera vlerëson se Faiku ishte kundër letërsisë që mbivlerësonte heronjtë e rremë të socializmit, por ishte për letërsinë e re, moderne. Lera mban mend se në tregimin "Njerka", botuar në "Drita", Faiku tregon figurën e njerikës si bashkëvuajtëse. Sipas Lerës, tek ndershmeria dhe drejtësia e tij qëndronte edhe tragjizmi i tij. Ai kujtoi

edhe këngën e preferuar të Ballancës, e cila ishte po ashtu në njëfarë mënyre si utopi për botë më të mirë. "Kërkoj pak kaltërsi. Aty ku kaltërsi nuk ka...", e cila në origjinal është në gjuhën italiane.

Mexhit Prençi vë theksin në atë se ikja e Ballancës nuk ishte ikje përgjithmonë, por ishte ikje fizike, por jo me vepra. "Ikja e tij ishte fizike, pasi la pas gjurmë të pashlyeshme. Koha e vlerësoi atë. Ai shkëlqente në tregime. Ai bëhej njësh me personazhet, ndjenjat dhe emocionet e tyre. Faiku ishte antikonformist në kohën kur gjërat vendoseshin nga një parti. Sot dhe nuk gjendet liria për të folur të vërtetën, e jo më në atë kohë. Por, Faiku arrinte të çlirohej nga prangat e politikës", tha ai.

Prof.Dr. Piro Gjoni ka shkruar një monografi për Faik Ballancën. "Faiku shkeli në tokë të panjohur të letërsisë sonë. Ballanca do të mbetet figurë kyçe në letërsi i vlerësuar nga e djeshmja, e sotmja dhe e ardhmja, pasi ka në qendër njeriun", u shpreh ai.

Xhahid Bushati, shkrimtar, publicist: Faik Ballanca ishte si Migjeni, kërkonte lirinë, kishte simbolikë në vepër dhe shfaqet vizionar. Ai mbetet shkrimtar tragjik, ai stërmundoj për kauzën njerëzore, ishte human, kishte dije e vetëdije në personazhet e tij. Ai përmendi faktin se Vath Koreshi kishte thënë për Ballancën se Faiku ishte ndër të rrallët shkrimtarë njeri, që ishte i vyer si shkruar, por edhe si mik.

Prof.Dr.Klara Kodra: Faik Ballanca ishte modern, edhe pse jetoi në vitet 1960-70. Personazhet e tij janë njerëzorë dhe kishin veçantësinë se ishin as negativë dhe as pozitivë. Kodra thotë se Ballanca ishte

shpirtërisht i bukur.

Vladimir Muça, mik, ardhur nga Durrësi: "Ideali i tij ishte mbi të gjitha: Njeriu. Nuk kishin lavde për Nënë Parti dhe as për ata që ushtronin pushtet. Faiku trajtonte si personazhe njerëz të thjeshtë. Ai ishte zjarr i tëri, i ndezur dhe i padurueshëm ndaj varfërisë, mjerimit. Faiku nuk kishte manikinë letrarë. Personazhet e tij dashurojnë, përjetojnë drama dhe vdesin", tha Muça.

Bujar Kapexhiu, mik i hershëm i Faik Ballancës: "Ishte njeri i mirë dhe i mençur, por edhe shumë serioz, aq sa edhe kur qeshte, Faiku qeshte me seriozitet. Ai me humor më tej përmendi faktin se vetë ishte dibran, sikundër edhe Faiku ishte po dibran. "Unë them se nëse Faiku do të ishte gjallë, nuk do të ishte as deputet dhe as ministër (nënkupto: sepse nuk donte pushtet). Ai do të ishte shkrimtar i madh, me siguri si Ismail Kadare", foli Kapexhiu.

* * *

Kështu u mbyll edhe përkujtimi për Ballancën, ku përveç atyre që folën kishte edhe persona publikë në zë, të tillë si Xhevahir Spahiu, që për letrat shqip vlerësohet se është sikundër e ka emrin: xhevahir.

Faik Ballanca mbushi 70-vjeç. Ai nuk ishte i pranishëm në ceremoni, por ishin në atë sallë veprat e tij, pena e tij, vepra që e bëri të pavdekshëm. Ballanca mbetet uragani i pandërprerë që me siguri do të kishte shndërruar edhe më fort po të jetonte më gjatë. Një uragan që ndriçoi këdo që e njohu dhe dogji të gjithë pushtetarët, ata që kishin krijuar një regjim, që do të mbahet mend si më i egri, më i ashpri dhe më totalitari në të gjithë lindjen e Evropës.

Keni ndonje shqetësim për të ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

Faik Ballanca, shkrimtari brilant i krahasueshëm vetëm me vetveten

Nga MEXHIT PRENÇI

Shkrimtari brilant Faik Ballanca është zë i veçantë dhe original i prozës shqipe. Na mbledhi në këtë tubim përkujtimor dhe rivlerësues, e në të njëjtën kohë edhe promovues të vlerave të prozës së tij. Sipas meje, çdo kohë vlerëson vetveten dhe rivlerëson të shkuarën, ashtu si koha e ardhshme do të vlerësojë të tashmen e saj dhe rivlerësojë kohën tonë.


Krijimtaria dhjetëvjeçare e Faik Ballancës është vlerësua nga shkrimtarët më të shquar të asaj kohe, - si shkrimtar i së ardhmes; po rivlerësohet nga koha e tanishme, - si shkrimtar brilant dhe do rivlerësohet brez pas brezi duke evidentuar dhe argumentuar me profesionalizëm të lartë, atë, që e bën Faikun të jetë vetvetja, si shkrimtar me individualitet të spikatur, i freskët e original, i guximshëm e sfidues i skematizmit dhe partishmërisë komuniste.

Me këtë status ka hyrë në letërsi pa trokatur, si prozator i përveçëm, e në të njëjtën kohë, edhe në pallatin e krijuesve elitare. Në këtë pallat, koha nxjerr jashtë ata që kanë hyrë me marifete dhe hyjnë shkrimtarët e shquar si Faiku, vendi i të cilit është i pazëvendësueshëm.

Që në tregimin e parë "Idhulli i Robi" shkruar në gjimnaz kur ishte 17 vjeç (në gazetën "Zëri i rinisë, më 1963) talenti i tij shfaqet në nivele mesatare dhe të epërme, si në rrafshin e ideve, mesazheve e të përmbajtjes, ashtu edhe të formave artistike. Vetëorientimi realisto-modern dhe dramtikolirik është element cilësor i talentit të tij.

Prozatori i ri shquhej për mendjemprehtësinë dhe guximin krijues, siç e dëshmon tejkalmi i vijat e bardha, në këtë tregim dhe të tjerë, ku siç thotë Martin Camaj, shkrimtarët e realizmit socialist marshonin si skuadër ushtarake në rreshtore, me hapin: "një, dy- një dy; prapa-ktheu, para-marrsh...".

Pa hyrë në analizë apo të rrëfej subjektin e tregimit siç ndodh rëndom, do të nënvizoj me pak fjalë vizionin dhe qëndrimin e shkrimtarit të ri, në raportet e partizanit me robin gjerman që punonin në ndërtimin e një ure. Që në takimin e parë prezantimi është armiqësor, në pozicione ekstreme. "Hitler



kaput!" i thotë Partizani. "Hail Hitler" uluret gjermani.

Mënyra si paraqet Ballanca marrëdhëniet e tyre në mjediset e kantierit, në punë dhe në jetën personale, është vetvetja e lirë që shkruan me realizëm, vërtetësi dhe natyrshëm, sa lexuesi bindshëm promovon veprimet dhe debatet e tyre në procesin psikologjik të ndryshimit gradual, të cilët nga armiq që ishin në fillim bëhen miq!

Sipas meje ky është "guxim i çmendur", kur deviza komuniste ishte: me armikun flitet vetëm me gjuhën e pushkës. Dy vite më vonë në Pleniumin e 15-të të PPSH të 1965-sës, pikërisht për këtë qëndrim ndryshe, u dënua drama "Dueli" e Qamil Buxhëlit, "Partizani pa emër" e Fatos Arapit, "Rrethimi i bardhë" i Naum Priftit dhe autorët e tyre.

Shkrimtari i shquar Faik Ballanca gjatë një dekade bëri emër dhe krijoi personalitetin e tij letrar me tregime e novela dhe romanin "Nomeja e largët", për të cilin Kadare do të shkruante: "...romani më pëlqeu. Asnjë nga akuzat që i bën redaksia nuk qëndrojnë. Ky është romani i tij i parë dhe çuditërisht si ka arritur të realizojë një strukturë kompozicionale të tillë, sa të vështirë aq dhe moderne".

Proza e Ballancës është reflektim i realitetit historik dhe jetësor që jepet me realizëm, thjeshtë e natyrshëm, pa rënë në thjeshtëzim. Autori nuk kërkon dramën e madhe, të bujshme e të potershme; nuk e jep të fryrë dramatizmin, tragjizmin dhe lirizmin e jetës, por duke ruajtur sensin e masës, shpreh të bukurën dhe të shëmtuarën, me originalitet, ndryshe nga të tjerët.

Kushdo që lexon prozën e tij aq sa merr kënaqësi estetike nga arti i të shkruarit dhe nga mesazhet e freskëta, të cilat burojnë nga liria e brendshme e autori, çka është sfidë ndaj mungesës së saj në realitetin socialist, - aq ndjen edhe dhimbje, që jeta e shkrimtarit të ri, u ndërpre, sapo kishin shpërthyer sythet e krijimtarisë së tij gjithë lëng jete dhe vezullime.

Proza e Ballancës është reflektim i realitetit historik dhe jetësor që jepet me realizëm, thjeshtë e natyrshëm, pa rënë në thjeshtëzim. Autori nuk kërkon dramën e madhe, të bujshme e të potershme; nuk e jep të fryrë dramatizmin, tragjizmin dhe lirizmin e jetës, por duke ruajtur sensin e masës, shpreh të bukurën dhe të shëmtuarën, me originalitet, ndryshe nga të tjerët.

Këtë e shquaj në tërë krijimtarinë e tij, por sidomos në tregimin "Mbama pallton, çun", për të cilin shkrimtari i talentuar Teodor Keko, do të thoshte: "I shkëlqyer, ai do të mbetet një nga perlat e tregimit tonë të ri"; ndërsa në tregimin "Njerka" pruri në letërsi figurën e njerks së mirë dhe të dashur, sfidë ndaj njerks së keqe- shtrigë, trajtuar nga letërsia tradicionale. Me vlera te veçanta

janë edhe tregimet "Masdite të lagura me shi; "Koleidoskopi", novela "Kënga e Marko Boçarit" etj.

Modernen ngjizur me realisten në veprat e Ballancës, i shoh si prirje e natyrshme e botës së brendshme, që tejkalon realizmin e vjetruar dhe sjell risi në qasjen drejt një realizmi psikologjik në zhvillim.

Shkrimtari ka aftësi të admirueshme krijuese për të depërtuar në botën e brendshme të personazhit për të zbuluar gjërat e qeta e të heshtura, të cilat i jep në lëvizje dhe tension të brendshëm që është cilësi e epërme e krijuesit, çka më kujton Çehovin.

Kjo padyshim është vlerë e cilësisë së prozës së tij, ashtu siç është aplikimi i fjalive të shkurtra dhe mesatare, ndërtaur me mjeshtëri, pa fjalë-lum të turbullta apo sajesa letrareske e përshkrime jofunksionale që pengojnë rrjedhën e natyrshme të rrëfimit.

Sipas meje rol të veçantë në cilësinë e prozës së Ballancës, lot edhe stili ekspresiv, konciz, i qetë në dukje, dinamik përtej saj në shtresat e nënshtresat polisemantike të tekstit. Ai vuri në fokus të krijimtarisë temat në rrafshin etiko-moral e historik dhe të rrëfyerit nën mutaf, ku kishte më shumë hapësirë për të respektuar lirinë krijuese të tij brenda botës së tij, që t'i shpëtonte censurës mizore enveriste.


Duke përfunduar theksoj se Faik Ballanca si njeri, qytetar dhe shkrimtar ishte fisnik, krenar dhe i sertë. Me trupin e drejte e thatim, sy zhbirues e mendje të hollë e të mprehtë, më kujton Migjenin, madje edhe me vdekjen e parakohshme. Më kujton Migjenin jo vetëm si talent i rrallë dhe i jashtëzakonshëm, por edhe për faktin se të dy, rrënjët i kanë në Dibër.

Ndonëse Faik Ballanca, na la pak vepra, zë vend të nderuar në letërsinë tonë mbarëkombëtare. Vepra e tij është kumt për të gjithë ata që shkruajnë shumë e për lum, pa e kuptuar sentencën se jo sasia, por cilësia është vlerë.


Dostojevski do të thoshte: "Talentit është aftësia për të shprehur bukur, atë, që mungesa e talentit e thotë shëmtuar". Faik Ballanca shkruante bukur!

Është shkrimtar brilant i krahasueshëm vetëm me vetveten.


LIBRA TË RINJ NGA AUTORË DIBRANË




Agron Tufa: Thembra e Akcilit
Botimet M&B. ISBN: 978-9928-172-62-4
Çmimi: 800 lekë



Ramiz Gjini: Pëllumbat e rrugës - roman
Botimet M&B. ISBN: 978-9928-172-56-3
Çmimi: 700 lekë



Naim Berisha: Shpresa - roman
Botimet M&B. ISBN: 978-9928-172-59-4
Çmimi: 500 lekë



Mevlud Buci: Alegoria e Dibrës
Botimet M&B. ISBN: 978-9928-172-34-1
Çmimi: 1200 lekë

2015: Korabi siguron daljen në kategorinë e parë dhe me besim për kalimin në superiore

Korabi e mbyll vitin në vendin e tretë, 2 pikë larg kryesuesit

Nga **FATMIR ZHUZHI**

Ka qenë me fat viti 2015 për ekipin e Korabit, pasi në maj të këtij viti nën drejtimin e trajnerëve, Erblin Laçi dhe Shpëtim Toska, sigurojnë daljen në kategorinë e parë.

Ndërkohë që në shtator ndeshen për Kupën e Shqipërisë me Partizanin, por tani një ekip ndryshe, pasi janë bërë shumë përforsime. Ndonëse humbëm në ndeshjen e parë me rezultatin 0-5, fitoi ndeshjen e dytë 0-2.

Megjithëse u eliminua nga kupa, mendjen e kishin te kampionati. Për këtë presidenti Mziu, tha që ndeshja me Partizanin ishte një ndeshje luksi për ne, pasi do të ngelet në arkivën e klubit.

Në kampionat ekipi dibran i drejtuar nga tekniku Mehmeti, në 13 javë kampionate ka arritur që të marrë 9 fitore, 1 barazim dhe 3 humbje, me një golavarazh të mirë 19-6, duke grumbulluar 28 pikë, 2 pikë larg vendit të parë.

Meritë të madhe ka i gjithë ekipi, por në veçanti meritën kryesore e ka portieri Elbasanas, Kotorri, pasi në 13 javë ka pësuar vetëm 6 gola, ndërsa golashënuesi më i mirë është sulmuesi shkodran Guri, i cili deri tani ka shënuar 9 gola.

Mbështetjen më të madhe e ka pasur nga tifozëria dibrane, e cila nuk i është ndarë ekipit si në fushën tonë ashtu dhe në transfertë. Ata

kanë krijuar dhe shoqatën e tyre, të cilën e kanë quajtur, "TIFO GRUP ARBERIT".

Javën e fundit në këtë vit ekipi luajti ndaj Erzenit, ku fitoi me rezultatin 2-0 dhe me këtë fitore ngjitet në vendin e tretë me 28 pikë.

DRITAN MEHMETI:

E kemi mbyllur me sukses vitin 2015, ndonëse ekipi ka pasur luhataje nga ndeshja në ndeshje, por jam munduar që të bëj më të mundshmen, që mos të dalim pa pikë në asnjë ndeshje, ndonëse në ekip mungon konkurrenca, pasi mungojnë lojtarët e stolit dhe jam i detyruar që të bëj ndryshime në formacion.

Shpresojmë që në bashkëpunim me presidentët të ulemi dhe të bisedojmë, për afrimin e ndonjë futbollisti cilësorë, për të arritur objektivin. Ndërsa për superioren duhet që të qëndrojmë me këmbë në tokë, pasi kampionati është i gjatë, por dua të falënderoj me gjithë zemër të gjithë tifozët dibranë, pasi janë tifozëria më e mirë në Shqipëri.

ELVIS KOTORRI:

"Jam i lumtur që luaj për Korabin, pasi kushtet që na janë ofruar nga drejtuesit e ekipit janë të mira si dhe presidentët e ekipit kanë qenë korrektë me pagat. Besoj që dhe ne kemi bërë maksimumin deri tani dhe shpresojmë që të arrijmë objektivin.

Renditja pas fazës së parë

Nr.	Skuadra	P	NL	F	B	H	Gsh	Gp	DG	PP
1	KS Kastrioti	30	13	9	3	1	27	11	16	0
2	Besëlidhja	29	13	9	2	2	26	11	15	0
3	KS Korabi	28	13	9	1	3	19	6	13	0
4	KF Erzeni	22	13	7	1	5	19	12	7	0
5	FC Besa	18	13	5	3	5	17	16	1	0
6	FK Kamza	16	13	4	4	5	12	16	-4	0
7	Iliria	16	13	5	1	7	19	20	-1	0
8	KF Burreli	12	13	3	3	7	11	20	-9	0
9	KF Ada	8	13	1	5	7	12	28	-16	0
10	KF Adriatiku Mamurras	3	13	0	3	10	6	28	-22	0

Bashkia nderon donatorët e ekipit



Kryetari i Bashkisë Dibër z. Shukri Xhelili duke i dorëzuar mirënjohjen për ndihmën e dhënë për ekipin e Korabit, biznesmenit Musa Riçku. Nga e majta në të djathta: Lunada Methasani - moderatore e veprimtarisë, Musa Riçku, Shukri Xhelili dhe Deñrim Methasani.

Me daljen në Kategorinë e Parë ka qenë e nevojshme edhe gjetja e burimeve financiare për të garantuar një ecuri normale të ekipit. Me këtë rast, Bashkia e Dibrës, në bashkëpunim edhe me miq të Korabit dhe biznesmenë, është përpjekur të gjejë burimet e nevojshme financiare.

Në ceremoninë e shpalljes së 10 sportistëve më të mirë të vitit, zhvilluar në Peshkopi më 19 dhjetor, janë nderuar me mirënjohje disa nga mbështetësit financiarë të ekipit, mes të cilëve edhe biznesmeni Musa Riçku, i cili, që nga java e parë në këtë edicion ka qenë pranë ekipit. Mirënjohja për z. Musa Riçku ishte me motivacionin "Për kontributin e çmuar të

dhënë në ecurinë e rezultateve pozitive të klubit sportiv "Korabi" gjatë vitit 2015".

Për ndihmën e dhënë ekipit në këtë edicion janë nderuar edhe presidentët e ekipit Femi Mziu dhe Albert Laçi, si dhe një mbështetje të fortë për ekipin ka dhënë edhe Shemsi Prençi. Gjithashtu, në këtë veprimtari janë nderuar edhe grupet e tifozëve "Arbërit" dhe "Sokolat" si dhe drejtues e ish-drejtimes të ekipit të Korabit në futboll dhe voleyboll gjatë viteve të fundit.

Në këtë veprimtari merre pjesë edhe sekretari i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit, Ilir Shulku.

Gazmir Rama, Nderi i Mundjes Shqiptare

Më datë 28 nëntor, Federata Shqiptare e Mundjes dekoron me titullin "Nderi i Mundjes Shqiptare" sportistin Gazmir Fiqiri Rama.

Familja Rama është një familje sportive ndër vite, por plot nipa e mbesa, ka qenë viti 1995 kur ndeshen babë e bir, një rast i rrallë në sportin shqiptar, por e vërtetë. F

iqiri Rama gëzon titujt "Nderi i Gollobordës", "Nderi i Klubit Sportiv Korabi", "Nderi i qytetit të Dibrës", "Nderi i shortit shqiptar" etj. Por Gazi sot është një familjar i



respektuar.

Sporti i Mundjes është një sport i hershëm në Dibër dhe me traditë në këtë sport burrëror, sportistë të Dibrës jo vetëm kanë përfaqësuar emrin e Korabit, por shume ekipe të forta të Shqipërisë si Korabi, Partizani, Dinamo, Elbasani e shumë të tjerë, mundja dibrane jo pak kampionë ka nxjerrë. Mjeshtria sporti, mjeshtria të merituar deri "Ndere të sportit shqiptar" Fiqiri Rama dhe Xhelil Cibaku.

Klubi sportiv Korabi ka dekoruar plot 300 figura të shquara në këtë sport me tituj të ndryshme më 1 tetor të vitit të kaluar, por edhe Federata Shqiptare të Mundjes i falënderojmë.

Edhe sot Mundja ka sjellë disa Medalje, diploma, Kupa etj., por shumë djem janë larguar nëpër Botë, se shorti është i tillë. Fiqiri Rama, trajneri i ekipit, i bën thirrje rinisë që të merret me sport, art e kulturë, pasi vetëm kjo është mënyra më e mirë për një jetë të shëndetshme.

Melsi Tafa

**KËTU MUND TË ISHTE
REKLAMA JUAJ PËR
VETËM 1000 LEKË**

Porosite tani: 069 20 68 603

Bashkia Dibër në bashkëpunim me Sport Klub Korabi organizoi në fund të dhjetorit në mjediset e Pallatit të Kulturës Peshkopi aktivitetin e fundvitit: "10 sportistët më të mirë të Dibrës për vitin 2015".

"10 sportistët më të mirë të Dibrës për vitin 2015"



Ekipi i futbollit të Korabit, ekipi i volejbollit të vajzave, drejtues të pushtetit vendor, drejtues të ekipeve të Korabit në futboll dhe volejball si dhe donatorë të ekipeve në një foto të përbashkët në fund të veprimtarisë më 19 dhjetor 2015.

Nga **HASAN PASHA**

Rikthim në traditë. Kështu duhet etiketuar eventin e organizuar në qytetin e Peshkopisë. Bashkia Dibër në bashkëpunim me Sport Klub Korabi organizoi në fund të dhjetorit në mjediset e Pallatit të Kulturës Peshkopi aktivitetin e fundvitit: "10 sportistët më të mirë të Dibrës për vitin 2015". Deputetë, drejtues të pushtetit lokal, ish sportistë njohur, zyrtarë të klubeve dhe tifozë dibranë përshëndetën dhe uruan sportistët fitues. Deputeti Ulsi Manja dhe kryebashkiaku Shukri Xhelili falënderuan 10 sportistët më të mirë të këtij viti dhe premtuan se mbështetja e strukturave shtetërore nuk do të mungojë. Aktiviteti, i drejtuar mjeshhtërisht nga gazetari Defrim Methasani dhe vajza e tij Lunada, ishte organizuar në formën e spektaklit çka solli emocione të veçanta jo vetëm për fituesit e anketës, por edhe për të pranishmit e shumtë.

1. Ardita Zebi e ka nisur sportin e bukur të volejbollit që 12 vjeçe, pra gjashtë vjet më parë. Vetëm një vit është aktivizuar me para të reja dhe pese vitet e fundit me ekipin e të rriturave të Korabit. Me vullnet, me sakrificë, me stërvitje Zebi është aktualisht njëra nga lojtarët e spikatura të Korabit. "Atë që doja

e arrita falë prindërve, trajnerëve Bulku e Salkurti", shprehet 18 vjeçarja.

2. Klevisa Neli. Tre vjet më parë është federuar me skuadrën e Korabit për të rritura. "E nisa aktivizimin me një farë frike, pasi nuk kisha përvojën e mjaftueshme, por tani nuk e kam problem të luaj në çdo pozicion", shprehet Neli. Tani kjo lojtare është e mirëpërgatitur dhe po arrin rezultate të larta, falë dhe kujdesit të trajnerit Femi Bulku dhe këmbënguljes së Klevisës. Ajo shpreson se Korabi do të arrijë rezultate më të larta.

3. Eriona Kovaci: 15 vjeçe ishte Eriona Kovaci kur është aktivizuar me ekipin e të rriturave të Korabit të Peshkopisë. Vajza dibrane nuk mund të harrojë stërvitjen nga talenti Bashkim Lala. "Kam luajtur fillimisht si lojtare e lirë e Minatorit të Rrëshenit. Pastaj si sulmuese dhe tani edhe si pasuese. Si kapiteni e ekipit kam më shumë përgjegjësi për rezultatet e skuadrës", thotë Kovaci.

4. Fation Vishka: Nën kujdesin e Mjeshtrit të Mundjes Fiqiri Rama, Fation Vishka nga qyteti i Peshkopisë që në moshën 14 vjeçare nisi sportin burrëror të mundjes. Ai është shpallur kampion për disa vite për grumoshat dhe nënkampion me të rinjtë. Ka fituar tituj nderi edhe me të rriturit. Në disa gara është shpallur sportisti më i mirë dhe

ka fituar medalje ari në turneun e Shkupit, Maqedoni.

5. Elvis Kotorri: Njihet si gardiani i portës dibrane të Korabit. Presidenti Femi Mziu e cilëson si garancia kryesore e rezultateve pozitive të ekipit. Në pjesën e dytë të fazës së parë, për 450 minuta nuk pësoi gol në portën e tij. Ai është memorizuar në mendjet e tifozëve "Arbërit" si një portier me cilësi të lartë.

6. Klevis Kacnia: Sportdashësit e Korabit e kanë cilësuar me të drejtë si "motorri i mesfushës". Konsiderohet si lojtari kyç i ngjitjes së Korabit në Kategorinë e Parë. Kolegët dhe drejtuesit e skuadrës e klubit shprehën me superlativa për cilësitë e këtij lojtari.

7. Rigers Karaj: "Katalizatori" i skuadrës së Korabit. Kështu e cilësojnë specialistët e futbollit Karajin. Madje shkojmë më tej kur thonë se ai është lojtari që ngre peshë në çdo ndeshje tifozët dibranë. Është një bashkëpunues i shkëlqyer me të gjithë kolegët e tij.

8. Eriol Merdini: Është dhe mbetet lojtari i rezultateve pozitive të Korabit. "Oli është njeriu që u dha jetë rezultateve pozitive dhe të njëpasnjëshme të ekipit Korabit", thotë Presidenti Mziu. Merdini është lojtari me të ardhme në futbollin shqiptar.

9. Sindrit Guri: "Sinonimi i fitoreve të Korabit". Kështu shprehen shkurt drejtuesit e Klubit të Korabit. Me nëntë golat e shënuar në grupin A ai aktualisht renditet si golashënuesi më i mirë i Kategorisë së Parë. Sulmues i shpejtë, "agresiv" para portës së kundërshtarit, nuhatës dhe shënues shumë i mirë. Të tjera skuadra do të kishin zili një lojtarë si Guri.

10. Sokol Mziu: Kapiteni shembull për të gjithë lojtarët e Korabit. Model në të gjitha drejtimet. Lokomotiva që ka udhëhequr skuadrën drejt suksesit. I palodhur, i edukuar, komunikues me të gjithë, zbatues i rregullave të lojës së futbollit. Dibranët janë me fat që kanë një lojtar me cilësi kaq të mira.

Korabi ngre Akademinë e Futbollit, italiani Picozzi pret shiritin

Pas nisur ndeshja Korabi-Erzeni në stadiumin Korabi të Peshkopisë është organizuar një ceremoni e veçantë. Dibranët kanë deklaruar ngritjen dhe funksionimin e Akademisë së Futbollit Korabi. Sipas Presidentit Femi Mziu: "Dibranët janë të mendimit se duke ngritur Akademinë e Futbollit mendojnë që tani për të ardhmen e këtij sporti në qytetin e Peshkopisë".

Mziu sqaron: "Grupi i trajnimit do të përbëhet nga persona të licensuar dhe të përgatitur mirë nga ana profesionale. Kjo është një shkollë ku duhet punuar me kujdes, pasion dhe seriozitet të madh. Grupmoshat që do të përzgjidhen janë të 8-16 vjeç. Kjo do të bëjë që Korabi të përfshihet edhe në kampionatet kombëtare të moshave", shtoi ai.

Akademia do të ketë në dispozicion të gjitha kushtet e nevojshme profesionale.

Në ceremoninë e organizuar ishte i pranishëm Giovanni Picozzi, specialist i njohur futbollit, i cili shquhet në zbulimin e talenteve të futbollit në shtetet e Ballkanit.

Po ashtu mori pjesë në ceremoninë festive edhe ish trajneri i Tërbunit të Pukës, (italian) i cili do të asistojë në seleksionimin e talenteve të futbollit nga Dibra. Kjo iniciativë Presidentit Mziu dhe Bashkisë Dibër do të ketë më siguri ndikim pozitiv në komunitet, pasi përveç përzgjedhjes së talenteve që do të luajnë me ekipe të tjera të Ballkanit apo më larg, do të jepet mundësia të përzgjidhen edhe talente që do të luajnë me ekipin e parë të Korabit.

Sipas Mziut, Picozzi premtoi nga Peshkopia se çdo muaj një specialist futbollit nga Italia do të asistojë Akademinë e Futbollit Korabi dhe do të merret me përzgjedhjen e lojtarëve.



LIBRI PRANË JUSH

LIBRARIA FLETA XXI, PRANË MUZEUT,
PESHKOPI

Email: fletaxxi@gmail.com

Ndre Mjeda mori rrugën për në Gur të Bardhë, fshat malor i Matit, ku rruga gjarpëronte në shtigje të ngushta, të thepisura, buzë greminave dhe kalohej vetëm me mushka të sprovuara.

Udhëtimi i Ndre Mjedës në vendlindjen e Pjetër Budit

Nga **HAMDI HYSUKA**


Pjetër Budi është matjan, shqiptar i madh, poeti i parë i letërsisë shqiptare, pararendës i Rilindjes sonë Kombëtare. Vepra e tij ka qenë shumë e përhapur, sidomos te besimtarët katolikë. Ashtu si shkrimtarët e tjerë të letërsisë së vjetër, Budi punoi me ngulm për ruajtjen dhe përparimin e gjuhës amtare. Ai e shikonte dijen një mjet të domosdoshëm për zhvillimin e vendit.

Krahas të tjerëve, vendas dhe të huaj, me studimin e veprës së Pjetër Budit është marrë dhe Ndre Mjeda, poet i madh i Rilindjes Kombëtare. Madje, për nder dhe respekt të veprës së Budit, Mjeda ndërmoi një udhëtim në Gur të Bardhë, në vendlindjen e shkrimtarit të motçëm, siç e quajti ai. Se kush është Ndre Mjeda, dihet nga të gjithë, por pak fjalë kanë vend për të, sepse ka nderuar matjanin e madh.

Ngaqë ai dallohej për zgjuarësi të rrallë, jezuitët ishin ata që e dërguan për studime të larta fetare në Spanjë, Poloni, Kroaci e Itali, ku fitoi doktoratën në filozofi e teologji. Por, po ata, e përjashtuan nga ai urdhër. Në vitet e fundit të jetës prapë pranuan ta merrnin Mjedën mësues në gjimnazin e tyre të Shkodrës. Pikërisht në ato vite, në qershor 1930, Ndre Mjeda mori rrugën për në Gur të Bardhë, fshat malor i Matit, ku rruga gjarpëronte në shtigje të ngushta, të thepisura, buzë greminave dhe kalohej vetëm me mushka të sprovuara. Cili ishte qëllimi i atij udhëtimi?

"...Vetëm për studimin mbi një botim të dom Pjetër Budit, prej Gurit të Bardhë, të shtypur në gjuhën amtare në vjeshtën e vitit 1621", shkroi revista "Leka" në numrin e datës 7 korrik 1930. Ndërsa në qershor-korrik të vitit 1938, po kjo revistë **për punën e Mjedës me veprën e Budit, në faqen 270-275**, shkruan:

"U xû në gojë nder këto dit edhe auktoriteti i D. Ndrë Mjedës. D. Ndrë Mjedja, gramatolog, glotolog e letrar i madh pernjihëri, ká kënë me të sakt një nder antarë mâ kompetentë të Komísis Le-trare shkodrane qi dau unjísimin e gjuhës në temel t'Elbanishtes. Ky kje gjenezi i studimit të tí permbi Budin... E prei Budit e prei popullit, me krahasime me ndimë të dijes së thellë së vetes në lamë glotologjike, xuer pak ka pak e me evolucjone të pádámë



DOM NDRÉ MJEDA



theorin e vet gramatikore edhe orthografíke. Mjerisht e xûni deka pá e lânë të kristalizote plotsisht teorin, e cila me të sakt do t'ishte kënë një hap i mirë kah unjísimi. Nji punues njaq i persosun vonë e vonë ká per të mujtë me ja xânë vendin D. Ndreut."

Në artikullin "Nji vizitë shkencore në Gurin e Bardhë" botuar në "Vullneti i Arbërisë", më 20 qershor 1930, është shkruar: "Prifti katolik Z.D.Ndre Mjedja, i shoqnuem prej deputetit të Dibrës Z. Kol Mjedja, niset sot

Mjeda e vlerësonte Pjetër Budin si poetin e parë shqiptar, si letrar patriot, luftëtarin e zjarrtë për çlirimin kombëtar, ndërsa veprën e tij, një thesar të vërtetë të gjuhës shqipe. Për ribotimin e veprave të Budit ai hartoi projekt ambicioz me të cilin punoi një dhjetëvjeçar.

Mjeda e vlerësonte Pjetër Budin si poetin e parë shqiptar, si letrar patriot, luftëtarin e zjarrtë për çlirimin kombëtar, ndërsa veprën e tij, një thesar të vërtetë të gjuhës shqipe. Për ribotimin e veprave të Budit ai hartoi projekt ambicioz me të cilin punoi një dhjetëvjeçar.

Pas rrugës së lodhshme nëpër Tufinë, Shkallën e Tujanit dhe Qafën e Murrizës, Mjeda arriti në Gur të Bardhë. Në fillim ndaloi te hani i Ibrahim Budit, afër ish-xhamisë së atëhershme, ku u prit sipas zakonit. Piu kafe e hëngri drekë, pushoi për pak orë e bashkë me Ibrahimin shetitën katundin. Në Gur të Bardhë Mjeda gjeti trashëgimtarin e familjes së Pjetër Budit. Takoi atje burra të moshuar, gurabardhas brez pas brezi, të cilët kishin kërkuar Selanikun e Stambollin dhe u tregoi qëllimin e ardhjes së tij nga Shkodra. Rruga e lodhi Mjedën, por ajo nuk i shkoi bosh. Nga Guri i Bardhë njohu më mirë Budin, vërtetoi ato që Budi shkruante në veprën e tij dhe mendoi që "Doktrinën e Krishtenë" ta ribotonte, pasi botimi i fundit njihje vitin 1868. Duke gjurmuar librin treqind vjeçar Mjeda njohu historikun e familjes së Pjetër Budit, traditat e Gurit të Bardhë e të krejt Matit. E rëndësishme për Mjedën ishte se ai vërtetoi vetë, që dialekti i gurabardhësve ishte më shumë se 50 përqind njësoj me atë të librit të Budit. Studimet dhe komentet për doktrinën e Budit të madh Mjeda i bashkoi tok me mbresat nga Guri i Bardhë.

Mbasi zhvilloi intervistat e planifikuara me të moshuar të fshatit malor, më 21 qershor 1930 mori rrugën për kthim, kësaj radhe, në një drejtim tjetër: nëpër luginën e lumit Mat, në drejtimin Jug-Veri, për shkak të terrenit në zbritje. Natën e parë të rrugës së kthimit fjetën në Bershë, kurse natën tjetër e kaluan në Burrel, i cili atëherë sapo ishte bërë qytet. Njohu nga afër në Burrel shtëpinë e princit Xhelal Zogu, Bashkinë, zyrën e rekrutimit, hotele, kafe, restorante e dyqane. Për nder të tij Bashkia shtroi një darkë. Mjeda mori pjesë atë vit në provimet e fundit të vitit shkollor në qytet. U gostit nga mësuesit e nxënësit, të cilët veshur me rroba kuq e zi, i bënë nderime. Ai mbeti i kënaqur nga përgjigjet e nxënësve, i pyeti vetë në histori, lexim etj. Kënaqësi të madhe ndjeu kur nxënësit recituan vjershat e tij. Të nesërmen, pas 9 orësh rrugë të vështirë, arriti në Krujë dhe mori rrugën për Shkodër.

FOTOMESAZH



Megjithëse krahasimi me dy media të rëndësishme botërore është shumë hiperbolik, ideja është shumë e mirë, dhe ndjehemi të mikluar nga Gazmend Kërkuti, një nga mbështetësit e gazetës që ditën e parë. Gazmendi edhe herë të tjera ka përdorur fotografinë për të pasqyruar gazetën, dhe për këtë ai ka gjithë falënderimet tona. E vetmja gjë që i bashkon tri gazetat në foton e mësipërme është "liria". Liria për të shkruar dhe për të pasqyruar të vërtetën dhe të mirën - sigurisht aq sa mundemi. Dhe kjo liri nuk do të ekzistonte pa mbështetjen e lexuesit, kudo qoftë ai. Lexuesit jashtë vendit, sidomos në SHBA, tani mund ta marrin gazetën në PDF duke paguar me PayPal përmes adresës < rrugaarbërit@gmail.com > Një abonim në Europë kushton 10 Euro në vit, ndërsa në SHBA dhe vende të tjera 15 USD. Brenda Shqipërisë dhe Dibër të Madhe pajtimi kushton 600 lekë në vit. Faleminderit që kontribuoni që gazeta "Rruga e Arbërit" të jetë një gazetë e lirë!

...Më ka rrëmbyer gjithçka në këtë amfiteatër natyror. Në gjirin e së cilës kërkoi të vendos njeriun. Edhe pse shiu ka më se dy orë që nuk ndalet. Ndërsa shpendët shtegtarë më ngjallin admirim e respekt.

Nga Dr. SELMAN MEZIU

Gjumi më doli përtueshëm. Dëgjova një zhurmë çudisjellëse. Pikat e shiut shkërmoqeshin në gjamin e dritares. Këto tik take të brishta, përziheshin me cicërima zogjsh. Një si muzikë e dalun prej hojeve të ditës që sapo agonte. Ishte njëzetë gushti. Fërkova sytë dhe u çova në këmbë. Largova perden. Ç'të shihja? Qindra dallëndyshe të radhitura në tela. Dikur këto mbanin shermetet e rrushit thanxë. Ndërsa tani.....

U veshja me shpejtësi. Mora makinën fotografike dhe fillova ta shkrepja pa mbarim. Ndërsa shiu binte kokërmadh, por habitshëm qetësisht. Toka kundërmonte një erë shuarje zjarri. Edhe vetë molla që tanima kishte vetëm gjethe i ish-in shtuar qindra dallëndyshe. Disa lëviznin në drejtime të ndryshme, të tjera vendosura si rruazat në pe, në tre tela që bashkoheshin në shtyllën kryesore. Ato cicëronin, vallëzonin, qetësoheshin. Shiu me sa duket nuk i shqetësoonte. Çfarë ishte, një film, një magji apo një koreografi reale e natyrës vetë? Apo një mbledhje pa protokoll, për shtegtim?

Gëzimi i ardhjes së pikave të shiut, ndoshta iu jepte këtë gjallëri festiviteti. Vera e thatë, vapa përvëluese, pluhuri i mjeteve me katër rrota, me sa duket i kishte mërziur marrëzisht. Iu kishte ndrydhur jetën. Pakësuar lëvizjet, e shtuar vuajtjet e të vegjëlve. Ato duke ndërjer freskinë e erës, lagjen e krahëve në pozicione të dëshiruara nga ato. Ndjenin kënaqësi. Iu gulçonte gëzim, hareja e shumonte cicërimat melodioze.

Ato ndoshta po organizoheshin për të filluar udhëtimin e gjatë. Siç bëjnë të rinjtë e atdheut tim. Bisedojnë me sekserët. Ndërsa tregtarët e mallit të gjallë urdhërojnë. Udhëtimin, me këmbë gjysëm zbathur në livadhe, djerrina, gërxhe e pyje të frikshme. Në karrocëritë e makinave udhëve të ngushta e të fshehta drejt veriut të Europës. Me gomonet tmerrëndjellëse në dallgët shkumëzuese të detrave. Por fatkeqësisht me kokë në torbë. Me anijet pirate njëqind dyqind së bashku në netët e errëta llahtaruese e dallgët kërcënuese e jetëhupse. Ndërsa dallëndyshet fluturojnë të lira. Mbi sipërfaqet ujore kaltërosh të pafundme. Lart në faqet e maleve. Ku po të duan të pushojnë, s'munden. Drurët e ahut, bredhit, pishave, nuk i shikojnë. Se njeriu i ka "vrrarë", iu ka ndaluar funksionet fiziologjike. Iu ka shkaktuar eliminimin fizik. Prandaj iu duhet të fluturojnë plotë lodhje, më shumë. Ndonjë dallëndyshe edhe humbet në këto gërxhe, shpate të gërryera, të shëmtuara. Kështu edhe djemtë, vajzat, familje të tëra vdesin nga lodhja, uria, tradhtia, shpirtligësia e kontrabandistëve. Natyra lëviz e shndërrohet përjetësisht përmes kundërshtish.

Ato duke udhëtuar do të lënë pas një skëterrë natyrore. Ndaj këtë mëngjes ato provojnë rezistencën për një udhëtim të lodhshëm. Dallëndyshet duhet të pushojnë për tu çlodhur e ngrënë diçka. Se ato harxhojnë qindra kuaj fuçi dhe mijëra vat energji. E kjo duhet zëvendësuar. Ndërsa njeriut të shtymun prej vuajtjeve të shpirtit të mërziur e uritur, i duhet të paguaj sa frengu pulën për ikjen shumë larg. Dallëndyshet shtegtuese përgjatë stinëve nuk njohin paranë. Kështu kanë bërë në mijëvjeçarët. Ecin, çlodhen, hanë dhe nisen drejt vendeve të ngrohta. Se këndej ky shi e kjo erë, lajmërojnë ardhjen e dimrit. Shpendi me i afërt i njeriut duhet të vihet për udhë. Për këto e natyrshme. Edhe Da Vinçi kopjoi nga natyra e lëvizjes së krahëve të tyre. Ndaj shkenca ka shtrirje dejesh tek ajo vetë. Gjaku, limfa, lëngu qelizor, përrenjtë, lumenjtë, burimet e ujit, kanë shtratin e tyre të jetës të lëvizjes së përjetshme. Edhe dallëndyshet për të mbijetuar ndjekin këto drejtëza përmes hapësirave të natyrës.

Ndërsa rinia, nuk ikën nga dëbora, hejet e akullit, e veriu që vërshëllen e të ngrinë. Përkundrazi. Dallëndyshet duan ta lënë përkohësisht, ndërsa njerëzit e këtuashëm nuk kanë mundësi jetese ndaj plotë dhimbje amshuese e braktisin përgjithnjë. Nuk ka burime për të

Magjia e një mëngjesi



fituar paranë. Nuk ka organizim. Nuk ka.... Ndaj duhet të ikin. Por jo aty ku ka gjithmonë verë dhe gruri piqet dy herë. Në vendet e ftohta ku temperaturat maksimale nuk i kalojnë dhjetë gradët. Jo në koloni! Por në grupe pa familje. Ose edhe me fëmijën që ende pinë sisë në gjirin e nanës. Të tjerë pa mbushur njëmbëdhjetë vjeç syrgjinosen. Me dhimbje e lotët çurg duke lanun babën e nanën, me duart në gj. Ku mali i mallit dhe i sflitjes së shpirtit ngrihen plagëshumtë në zemrën e tyre. Nuk hapet një dritare për të rrezëlluar dielli, shpresa, por një pus i frikshëm me errësi të kobshme. Ky shpend trupvogël, krahëshpejt miqësohet me njerëz të tjerë. Nën strehë të shtëpive e ballkonit, në korridore e dhoma ngre folenë. I mbledh plot kujdes, zell mjeshtër mirë, baltën, fijet e barit e kashtës në atdheun e dytë. Ndërton folezën për të fjetur, pushuar, bërë vezët e vogla eliptike. E ripërtërin llojin, specien. Me sojin e vetë. Çfarë mrekullie ka në qelizat e natyrës!

Ndërsa njeriu, çiftëzohet e krijon njeriu. Por ai qerrata, i polli mëndja bombën atomike. Shpiku barotin, shigjetën, tankun e kallashnikovin. Lindi e përjetoi, Polpo-

tin, Pinoçetin, Totilën, Hitlerin, Talibanët, Fashizmin, Komunizmin etj. Po përse vallë? Për të zhdukur llojin e vetë. Apo për lavdi personale, apo për tu ushqyer apo... Ndërsa nga dritarja e katit të dytë. Shikoi dallëndyshet që rrinë nën strehën prej rrasash, kapur fort pas murit me këmbëzat e thonjtë e vockël. I shikoj me habi! E aty për aty kërkoi ta shpjegoj. Dhunti e natyrës. Pastërtia e racës. Stërvitje e kalitje për shtegtim. Epërsia gjenetike e llojit. Gumëzhin oborri nga cicërimat e ngrohta e freskisjellëse. Ato si lozonjare, fluturojnë me shpejtësi me rreze të shkurtër nga tubimi i tyre. Pa djallëzi, të qeta, por plot energji, ngrihen fluturojnë, rikthehen e të tjera përgatiten. E kështu pa ndërprerje.

Një funksionim i përsosur. Po tek shoqëria njerëzore përse nuk ka këtë rregullsi. Ne studiojmë në shkolla. Diplomohemi. Përpiqemi të bëhemi politikanë. Por zaten i rrëmbejmë tjetrit kafshatën nga goja. E vrasim, e spiunojmë, e thashethemnojmë, i japim të shtymen kur i ndodh një e papritur. Duam kafënë, rakinë, të hamë, të pimë e për punë s'duam t'ia dimë. Sakaq një dallëndy-

she pranë meje në sqep mbante një krimb. Filloi ta hajë duke lëvizur sqepin. Gjithçka qetësisht. Indiferentisht nga qindra të tjerat që vallëzojnë emocionueshëm. Ato nuk e trazojnë njëra-tjetrën. Sa mirë do të ishte kështu për shqiptarët!

Më ka rrëmbyer gjithçka në këtë amfiteatër natyror. Në gjirin e së cilës kërkoi të vendos njeriun. Edhe pse shiu ka më se dy orë që nuk ndalet. Ndërsa shpendët shtegtar më ngjallin admirim e respekt. Për gjithë festivalin e shfaqur prej tyre me mjeshtëri të përsosur.

Këto tubime do të përsëriten. Me të njëjtin skenar. Në shkurretat bregdetare. Në ishujt me bukurinë e bimëve të shumta e arkitekturën mahnitëseshtirëse. Në direktet e anijeve. Në..... E ato përsëri do të kthehen. Për të lidhur miqësinë, me njerëzit e natyrën e këtuashme. Për të respektuar gjithçka e vazhduar jetën.

Ndërsa atdhetarët e mi do të hanë shkopinj gome nëpër kampe skllëvërish të kohëve moderne. Do t'iu thahet goja e rreshken buzët për një pikë ujë. Do t'iu dridhen buzët e këmbët nga vështrimi i egër i policit, xhandarit, gardianit.... Do të vështrorjnë urryeshëm deri në flijim politikanët satrap, e të korruptuar nga paraja. E ai, atdhetari im do ti duhen vite shume vite, të fitoi pak para. Të mbajë veten gjallë. Por i duhet të kthehet skllav. Do të punojë për të tjerët ku do t'iu thithin gjakun me pambuk. Do ta përçmojnë. Do ta shikojnë me urrejtje e trajtojnë si mos më keq. Sigurisht në dhe të huaj. Ai nuk kthehet më. Fëmijët e tij në rast se do të krijojnë familje do të flasin ndryshe. Do të mendojnë e veprojnë si mëmëdheu i tyre. E ti do të urrehesh prej kohës që të përgatiti, historia bashkëkohëse e politika bukëshkalë.

Ai shpend i shpejtë cicërim melodioz e gazmor në shtëpinë tënde gërmadhë do të gjejë një qoshe për të ndërtuar folenë, por gjithmonë lart. Larg armiqve. Larg gjakpirësve të huaj. Ndërsa ti, unë, ai, ata, vendbanimin do ta keni larg dheut tuaj të ëmbël, të dashur, por edhe mumjeve të zeza politike. Ky është fati juaj i zi.



Z.Ferit Keputa është dalluar si intelektual, njeri i drejte familjar, i perkushtuar e puntor...

Ferit Këputa, studiues i përkushtuar i historisë

Nga RENATO TOTRAKU

Ferit Keputa u lind me 24 shtator 1935 ne fshatin Laç te rrethit te Matit ne nje familje me tradita nacionaliste. I ati i tij Aliu ishte ushtarak i perkushtuar ndaj Monarkise Shqiptare dhe sherbeu ne oborrin Mbretoror ne Tirane deri ne vitin 1939, ku prane mbante gjithmone familjen e tij. Me pushtimin fashist te Shqiperise familja e Ali Keputes u rikthye ne fshatin e Laçit, ku Feriti i vogel u rrit duke marre virtytet me te mira prej tyre. Shkollen fillore e kreu ne fshatin e lindjes ne vitin 1949, ndersa sistemin 7 vjecar e permbylli ne Shkoder ne vitin 1952, ku gjate veres se ketij viti kreu nje kurs 2 mujor dhe ne shtator filloi pune mesues ne shkollen e Bruçit. Pas nje viti emerohet ne Batër, afer Burrelit, ku le gjurme te femijet dhe komuniteti i atysem per pune te perkushtuar, duke u bere shembull edhe ne shtypin e kohes. Keshtu, ne gazeten "Bashkimi" te dates 28 mars 1954 shefi i arsimit te Qarkut Diber do te shkruante artikullin: "Kryemesuesi i Batrës, Ferit Këputa, shembull ne te gjithë rrethin e Matit".

Po ne kete vit martohet me Xharie Gjestilen me te cilen linden dhe rriten 4 femije: Gëzim, Florën, Vjollcën dhe Afërditën, duke i arsimuar dhe edukuar me durimin dhe kembenguljen per te perballuar veshtiresite e jetes.

Krahas mesimes, te mesues Feriti vlonte deshira pe ruajtjen dhe trashegimine kulturore te treves se Matit. Pasi kthehet ne shkollen e Bruçit ne vitin 1954 merret me ngritjen e grupit te pare te valleve per vajza ne Mat dhe merr pjese ne festivalin e qarkut, duke zene vend nderi. Sistemi qeverises i kohes, i cili kishte filluar te aplikonte luften e klasave, nuk harronte origjinen familjare nacionaliste te Feritit, ndaj vazhdimisht e qarkullonte ne fshatra te ndryshem, duke e pasur ate nen veshgim. Me 1955 dergohet mesues ne Rrethe Baz, ku punoi per 5 vite. Gjate kesaj kohe u vjen ne ndihme ekipit te arkeologeve te drejtuar nga Selim Islami, Frano Prendi, Zhaneta Andrea, qe punonin ne kete territor, duke i çuar ata ne shume pika me vlere. Me deshiren per ta pervesuar sa me mire profesionin e mesuesit, regjistrohet me korrespondence ne shkollën pedagogjike te Tiranës, ku mbaroi 4 klase per dy vite dhe ne vazhim me 1965 mbaroi Insitutin 3 vjecar "Aleksander Xhuvani" ne Tirane ne degen Gjuhe-Histori, gjithnje pa shkeputje nga puna. Ne vitin 1967, kur ishte mesues ne fshatrat e Martaneshit, fillon studimet ne fakultetin e Histori-Filologjise, dega Gjuhe dhe Letersi Shqipe. Po ne kete vit ngriti ansamblin me 54 instrumenta muzikore, me i madhi ne Mat dhe ne Shqiperi. Me 1979 permbyll shtegtimet neper shkollat e fshatrave te Matit dhe emerohet pergjegjes i shtepise se kultures ne Bruç. Gjate kesaj kohe ai punon me perkushtim si studiues, krijues dhe organizator i aktiviteteve kulturore, duke dhene shfaqje ne shume ndermarrje dhe kooperativave bujqesore si ne Burrel, Ulez, Kraste, Kurbnesh, Perlat, Bate, Cëruje, Komësi etj., dhe duke i regjistruar materialet folklorike te Ansambllit te Laç-Bruçit ne 3 emisione folklorike ne Televizionin Shqiptar. Ne kete ansambel folklorik, krahas kengeve dhe valleve, i vecante ishte dhe formacioni i vajzave, qe luanin me instrumentin e çiftelise.

Krahas punes organizative Feriti krijoi dhe kenge si *Drita elektrike, Lokemadhja, Kenge kurbeti, Moj lulja e trandafil, Syni i zi* e shume te tjera, te cilat u vleresuan ne festivalet kombetare ne Vlore, Elbasan,



Gjirokastr, Tirane e ne shume skena te tjera. Me ardhjen e ndryshimeve demokratike ne fillim te viteve '90 bashke me femijet e tij u rreshtua ne frontin e atyre qe kerkonin rrezimin e diktatures komuniste dhe lejimin e lirise te te drejtave te njeriut. Me daljen ne pension ne vitin 1992 merret ne sistemin e shenimeve te bera nder vite mbi figura historike qe lane gjurme dhe ndikuan ne jeten e matjanit e mbare kombit shqiptar, si dhe me te dhena qe hidhnin drite e saktesonin historine e shtremberuar nga historianet e politizuar te monizit. Ne vitin 1994 le fshatin e lindjes dhe vendoset bashke me femijet ne qytetin e Burrelit, ku intensifikon kontakte me bartes te fakteve dhe ngjarjeve te pathena historike, duke botuar njeri pas tjetrit libra studimore, monografi e studime historike

Ne vitin 2000 boton "*Mati ne shek. XX*", ku ve ne dukje vepren historike te matjaneve qe nga lufterat per pavaresi dhe çlirimin nga pushtuesit e huaj. Kete liber do ta ribotoje ne 2002, duke e plotesuar me te dhena e fakte te reja.

Po ne 2002 boton librin "*Ismail Terziu, Shqipe Mati*". Ky liber monografik i kushtohet jetes dhe vepres se patriotit nga Lisi Ismail Terziu. Ne vitin 2003 boton "*Arsimi e Kultura ne Mat*" veshtrim historik, ku behet fjale per fillimin e zhvillimin e arsimit dhe kontributin e mesuesve per edukimin arsimor dhe patriotik te brezave te rinj. Sherbimi "*Shendetesor ne Mat - Veshtrim Historik*" eshte botim i vitit 2005, ku pershkruan rruget e zhvillimit shendetesor ne Mat. Ne 2007 boton librin "*Vendorigjina e Kastriotëve eshte Mati*". Ketu studiuesi Ferit Keputa, bazuar ne fakte arkivore rreshton te dhenat qe pranojne se fisi i Kastriotëve eshte nga Mati. Po ne 2007 boton librin "*Matjanet ne Luften e dyte Boterore*", ku na sjell te dhena mbi ngjarje dhe figura te shfaqura gjurmet dhe kontributet patriotike te te cileve ishin mohuar nga gjate periudhes moniste. Libri i tij i fundit ne radhe eshte "*Mati ne Kulmet e Historise Kombetare*" botuar ne vitin 2012, ku permbledhtas dhe me saktesi historike rreshtohen figura dhe ngjarje qe kane lidhje me Matin e historine e tij. Ndersa libri qe terhoqi vemendjen me prezencene studiuveve te Qendres se Studimeve Albanologjike eshte "*Mati dhe Skenderbeu*" botuar ne 2010. Ne kete liber gershetohen ne menyre shkencore te dhenat arkivore me deshmite gojore te popullit te Matit. Promovimi i ketij libri u be ne nje vend historik prane Stelushit, ne permbyllje te nje ekspedite 2 ditore te drejtuar nga studiuesi Ferit Keputa

Ferit Këputa krijoi dhe këngë si *Drita elektrike, Lokemadhja, Këngë kurbeti, Moj lulja e trandafil, Syni i zi* e shumë të tjera, të cilat u vlerësuan në festivalet kombëtare në Vlorë, Elbasan, Gjirokastrë, Tiranë e në shumë skena të tjera. Studiuesi Ferit Keputa është autor i dhjetëra artikujve studimore te botuar ne shtypin periodik si gazetate "Republika", "Atdheu", "55", "Standart", "Mati", "Tirana Observer", "Revista Emathia"...

me personalitete te fushes akademike dhe historiane te periudhes se mesjetes dhe studiues, shkrimtare e poete matjane. Studiuesi Ferit Keputa eshte autor i dhjetëra artikujve studimore te botuar ne shtypin periodik si gazetate "Republika", "Atdheu", "55", "Standart", "Mati", "Tirana Observer", "Revista Emathia" etj. Shkrimet e tij ngrene zerin mbi saktesimin e ngjarjeve historike te shtremberuar nga pseudo-historianet qe per servilizma dhe qellime perfitimesh politike hodhen balte mbi figura nacionaliste dhe krahina e siç ishte ajo e Matit.

Po ne perfaqesimin e studiuesit dhe njohesit te mire te histories se krahines se Matit merr pjese ne debate televizive te zhvilluara ne "Mat Televizion", "Mt + Leza" etj., duke u bere pjese e paneleve televizive, ku shtrohen debate historike dhe flitet per figura te shquara. Ndryshimet demokratike bene qe te rikthehet ne Atdhe Familja Mbretorore dhe te kerkohet e te vihet ne vend dinjiteti dhe kontributet e shquara te Mbretit Zogu I ne shtetformimin dhe konsolidimin e shtetit shqiptar. Ne vitin 1998 studiuesi Ferit Keputa bashke me studiues te tjere e simpatizante te punes dhe vepres se Mbretit Zogu I themeluan shoqaten atdhetare "Ahmet Zogu" me qender ne Burrel. Kjo shoqate ka luajtur rol te rendesishem ne njohjen popullarizimin e veprave te Mbretit Zog I dhe te figurave te tjera qe dhane jeten nen moton "Atdheu mbi te gjitha". E drejtuar nga Z.Ferit Keputa, kjo shoqate ka organizuar aktivitetet te shumta perkujtimore. Zoti Ferit

dhe zoterinjte Sulejman Cakoni, Enver Hasa, Murat Basha, Lufter Pepmarku e shume te tjere nepermjet shkrimeve publicistike e konferencave shkencore kane sjelle fakte dhe kane saktësuar te dhena ne sherbim te rishkrimit te historise se gjysmes se dyte te shek. XX.

Ne kete kontekst jane bere propozime dhe jane miratuar nga institucionet perkatese kerkesa per emertime sheshesh dhe rruges me emrin e Mbretit Zog I dhe pjestareve te tjere te familjes mbretorore. Me kerkesen e kesaj shoqate keshilli i Bashkise Burel miratoi emertimin e sheshit "Ahmet Zogu" para bashkise emertimin e parkut te qytetit te Burrelit me emrin Nena Mbreteshe Geraldine dhe vendosjen e monumentit Zog I ne nje nga sheshet kryesore te qytetit te Burrelit. Me kerkesa te kesaj shoqate Bashkia e Tiranës emertoi Bulevardin Zogu i I ku ne kuadrin e 100-vjetorit te Shpalljes se Pavarsise ne krye te bulevardit u vendos monumenti i Mbretit Zog I. Kudo ku ka punuar dhe jetuar Z.Ferit Keputa eshte dalluar si intelektual, njeri i drejte familjar, i perkushtuar e puntor e u shkon puneve deri ne fund. Per pune te mire ne edukimin mesimor te femijeve eshte vlersuar me mirnjohje nga komuna Martanesh.

Per shkrimet e botuara ne revisten "Emathia" nga grupi botues eshte vlersuar me "Penda Budi 2010". Ne kuadrin e 100 vjetorit te Shpalljes se Pavarsise Keshilli i Bashkise Burrel e vlerson ate me titullin "Qytetar Nderi" me motivacionin "Per kontributin e dhene ne krijimin dhe promovimin e vlerave kulturore si dhe per botimin e shume librave mbi historine e Matit e matjaneve ne te gjitha fushat". Se fundmi, ne bashkepunim me shoqaten patriotike kulturore dhe institutin e historise pergatiti sesionin shkencor me rastin e 610 vjetorit te lindjes se heroit kombetar Gjergj Kastrioti Skenderbeu. Ne proces botimi eshte edhe libri per vendlinjen e tij ku lindi dhe u rrit.

Sot mes miqve dhe qytetareve matjane e te aferme e femijeve te tij, niperve e mbesave Ferit Keputa ndihet i vlersuar me keto tituj. Ndihet i vlersuar, sepse shoqeria ne kete rast respekton personin qe nuk rendi pas punes vetem per nje rroge per te mekembur familjen e tij, por vlerson intelektualin qe punon me perkushtim e pasion, i cili la gjurme kudo me punen qe beri ne edukimin arsimor te brezave, zhvillimin e jetes kulturore dhe studimet e shumta ne fushen e historise. I uroj paç jete sa me te gjate dhe shendet te plote. Mendja dhe dora e tij mos pushofshin kurre ne dobi te historiste dhe treves dhe popullit te Matit e me gjere.

OFROJMË

redaktime - korrigjime
- ftesa - fletëpalosje
- fotokopje - kartvizita
- printime - lidhje libri duke filluar nga 1 kopje e vetme!
Çmime të favorshme dhe shpejtësi!

Telefono: 068 65 08 441

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit

<rrugaearbërit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:

Në Shqipëri: 600 lekë.

Në Europë: 10 Euro.

Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Hilmi Sadiku, një shkëmb i zbritur nga vendlindja e tij

Në qoftë se do ta mendonim historinë e kësaj shkolle, mësuesit e saj vetëm mësimdhënës, vetëm rrogëtar, do të gabonim rëndë.

Që nga mësuesi i saj i parë, Haki Sharofi, pjesëmarrës aktiv në të gjithë jetën politike administrative, sportive dhe artistike të qytetit, do të vazhdojë me emra të tjerë, që do të jenë pro dhe kundra regjimit të Zogut, do të vazhdojë me ato emra që qenë aktiv dhe morën pjesë në luftën antifashiste nacional-çlirimtare, me ata që kundërshtuan regjimin komunist gjër me jetën e tyre.

I radhitur ndër emrat e tyre, është edhe ai i mësuesit dhe ish-drejtorit të kësaj shkolle, Hilmi Sadiku. Ai drejtoi këtë shkollë për disa vjet me radhë, në vitet 1962-66.

Tradita e familjes, shkollimi në normalen e Elbasanit, përfundimi i studimeve të larta në degën e gjuhë-historisë, mbi të gjitha, kureshtja që e shoqëroi dhe vendosmëria për të thënë të vërtetën, e shoqëroi gjithë jetën, që të punonte shumë për ato të vërteta, që gabuan rrugë dhe për ato që ndoshta humbën krejt.

Për ato probleme që e shqetësuan seriozisht, Hilmi Sadiku, në këndellje për dritë të re, asnjëherë nuk priti që "të vijë koha". Si mësues i gjuhës shqipe, punoi aq fort, ashtu siç punoi edhe në profesionin tjetër, në atë të historianit.

Ndjësia e vendit që e lindi, të vërtetat e dëgjura dhe kundërtia e tyre e servirur, nuk dihet se ku, bënë që Hilmi Sadiku, të punojë me aq pasion e seriozitet, që brezin e tij, dhe ata që do të vijnë, koha mos t'i fuste në kurthin e dhembshurisë nesër.

Kur punoi si mësues në këtë shkollë, puna që e shumëfishonte, sepse shkolla ishte 12-vjeçare. Ishte një përvojë e re dhe kërkonte shumë angazhim, përgjegjësi dhe ishte koha për të vendosur përvoja të reja. Jemi shprehur se koha mësuesit i kërkonte që të mos ishte vetëm mësues, por qytetar, që ndiqte të gjitha zhvillimet politike. Për nga natyra, mësuesi është shumë i ndjeshëm dhe mjaft korrekt e i drejtë në konceptimin dhe përcjelljen e tyre, e dobi të komunitetit ku ai jeton.

Kjo është arsyeja që shumë mësues kanë lënë gjurmët e tyre, pothuaj në të gjitha fushat e jetës. E parë në këndvështrimin shumëplanësh, Hilmi Sadiku nuk që për asnjë moment vetëm mësues.

Kujtimi mbi vendlindjen e tij, Gollobordën, e ftoi gjithmonë që të thurte ndër gjegjen krenare për të gjithë gollobordasit dhe për ata që e dinin lavdinë e atij vendi. Kjo për shumë arsye, por më kryesorja, ishte për t'iu



kundërvënë shpirtave të natës së pandërgjegjshme, mendimit absurd të trajtimit të Gollobordës, si minoritet maqedonas madje më keq akoma, të gollobordasve si

maqedonas.

Studimet e tij disa vjeçare, fjala e folur nëpër takime, konferenca dhe në shtypin e shkruar, këmbëngulja në të kundërtën, do t'i kushtonte shumë kohë, por mbi të gjitha, me kundërshtarët e të drejtës së tij dhe me mbrojtësit e tezës së kundërt.

Si një shkëmb i zbritur nga vendlindja e tij, kurrë nuk pushoi së argumentuari e vërtetuari shkencërisht, se aty, në rrënjët e hershme të Gollobordës, kanë qenë e mbeten gjurmët arbnore shqiptare të së shkuarës dhe të së ardhmes.

Trajtimi shkencor, historik, gjuhësor, etnokulturor, morfologjik i të vërtetës së fjalës së tij, i bëri të pashpresë dhe fatpadalës edhe kur e tregoi me gisht plagën e hapur edhe kur i tregoi me emër ata që u munduan të ndezin zjarrin me thëngjij të mbuluar, dhe ata që donin të notonin në ujera të ndenjura e të qelbura të kohës.

Jo njëherë, por sa herë që vijnë fushatat elektorale, se nga mbijnë e se nga shfaqen, por gjithmonë gjendet dikush që "i qan zemra për Gollobordën e për gollobordasit" dhe herë na i nxjerrin maqedonas, herë bullgarë, pale pastaj kur na iu dogj shpirti edhe Bollanos së grekërve.

E shoqëruar vetëm me memecërinë time thashë "Po të jetë e vërtetë se dëgjojnë të vdekurit, i pari tani çohet Hilmi Sadiku dhe jua zen derën me shkop, për këto marrëzira që po tregoni!"

Për të gjitha të vërtetat e folura, të mbrojtura me aq pasion e vërtetësi, Hilmi Sadiku thërret edhe nga varri se edhe kur vitet hyjnë në mes, gjaku është ai që kërkon lidhje. Dhe Golloborda e tij, ai monument natyror që vete Zoti ua dhuroi, foli në gjuhën shqipe sa vetë jeta dhe gjer sot. Sepse shqipja e vjetër indoeuropiane që për mësuesin e saj, për ish-mësuesin e kësaj shkolle, shenje e prejardhjes mbretërore, për vetë kombin që e foli.

■ Si një shkëmb i zbritur nga vendlindja e tij, kurrë nuk pushoi së argumentuari e vërtetuari shkencërisht, se aty, në rrënjët e hershme të Gollobordës, kanë qenë e mbeten gjurmët arbnore shqiptare të së shkuarës dhe të së ardhmes.

■ Trajtimi shkencor, historik, gjuhësor, etnokulturor, morfologjik i të vërtetës së fjalës së tij, i bëri të pashpresë dhe fatpadalës edhe kur e tregoi me gisht plagën e hapur edhe kur i tregoi me emër ata që u munduan të ndezin zjarrin me thëngjij të mbuluar, dhe ata që donin të notonin në ujera të ndenjura e të qelbura të kohës.

EMRIE SKUKA

100 vjet në 36 shkronja.

BOTIME M & B

100 vjet në 36 Shkronja. ■ EMRIE SKUKA

Kolektivi i shkollës "Demir Gashi", 2014

Profil

Një grua me zemer të madhe

Nga MEHDI DEMA

Nazmie e quajnë, vajzë Dibre, nga Majtara që e lindi dhe e rriti, por që vajzëria e saj zgjati jo shumë; në moshën katërbëdhjetëvjeçare i u desh të fillonte jetën në një tjetër familje, për të mos u larguar më, për gjithë jetën, prej saj. Tek Ruset e Homeshit, Nazmija, do ta mbushte shtëpinë plot me nipër e mbesa. Nga moshë e re dhe fiziku i saj, ndoshta edhe mund ta kenë paragjykuar atë vajzë të re, trup vogël, e imet, e heshtur dhe pak fjalë, por e zgjuar. -“A do të mund të rrisë fëmijë e të mbajë familje kjo vajzë?” - Ndoshta do të kenë diskutuar, mes tyre edhe të afërmit e të shoqit. Por, më plaku i shtëpisë, vjehri i saj Demiri, të cilin jeta e kish detyruar të mërgojë, i njohur me kulturën e Lionit dhe të Stambollit, do t’u ketë kujtuar të tjerëve se: “Edhe foriri është i vogël, por vlerën e ka të madhe”. Dhe... vitet që pasuan e vërtetuan këtë. Nazmija i dhuroi familjes së re plot djem e vajza, si për t’ju treguar “paragjykesve” se qenë gabuar. Ajo, me mundësitë që i jepte koha, rriti plot fëmijë të shëndetshëm, moralisht dhe fizikisht. I rriti ata me shumë mundime e sakrificë, me fukarallëk, por me nder. Me ato pak mundësi që i lejonte ekonomia e varfër, si një nikoqire e mirë, atë ushqim të kursyer, mjaftohej që fëmijët ta merrnin me vlera optimale higjieno-ushqimore. Bënte kujdes që ushqimet të ishin sa më natyrale, direkt nga kopshti i saj, të cilin e përgatiste me shumë kujdes, që nga mbjellja deri në prodhim, qumështi natyral e i pastër i lopës, që e trajtonte si nënë e dytë e fëmijëve të saj, dhe deri tek vezët e freskëta të shpendëve shtëpiakë.

Por, ajo që nënë e mirë jo vetëm për fëmijët e saj. I dhimbeshin dhe bënte kujdes maksimal, me sa mundej, edhe për pjesëtarët e tjerë të familjes, edhe për fëmijët e të afërmeve; madje respekti i saj i kalonte edhe këta kufij.

Rrugë ime, për të shkuar në punë, kalonte pranë shtëpisë së nënë Nazmies. Më bënte përshtypje ajo pastërti shembullore e baçes me shumë pemë, si në lloje dhe në sasi, që gjallërohej dallueshëm nga shtëpitë tjera të lagjes edhe nga pulat, rosat e patat, që ajo mirërriste. Të binte në sy se ai ambient fshati, ku s’mungonin shpendë e bagëti, nuk mbetej asnjëherë i ndotur; çdo gjë në kohën dhe vendin e vet. Ta kish ënda të uleshe në atë barin e pastër të baçes, si një shilte e madhe e odave dibrane, dhe, të harroje lodhjen.

Në periudhën e kooperativave bujqësore, të sistemit socialist, shpendët shtëpiakë, deri në kohën kur u bë kufizimi i tyre, ishin një e ardhur, ndonëse modeste, por me vlera të konsiderueshme, për të ushqyer familjen. Ndoshta kujdesi i nënë Nazmijes për lopën, “nëna e familjes” siç quhej atëherë, duke e trajtuar me kujdes, në ato



Sot nënë Nazmija gëzon e lumtur mundin, djersën, sakrificën, zemërbardhësinë e saj; e bekuar nga Zoti, me fëmijë, nipër e mbesa të edukuar si ajo vetë; të suksesshëm në jetë, të respektuar kudo ...

kushte detyrimisht të kufizuara nga sistemi, si dhe për shpendët shtëpiakë, që një ndër faktorët determinant, që fëmijët e saj të rriteshin të shëndetshëm mendor e moralë. Mësuesit dhe mësueset e fëmijëve të nënë Nazmies, ruanin opinionet më të mira, si për rezultate të larta në mësim, në sjelljen e tyre shembullore dhe për mirëkujdesjen e saj, që nga edukimi i mirë deri tek ajo veshja e pakët, por e mbajtur pastër e me kujdes. Duke sjellë në kujtesë vite të shkuara, tek kujtimet e rezervuara për nënë Nazmien, më duket sikur shoh tek ajo një “Nënë Terezë”. Në ato vite, mjaft të mundimshme për mua; kur shërbeja mbi dy orë rrugë në këmbë larg nga vendbanimit, kur dhe dimrat ishin jo shumë bujarë, krahasuar me tani, pata një goditje fizike nga nervi shiatik. Një ditë, prej ditësh, nënë Nazmies, tek po kaloja në rrugën tangent me shtëpinë e saj, i bën përshtypje se unë nuk kisha atë të ecurin e zakonshëm prej djaloshi, por si i mpirë, prej një të moshuari. Interesohej, me shumë takt, respekt e keqardhje, për shëndetin tim. Pyet time shoqe, të cilën e takonte shpesh, kur shoqëronte të vegjlit e saj për në shkollë, se çfarë kisha unë që s’i qesh dukur mirë në të ecur. Ajo i shpjegon për shqetësimin që kisha prej disa ditësh (Do të desha të shtoj këtu si parantez, ndoshta brezat e tanishëm mund të mos na kuptojnë drejt, por ne atëherë sakrifikonim tej mase për punën, nuk shkëputeshim lehtë prej saj; qemë shumë të përkushtuar). Dhe nënë Nazmija, e cila ndiente dhimbje për këdo që kish probleme, si për familjarët e vet, e kish lodhur mendjen se ç’mund të kontribuonte pozitivisht për shqetësimin tim. E ç’mund të bënte ajo me zemrën e saj të madhe, veçse ti lutej Zotit për shërim të shpejtë? Por, me bujarinë që e karakterizonte, kish menduar se mund të ndikonin pozitivisht vezët e freskëta të shpendëve,

mirëslljlla duhet vlerësuar me mirëslljllje. Për mua ai kontribut modest i nënë Nazmies, në atë kohë, vlen sa shumë miliona lekë dhe mirënjohja e respekti për të, qenë dhe mbeten të pashlyeshëm. Duke hedhur në letër këto pak rreshta, kujtim i së kaluarës, ndiej një farë lehtësimi, se po mundohem të bëj sado pak nga obligimi im, në respekt të një gruaje zonjë, me trup të vogël e zemer të madhe.

Mirësia që e karakterizon atë, nuk mbeti e pa u shpërblyer.

Sot ajo gëzon e lumtur mjaft mirë, mundin, djersën, sakrificën, zemërbardhësinë e saj; e bekuar nga Zoti, me fëmijë, nipër e mbesa të edukuar si ajo vetë; të suksesshëm në jetë, të respektuar kudo për punën dhe respektin ndaj të tjerëve. Dhe kjo nuk është rastësi, por shpërblim i bekimit të nënës së tyre, për kujdesin dhe dashurinë e pafund, që ata tregojnë për nënën që i rriti dhe edukoi me cilësitë më të mira. Ndihej sinqerisht mirë, kur shoh fëmijët e kësaj nëne bujare, të realizuar ashtu siç desh ajo.

Ndaj, nënë Nazmie, me plot gojën të them, se munda dhe sakrificat, nuk të kanë shkuar kot. Ji e lumtur nënë Nazmie!

Të rrosh e shëndetshme dhe sa më gjatë, për të shijuar mirësitë që vet gatove!

të freskëta nga shpendët e saj, duke sakrifikuar nga ushqimi i fëmijëve të vet. Ishte koha e kufizimeve drastike nga sistemi i atëherëshëm mbi pronën personale; që e ndaluar të mbaje bagëti. Vitet e fundit që ndaluar të mbaje edhe shpendë që të dalin jashtë banese, sepse “dëmtonin” pronën socialiste. Sot tingëllon si barcaletë e pabesueshme, të tregosh se ndonjë pushtetar i zellshëm pati qëlluar edhe me armë mbi pulat që gjendeshin jashtë oborrit të shtëpisë. Qe një realitet. Ky kufizim e bënte të vështirë mirërritjen e shpendëve shtëpiake. Ndaj unë dhe ime shoqe, e ndienim veten të zënë ngushtë; nga njëra anë na dhimbsej për sakrificën që bënte nënë Nazmija, nga ana tjetër, ajo do të ndihej keq po të mos pranonim kontributin e saj të sinqertë.

Mirëslljlla duhet vlerësuar me mirëslljllje. Për mua ai kontribut modest i nënë Nazmies, në atë kohë, vlen sa shumë miliona lekë dhe mirënjohja e respekti për të, qenë dhe mbeten të pashlyeshëm. Duke hedhur në letër këto pak rreshta, kujtim i së kaluarës, ndiej një farë lehtësimi, se po mundohem të bëj sado pak nga obligimi im, në respekt të një gruaje zonjë, me trup të vogël e zemer të madhe.

Mirësia që e karakterizon atë, nuk mbeti e pa u shpërblyer.

Sot ajo gëzon e lumtur mjaft mirë, mundin, djersën, sakrificën, zemërbardhësinë e saj; e bekuar nga Zoti, me fëmijë, nipër e mbesa të edukuar si ajo vetë; të suksesshëm në jetë, të respektuar kudo për punën dhe respektin ndaj të tjerëve. Dhe kjo nuk është rastësi, por shpërblim i bekimit të nënës së tyre, për kujdesin dhe dashurinë e pafund, që ata tregojnë për nënën që i rriti dhe edukoi me cilësitë më të mira. Ndihej sinqerisht mirë, kur shoh fëmijët e kësaj nëne bujare, të realizuar ashtu siç desh ajo.

Ndaj, nënë Nazmie, me plot gojën të them, se munda dhe sakrificat, nuk të kanë shkuar kot. Ji e lumtur nënë Nazmie!

Të rrosh e shëndetshme dhe sa më gjatë, për të shijuar mirësitë që vet gatove!

Botime

Të mos harrojmë, duke kujtuar dhe shkruar për njerëzit

Nga SAKIP CAMI

“Memoria historike e kombit”. -Ky është titullikuptimplotë i librit më të ri të gazetarit e shkrimtarit mirënjohur Halil Rama. Libri është padyshim dhurata më e mirë që autori u bën lexuesve të tij, fillimvitin e ri 2016.

Pas “Testamentit të Atdeshdashurisë” vjen jo rastësisht “Memoria historike e kombit”. Brezat duhet të njohin historinë, në të kundërt historia do të harrohet. Kurrë nuk duhet të harrojmë. Harresa është dëmi më i madh për ndërgjegjen e një kombi. Kush një të kaluarën, projektin edhe të ardhmen. Ky është mesazhi kryesor i këtij libri me monografi, personazhe, personalitete, kujtime dhe recension.

Kryeredaktori i gazetës “Veterani”, Halil Rama, pas njëhulumtimi 15 vjeçar në historinë e popullit tonë, pas libret të suksesshëm për 20 vjetorin e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve Luftës Antifashiste të Popullit Shqiptar (OBVL) dhe për Heroin e Popullit dhe Nderin e Kombit, GjeneralRahman Parllaku, për patriotin dhe filozosfin popullor dibran, Dine Hoxha e kompozitorin e tangos shqiptare, Muharrem Xhediku, vjen sërish me një kontribut tjetër për historinë e lavdishme të kombit tonë, aq shumë të vuajtur etë lodhur nga luftërat dhe grackat e Fuqive të Mëdha.

Brezat që vijnë duhet ta dinë mirë se nuk ka patur NATO dhe BE me të cilët bashkëpunojmë sot. Historia jonë kombëtare ka kaluar nëpërmjet vështirësish të panumërta Memoria historike e kombit dhe të pashembullta. Një komb dhe një popull i vogël në numër si kombi ynë ka mbijetuar vetëm nëpërmjet sakrificave dhe luftërave. Si gjatë Luftës së I Botërore ashtuedhe gjatë Luftës së II Botërore Shqipëria është rënditur nëkraht të aleatëve, në krahu e duhur, me fitimtarët. Është dërdhur shumë gjak, që nuk duhet injoruar sepse është gjaku i baballarëve dhe gjyshërve tanë.

Në reportazhin “Memoria historike e kombit” që është edhe titulli i tërë librit, autori tregon se në Borovën martire 72 vjet më parë, nazistët masakruan gjithë banorët e fshatit Borovë. Pushtuesit nuk kursyen as gratë shtatzëna dhe foshnjat në djep. Fshati i vogël, vetëm 5 km larg Ersekës, vijon ende të jetë një dëshmi e gjallë historike. Grupi i veteranëve të OBVL dhe i të mbijetuarve të një prej masakrave më të mëdha në Shqipëri kryejnë homazhenë varrezat e 107 martirëve të Borovës. Vendorsin kurora melule, bëjnë foto tek partizani i Borovës, tek varrezat masivetë të rënëve. Kërkojnë të vizitojnë muzeun e Borovës, por Muzeu i Borovës është i mbyllur, në rikonstrukcion.

Ndoshta është koha kur muze të tilla të ristrukturohen të jenë të hapura për publikun në çdo orë dhe në çdo ditë. Mëthoni të nderuar lexues se në çfarë vendi të Europës apo edhe të Botës i gjen muzetë e luftës të mbyllura, lapidarët të thyer, veteranët të harruar!!! Është koha që gjërat të vemë në vend. Më pak shpenzime për salltanete pushtetarësh dhe më shumë për njerëzit që sakrifikuar dhe sakrifikojnë për Shqipërinë dhe Kosovën, për kombin shqiptar.

Në këtë libër do të gjejmë protagonistët e Luftës së Dibrës kundër serbve në vitin 1920, protagonistët e OBVL Rahman Parllaku dhe Skënder Malindi, që edhe mbi 95 vjetmbi supe, edhe të burgosur në burgun komunist, përveç internimit fashist dhe plagëve në luftë marrin përsipër tutregojnë brezave vendet dhe ngjarjet historike të Luftës Anti-



fashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar.

Një vend të veçantë gjejnë të përndjekurit dhe të persekutuuarit politikë si Mark Shllaku, Bajram Ndreu, pinjollit i familjes NDREU të Zall Dardhës, rrëfimi për kalvarin e familjes Shtylla që u përfshinë në të pabërën e bombës në ambasadën sovjetike etj.

Besim Ndrejoni rrëfen vetë si i intervistuar dhe si President i Unionit të të Përndjekurve politikë se kjoshtresë e rëndësishme e shoqërisë shqiptare po bën 25 vjetdemokraci dhe nuk po e gjen vehten e saj, e përndjekurësh, por këtë herë nga politikanët e rinjtë pas viteve 90, që kurrë sesi nuk mund ti quash demokratë.

Me mjaft mjeshtri artistike dhe mjete shprehëse autori sjell profilin e “skenderbegasit” nga Arrasi i Çidh-nës, Lavdrim Krashi, i ngjitur me dinjitet në administratën e bashkisë së Londrës, si dhe recensionin për librin e Hasan Moglicës nga Oksh-tuni që përshfaqet si frymëzues i kryeministrit kanadez.

Libri i redaktuar me përkujdesje maksimale nga Qamil Xhani – Kryeredaktor i gazetës “Koha Jonë”, përmbledh edhe shkrime të autorit për personalitete të letërsisë e të kulturës shqiptare si Teodor Laço, Shaqir Rexhvelaj, Shefki Karadaku, Skënder Cala, Lutfi Hanku, Naim Berisha, për emblemën e sportitshqiptar Isa Tare, studimin për librin e Diplomati Dr. Arjan Starova për jetën e presidentit amerikan Ronald Regan, për personalitetin e mjekësisë ushtarake shqiptare, Prof. Dr. Islam Dauti, për këngëtarin e ri dhe të talentuar Dritan Jashari etj.

Gazetaria dhe hulumtimi e kanë ndihmuar autorin H. Rama që nëpërmjet personazheve jetësore të futet fuqimisht dhe estetikisht tek jeta dhe historia shqiptare.

Unë do ta ftoj lexuesin që ta lexojë këtë libër sepse do të gjejë pjesë nga jeta e tij, nga jeta jonë që duhet kujtuar dhe jetuar realist me gjithë përfshirje dhe me senspozitiv, sepse vetëm kështu mund të arrijmë atje ku duam të arrijmë, të shkojmë në Europën e qytetëruar si shqiptarë të qytetëruar.

Nga ZABIT LLESHI

Idetë për mësim e shkollë shqipe në Grykën e Vogël u propoganduan pas betejës së Drinit 1844 ku sic njihet po në këtë vit u botua Abetarja e Naum Veqilharxhit. Beteja e Drinit tregoi se Perandoria turke po jepte shenja dobësie si rezultat i kundërshtimit të reformave të Tanzimatit nga të gjithë popujt e perandorisë. Moment tjetër ishte botimi i Abetares së Kristoforidhit, i cili organizoi dy vizita në Dibër për promovimin e Abetares shqipe. Ai mbeti shumë i kënaqur nga pritja e mirë që j'u bë nga dibranët dhe rrethet intelektuale të saj. Treva e Dibrës ka një kulturë të hershme materjale kulturore dhe shpirtërore. Ajo është e ndjeshme ndaj ngjarjeve ku informacioni shpërndahet e merret me shpejtësi, përpunohet në odën e burrave si në qytet dhe në malësi.

Për këto arësye Abdyl Frashëri zgjodhi të parën Dibrën për të përcjellë Programin e Lidhjes së Prizrenit ku gjuha dhe shkolla shqipe zinin vend të veçantë. Rrethi i patriotëve dibranë që mbështetën vendimet e Lidhjes së Prizrenit po rritej dita ditës siç ishin, Tush Lleshi, Bajram Markja, Haziz Dema, Taf Izvira, Sheh Sula, Jakup Sofraçani, Isuf Tasha, Hysen Skarra, Maliq e Mustafa Zeneli, etj. Ky brez patriotësh do të përgatisnin pasardhësit e tyre, të rinjtë Eqerem Cami, Mersim Dema, Dan Cami, Jashar Dema, Selman Kurti, Osman Lleshi, Sheh Latifi, Jashar Zeneli(Bllaca), etj.

Kuvendi i Shupenzës më 28 tetor 1878 u përcoll me një preokupim të veçantë nga ana e patriotëve Iasmal Markja, Imer Koleci, Taf Izvira, Haziz Dema, Haxhi, Halil e Osman Cami, etj. Më 1894 u hap shkolla shqipe në Homesh, e para shkollë shqipe në Grykën e Vogël nën kujdesin e Mersim Demës me mësues Shaqir Dacin. Kjo nxitë ndërgjegjen e shumë veprimtarëve për të mësuar gjuhën shqipe dhe fillimet e një lëvizje për zyrtarizimin nga autoritetet osmane të shkollave shqipe në Dibër dhe rrethinat e saj. Autoritetet osmane prezente por në shthurje nuk do të pajtoheshin me kërkesat për hapjen e shkollave shqipe e sidomos me alfabetin latin.

Pas hapjes së shkollave shqipe në Dibër të Madhe më 1888, në Rekë më 1889 e në Homesh më 1894 u burgosën e u internuan Said Najdeni, Shaqir Daci, Dervish Hima, Hamdi Ohri i cili u mësoi shqiptarëve gjuhën shqipe në burgun e Manastirit. "Patriotët dibranë lëvizjen (arsimore) kombëtare e shtrinë jo vetëm në qytet por edhe në fshatrat e trevës, madje edhe në burgjet e armikut" ¹

Lidhja e Dibrës e shkurtit 1899 në mbështetje të Lidhjes së Pejës përbën një kthesë në mbrojtje të shkollës shqipe. U krijua komisioni arsimor që do të ndihmonte në hapjen e shkollave dhe mbrojtjen e shkollave egzistuese. Në 5 vjet 1899-1904 kemi një intensitet mbledhës e kuvendesh me objektiv hapjen e shkollave shqipe në Sanxhakun e atdhërshtëm të Dibrës, sidomos në Arras, Luzni, Zogje, Homesh, Gjoricë e Martanesh. "Sytë e gjithë shqiptarëve janë drejtuar nga Dibra dhe në të vërtetë këtu gjendet pika e gravitetit të situatës së Shqipërisë." ²

Gazeta e Sofjes "Drita" më 1 mars 1902 do të shkruante : Dibranët qëndrojnë përbal turqve për të mësuar shqipen. Eqerem Cami dhe Sheh Latifi si veprimtarë të Rilindjes luftuan me të gjitha forcat për lëvrimin e Shqipes në Gjoricë e Viçisht në bashkëpunim me Jashar Demën, Bajram Marken (Zogje), Sheh Sulën (Zerqan), Hoxhë Moglicën (Okshtun).

Eqerem Cami forcoi lidhjet me Said Najdenin, Ibrahim Temon (Reka) dhe atdhetarët dibranë në Shkup, Manastir, Selanik, Sofje e Bukuresht (Jashar Erebarën) prej të cilëve siguron abetare e literaturë shqip.

Burimet zyrtare të autoriteteve osmane tregojnë se Eqerem Cami ishte një nga firmëtarët e Ultimatumit që j'u dërgua Guvernatorisë së Manastirit për të lëshuar urdhër që mësimet në gjimnazin e Dibrës të zhvilloheshin në shqip

Patriotët e Grykës së Vogël dhe lufta për hapjen e shkollës shqipe në Gjoricë

dhe mësues të vinte Shefqet Daiu nga Elbasani në atë kohë profesor i shqipes në Gjimnazin e Manastirit.

Jashar Erebara një patriot tjetër i Rilindjes në kujtimet e tij për arsimin e shkollën shqipe në Dibër midis të tjerash shkruan : "Në Malsi për propogandimin e mësimin dhe shkollës shqipe, për shpërndarjen e librave dhe literaturës shqip shqueshin Mersim Dema në Homesh, Eqerem Cami dhe Sheh Latifi në Gjoricë, Rrahman Markja (Zogje), Rrahman Leka Kovashicë, babë Isufi e Rexhep Krosi në Bllacë. ³

Perandoria Osmane në fillimet e shekullit të XX-të po shkonte drejt shkatërrimit përfundimtar. Atdhetarët dibranë e shfrytëzuan këtë situatë duke zgjeruar e kombinuar lëvizjen për arsim me atë të Kryengritjes së armatosur. Paralelisht u krijuan Klubi Bashkimi i Dibrës së Madhe dhe Komitetet e fshehta për mbrojtjen e shkollave shqipe. Në Viçisht vepronte Dan Cami e Tahir Tola, në Gjoricë Xhemal Cami e Eqerem Cami, në Homesh Mersim Dema, në Sofraçan Jakup Cani, etj. "Punë e Dibrës" Dibranët kanë çelur syrin e qëllon që kanë lyp gjuhën e tyre e msojtor shqip. ⁴

Fitorja e Revolucionit Xhonturk më 1908 rriti shpresat e dibranëve për të përfutur hapjen e më shumë shkollave në gjuhën shqipe. Vetë zhvillimet në Dibër çuan në mësimin e shqipes në mënyrë masive bashkë me zgjerimin e shkollave shqipe. Haki Stërmilli shkruan : "Tani dolën në shesh librat shqip që i kish mbuluar pluhuri e myku dhe nisi me u këndue gjuha jonë komtare" ⁵

Kongresi i Dibrës më 23 korrik 1909 me gjithë ndërhyrjet e xhonturqëve arriti t'u japë zgjidhje disa problemeve me rëndësi kombëtare në fushën e arsimit e hapjes së shkollave shqipe, veçanërisht zgjedhja e Alfabetit Latin që do të përdorej për mësimin e shqipes, etj. Në kongres muarën pjesë edhe përfaqësues të familjeve Dema, Lleshi, Daci e Cami me Jashar Demën, Osman e Pëllumb Lleshin, Dan e Eqerem Cami, Ramis e Qamil Daci të cilët dhanë kontributin e tyre për t'u kurorëzuar me sukses punimet e Kongresit.

"Më tepër se 300 delegatë, gegë, toskë, myslimanë, të krishterë ortodoksë e katolikë, të ardhur nga çdo cep i Shqipërisë me një gojë kërkojnë të ndreqen shkollat e sotme, të çelen shkolla të reja, të përparojë mësimi dhe më tepër të përhapet mësimi i gjuhës shqipe". ⁶

Në Dibër përpjekjet për shkollë shqipe dhe përdorimin e alfabetit latin për shkrimin e shqipes u gërshtuan me aktivitetin patriotik të malësorëve të vegjëlisë së qytetit kundër politikave që pengonin zhvillimin e arsimit shqip në Dibër të Madhe e rrethinat e saj.

Qeveria turke më 13 janar 1912 mori vendimin për të hapur në Dibër 100 shkolla turke dhe dërgoi një komision arsimor për zbatimin e tij. Ky komision jo vetëm se nuk gjeti asnjë mbështetje por përkundrazi në Dibër të Madhe u organizuan mitingje e protesta kundër të dërguarve të qeverisë turke. Dibra përbën një shembull të mirë për gjithë Shqipërinë që të kërkohet me guxim e pa frikë të shprehin ndjenjat dhe kërkesat e tyre të drejta. 7 Osman Xheka është ndër të parët që mësoi shkrim e këndim në Teqen e Bllacës pas Eqerem Camit e Shahin Camit. Në kujtimet e tij Osman Xheka shkruan : "Miku im Jashar(Zeneli) më mësoi ABC-në shqipe e më fali një abetare që e kam mbajtur kurdoherë në gj". Kujtimet e Osman Xhekës mbledhur nga profesor Petraq Pepo i botoi gazeta Shkëndia e Prishtinës në prill 1971 me titullin "Mësimi i Arbërishtes" në Bllacë .

Në tetor 1910 në Fushë të Thatë të Gjoricës 1500 burra nga Gryka e Vogël, Gryka e Madhe

Beteja e Drinit tregoi se Perandoria turke po jepte shenja dobësie si rezultat i kundërshtimit të reformave të Tanzimatit nga të gjithë popujt e perandorisë.

e Bulqiza u mbledhën në një tubim që mori trajtat e një mitingu. Malësorët i paraqitën Mytesarifit të Dibrës disa kërkesa ultimative veçanërisht për largimin e trupave turke nga Shqipëria, vendosjen e administratës shqiptare dhe hapjen e shkollave shqipe. ⁸

Këto kuvende dalëngadalë i avancuan kërkesat nga ato për shkollë shqipe në kërkesa politike për vendosjen e administratës shqiptare për të ardhur në Kuvendin e Gropave të Ukut të Marsit 1912 ku një hap e ndante nga Kryengritja e përgjithëshme që solli pavarësinë e Shqipërisë. Thesojmë se disa nga ideatorët e Kryengritjes së Përgjithëshme në Dibër ishin : Eqerem Cami, Ismail Strazimiri, Kadri Fishta, Mersim Dema, Dan Cami, etj. Ata luftuan me moton: " Pa pavarësi kombëtare nuk ka shkollë shqipe".

Shpallja e pavarësisë nuk e zgjidhi përfundimisht çështjen e shkollës jo për faj të shtetit shqiptar . Proçeset historike që rrodhën nuk e favorizuan programin e Qeverisë së Vlorës. Të njohura janë edhe pasojat e pushtimit serb, lufta ballkanike, lufta e I-rë botërore që mbylli të gjitha mundësitë për hapjen e shkollave shqipe. Pushtimi austriak i Shqipërisë më 1916 krijoi disa lehtësi, u zyrtarizua gjuha shqipe, u lejuua hapja e shkollave shqipe si dhe u la i lirë përdorimi i flamurit. Drejtorja e Arsimit në Shkodër me patriotin Luigj Gurakuqi ndërmorën disa reforma në fushën e arsimit, u futën programet gjermane në shkollë si dhe u krijuan këshillat arsimore.

Krahinari quhej atëherë Homeshi më 1917 zgjodhi si anëtar të këshillit arsimor të Gjoricës Hasan Çelën. Kryetar ishte Loke Dema. Detyra kryesore e Komisionit të arsimit pranë Krahinarisw ishte hapja e shkollave në Homesh, Zogje e Gjoricë. Gjendja ekonomike e Shqipërisë para dhe pas viteve 1920, lufta kundër pushtuesve serbë deri deri nga 1921(9 vite), lëvizjet politike para 1925, mungesa e objekteve shkollore e sidomos e mësuesve vonoi për 12 vjet hapjen e shkollës në Gjoricë.

Haki Sharofi në vitin 1923 ishte inspektor arsimit në Dibër. Ai me anë të një letre që i dërgonte Ministrisë së Arsimit kërkonte hapjen e shkollës Gjoricë për fshatrat (Gjoricë e Poshtëme, Gjoricë e Sipërme, Çerenec e Viçisht), nw qoftu se nuk është e mundur sivjet të mbahet shënimi për vitin tjetër. Për fat të mirë shkolla u çel më 1925 me 50 nxënës. Mësues u emërua Haxhi Ademi(Skënderi). Ai kish punuar nëpunës si sekretar Krahinarie në Luzni dhe Arras, kish kryer një shkollë progimnaz në Dibër të Madhe. Vështirësitë ishin të mëdha, pa lokale (mësimi zhvillohej në shtëpi të fshatëve), pa mjete mësimore, etj., por mësuesi Haxhi Ademi ia doli me sukses, punoi mësues deri sa doli në pension.

Më 20 maj 1932 shkolla e Gjoricës shkruan Gazeta "Besa" e datës 29 maj shkoi në Zerqan me një kuadrat të vogël dhe dha disa ushtrime manifestimi së bashku me atë të Zerqanit, të Zogjeve e Bulqizë. Nga dita e çeljes së shkollës deri në vitin 1933 shkolla frekuentohej vetëm nga djemtë. Në vitin 1933-1934 u regjistruan 9 vajza duke thyer përfundimisht konceptin e pjesëmarrjes së vajzave në shkollë. (Tani shkolla do të quhej e përzier) Nga viti në vit u rrit numri i vajzave të regjistruara në shkollë bashkë me fëmijët e tjerë që vazhdonin shkollën.

Në vitet e vështira 1925-1944 punës e luftës për forcimin e shkollës të Haxhi Ademit iu bashkuan Fasli Cami, Hamit Manjani, por edhe patriotët gjoricarë si Ferit Kaja, Shaqir Pali, Kurt Cami, Shaqir Xhepa, Ali Miftari, Ali Kotili, Sheh Latifi Dilaver Haxhi Lleshi, Qamil Krrusa, Xhetan Tasha, etj.

Mësuesit e ardhur si Fehmi Kodra, Qeramudin Cuka (nga Dibra e Madhe), Ismail Daiu (nga Elbasani), Shemsi e Drita Zhulali (nga Gjrokastra), Andrea Sefgjini, Erefili Tavaxhi bashkë me ato pak mësues vendas dhanë një kontribut të çmueshëm për thithjen e sa më shumë fëmijëve në shkolla .

Me punë vullnetare të vetë fshatarsisë filloi ndërtimi i lokaleve shkollore në Gjoricë, por edhe në fshatrat Viçisht, Çerenec e Luballesh.

Mësuesit zgjodhën nxënësit më të mirë dhe i dërguan në shkolla e kursesi Elez Xhekën, Xhemal Xhekën, Rexhep Likën, Demir Lleshin, Qamil Mustën, Shyrete Sharkun, Zare Skënderin, etj. të cilët u rikthyen si mësues në fshatrat e Gjoricës.

Shkolla Pedagogjike, sidomos ajo e Peshkopisë, u bë një burim tjetër i përgatitjes së mësuesve edhe për Gjoricën. Kështu Sabire Cami, Bukurije Lleshi (Kaja), Adivije Miftari, Zenepe Miftari (Gjata) janë brezi i parë i vajzave mësuese në Gjoricë që erdhën nga shkollat pedagogjike.

Në shtator 1948 u hap shkolla 7 vjeçare në Gjoricë. Me drejtor Hamit Manjanin, por shpejt ajo u transferua në Shupenzë në vitin shkollor 1949-1950. U rihap më 1957 me mësues normalistin Muntas Nasufi.

Shkolla e Gjoricës dhe mësuesit e saj përbaluan një punë të madhe për zbatimin e Reformës së Arsimit në vitin 1946, luftën kundër analfabetizmit, zbatimin e detyrimit shkollor në fillim për filloren, pastaj për 7 e 8 vjeçaren, sot 9 vjeçare. Shkolla e Gjoricës ka qenë ndër shkollat më të dalluara të Dibrës, që nga hapja e saj. Ajo ka patur mësues normalistë Hamit Manjani, Muntas Nasufi, Qeramudin Cuka, Fehmi Kodra, Fasli Cami, Riza Manjani (mbaroi studimet në Bullgari), mësues të dalluar në shkollë rrethi si, Latif Dema, Besim Turja, Xhelal Manjani, Shefqet Uka, Osman Patria, Emin Cami, Mehdi Dema, Elez Xheka, Xhevat Jella, Gëzime Hajdari, Avni Mera, Emin Ruçi, Pëllumb Cami, Fatos Muha, Liljana Xheka, Malvina Lika?, Ana Cami, Flora Domazeti, Rremzije Cami, Rudina Hajdari, etj. Në analizën e seksionit të arsimit 1961-1962 vlerësohet si shkolla më e mirë e rrethit të Dibrës me 91 % kalueshmëri drejtorin Xhelal Manjani e mësues të gjuhës Latif Dema. Nga shkolla e Gjoricës kanë dalë qindra mësues, agronomë, oficerë, ekonomistë, juristë, doktorë, etj. Gjorica ka furnizuar me kuadro Grykën e Vogël, Gollobordën, Bulqizën e deri qendrën administrative në Peshkopi.

Shkolla e Gjoricës është dalluar në veprimtaritë kulturore dhe artistike në shkollë zone, rrethi e atë kombëtare. Nga vitet 1960 Adivije Miftari Zabit Qoku, Hasan Çela, Tufik Xheka, Ilmije Lleshi, Shukri Hajdari, Hajri Alimani, Naslije Mulia kanë çuar grupe e individë deri në festivalet folklorike kombëtare në Gjirokastër e Berat.

Shembull në veprimtaritë sportive kanë qenë ekipet e shkollave të Gjoricës në spartakiadat e rrethit e ato kombëtare mësuesit e apasionuar Fadil Cami, Fehmi Lika, Maliq Dumani, Zabit Kaci e deri tek më i riu Edmond Miftari.

Gjorica ka nxjerrë nxënës ekselentë që kanë shkëlqyer në shkollat e profesionet e zgjedhura si Irfan Jashari, Agim Cami, Bashkim Hajdari, Shpëtim Cami, Rizvan Kazani, Novruz Mera, Lulzime Shehu, Izet Qoku, Skënder Kaja, Trandafille Lleshi, Edison Mera, Ardit Kaja, Ilir Krosi, Bashkim Hajdari, Flamur Skënderi, Eduard Ruçi, Fatime Qoku, Engel Rama, Elvana Rama, Anxhela Koleci, Marsela Dumani, Sonila Cami, Yllka Izvira, Aduela Shehu, Jolanda Kaja, Valentina Cami, etj.

(vijon në faqen 22)

Ashtu si fshatrat e tjerë të Grykës së Madhe dhe Bulqizës edhe Sofraçani ka pasur veshje karakteristike, krahinore për gratë. Kjo lloj veshjeje e përmirësuar dhe e kombinuar me veshjen e mëparshme iu përshtat klimës së ftohtë, terrenit malor dhe punëve të rënda, që ishte e detyruar të përballonte gruaja...

Veshja e krahinës së Sofraçanit dhe Grykës së Madhe

Nga XHELAL ROÇI

Veshja zakonisht ruan karakterin kombëtar të një populli, por ka ndryshime të pjesshme nga një krahinë në tjetrën dhe në kohë të ndryshme. Veshja ndryshon nga meshkujt te femrat, ndryshon sipas moshave si dhe ka pësuar ndryshime në periudha kohe të ndryshme.

Burrat fillimisht vishnin fustane me pala, këmisha me mëngë të gjata të punuara me fije leshi në rashbuej. (Krahina jonë rashbuej i quan vegjë).

Ky lloj stofi quhej qashë dhe punohej nga leshi i deles. Veshja për burra dhe për gra ndahet në veshje të brendshme dhe të jashtme. Për burrat, në veshje të brendshme bëjnë pjesë këmisha dhe të mbathurat. Këto fillimisht punohehin prej leshi, më vonë filluan të punohehin prej fije pambuku, pëlhurë e bardhë. Këmisha kishte një rreth të ngushtë, që rrethonte qafën. Mëngët i kishte të gjata deri te kyçi i dorës. Në disa raste mëngët bëheshin më të gjera deri 20-30 centimetra. Kjo lloj këmishë qepej me dorë, por në ndonjë rast edhe në rrobaqepësi (terzi). Këto lloj këmishash i kanë mbajtur deri në kohët tona burrat e vjetër. Me kalimin e kohës këto janë zëvendësuar. Në veshjen e brendshme hyjnë të mbathurat. Edhe këto fillimisht punohehin me fije leshi, më vonë prej pambuku ose liri. Shtrëngoheshin në mes nga një lloj rripi që quhej barci. Të mbathurat, fillimisht, vinin të gjera dhe në fund të këmbëve ngushtoheshin sipas pjesës së poshtme të këmbës. Këto qepeshin me dorë ose në rrobaqepësi. Në kohët e sotme edhe këto kanë pësuar ndryshime dhe përmirësime.

Mbi këmishë visheshin triko leshi me mëngë ose në formë jeleku. Këto thureshin nga gratë me fije leshi. Gjatësia e trikove dhe e jelekut arrinte deri në bel. Herë-herë bëheshin të hapura e mbërtheheshin me kopsa, në raste të tjera bëheshin të mbyllura. Jelekët shpeshherë zbukuroheshin me gajtanë të zi ose të verdhë që dukej si fije ari. Zbukurimi bëhej vetëm në pjesën e përparme. Shpeshherë jelekët qepeshin në rrobaqepësi edhe prej cope, stof leshi.

Bazën e veshjes e bënte shajaku, stof leshi i punuar me rashbuj. Shajaku punohej nga fije leshi deleje e bardhë ose e zezë.

Xhamadani i burrave. Ishte veshje e sipërme. Qepeshin prej qashë të bërë prej leshi, ngjyrë e bardhë ose e zezë. Mbahen me mëngë. Në disa raste me mëngë të shkurtra.

Pjesa e përparme ishte e hapur. Kjo stolisej me gajtan të zi. Xhamadanë me shajak të kuq, zakonisht i vishnin djemtë e moshave të reja. Ata qëndiseshin me gajtana të zi dhe deri me edhe gajtana me fije ari. Punohehin e zbukuroheshin me lule e gjethe të stilizuara. Pjesa e përparme e xhamadani nga të dy anët ishte e mbushur me sumbulla që kishin ngjyrë portokalli ose limoni. Në disa raste xhamadanët sipër supeve kishin kapakë dhe mëngët i kishin të stolisura me gajtana me ngjyra dhe astar po të ngjyrave të ndryshme. Astar zakonisht ishte prej pëlhurë mëndafshi. Qepeshin në rrobaqepësi nga gratë e familjes.

Brezi. Brezi punohej prej fije leshi në rashbuej, në formë shiriti me gjerësi 16-18-20 centimetra dhe gjatësi nga tre-katër pashë ose 4-6 metra. Brezi mbahej duke mbështjellë mesin në bel: Kishte breza ngjyrë të kuqe të errët dhe brez me lara. Larat ishin prej pambuku në formë shiriti të bardha. Zakonisht fundi i brezave ishte me tufa. Kishte edhe breza që punohehin me fije të hollë, më tepër në fabrika. Këto bliheshin dhe quheshin breza Stambolli.

Tirqët. Ishin veshje të punuara prej shajaku leshi. Leshi bëhej fije, endet e punohej në rashbuej. Pasi bëhej qashë ose cohë kalonte në valance ku shkelej. Copa e qoshes qepej e pritej tirq në rrobaqepësi ose nga gra specialiste. Tirqit ishin ngjyrë e bardhë, kafe ose të errët. Zbukurimi i tyre bëhej me gajtan të zi që vendosej në pjesën e përparme, rreth xhepave, në pjesën e prapme.

Mbylleshin me kopsa, shtrëngoheshin me rrip ose barc. Tirqit më të bukur visheshin kur burri bëhej dhëndër. Qepeshin në qytetin e Dibrës së Madhe, në Gostivar, nga rrobaqepësit. Dibra përdorte më tepër tirqit e ngushtë.

Shallvaret. Ishin veshje e jashtme. Punohehin prej stof leshi ngjyrë e errët ose kafe. Këto mund të krahasohen me pantallona të gjerë të lidhur në fund. Stofi punohej nga leshi i deles së zezë. Vishen më tepër në stinën e dimrit. Shallvaret në stinën e verës zëvendësohen me brekushe burrash të punuar nga pëlhurë doku prej pambuku të zi. Ngjajnë me shallvaret me xhepa të gjerë, të thellë për brenda.

Çorape burrash: Këto punohen prej fije leshi deleje, cilësi e parë. Këto i thurin gratë me



VESHJA E GRAVE

shtiza. Mund të jenë ngjyrë e bardhë, e zezë dhe çorape me çuka ose me tela që përdoreshin kur djali bëhej dhëndër. Për thurjen e çorapeve me çuka përdorej penj leshi me ngjyra të ndryshme. Zbukurohen me tel argjendi, ku vizatoheshin figura të ndryshme.

Tozlluket. Është veshje që mbulojnë këmbët nga thembrat deri te gjuri. Këto punohehin nga gratë me fije leshi, në formë stofi dhe qepeshin në rrobaqepësi. Mund të thureshin nga gratë me shtiza.

Opingat. Këto mbatheshin me këmbë. Punohehin nga lëkurë lope, kau, bualli dhe quheshin opinga lope. Punohej lëkurë kali dhe mushke. Opingat përgatiteshin nga opingarë, burra, por edhe nga gra.

Më vonë opingat bëheshin nga llastiku, komardare makine. Opingat e përgatitur nga lëkurë e përpunuar, quheshin opinga të verdha.

Dollama. Ka qenë veshje e hershme. Punohej prej materiali leshi. Kjo ishte në formë paltoje, por tjetër model. Qepeshin nga rrobaqepës. Në kushtet e tanishme dollama është zëvendësuar me pallton ose xhupin.

Xhulini. Përdoret më tepër nga barinjët e bagëti në bjeshkë. Xhulini bëhej prej stofi leshi. Ishte i gjatë nga koka te këmbët. Xhulini përdorej nga barinjët për të fjetur te vatha e bagëti. Ai qepej nga gratë me fije leshi ose liri. Mëngët e xhulinit ishin të shkurtra deri tek brryli. Xhulini punohej me lëkurë qengji të regjur më përpara me kripë. Çdo bari duhet të kishte xhulini. Xhulini kishte jakucen për ta vënë në kokë, e cila ishte e pandarë.

Jakuca. Ishte e shkurtër deri në bel. Punohej prej qashë. Mund të ishte ngjyrë e zezë ose dhe e bardhë. Mëngët i kishte të shkurtra deri në berryla. Jakën e kishte të madhe dhe të gjerë, me tufa, pas shpinës deri në shpatulla. Kur ishte koha me shi ose borë, të dyja skajet e jakës bashkoheshin dhe mbërtheheshin me anën e dy kopsave e vihej në kokë. Përdorej më tepër gjatë verës.

Sendet e burrërisë. Kutia e duhanit është në formën e paralelepipedit me kapak. Brenda mbushje me duhan të grirë. Në kapak ka një vend që mbahen letrat e cigares.

Cigarja e sermës. Kjo ishte e gjatë deri në 50 mm. E punuar me pjesë argjendi. Në të futej cigarja dhe shërbente për të thithur tymin. Këto zakonisht ruheshin në brezin e mesit, por edhe në xhep. Ndonjëri e vendoste në qafën e jashtme mbas shpine.

Ora e xhepit. Zakonisht ishin orë të markës "Sakisuf" që prodhoheshin në Stamboll në formë artizanale dhe silleshin nga tregtarë ose emigrantë. Mbaheshin me varg të gjatë në qafë. Në kraharor vargu prej argjendi kishte një bashkuese për dy anët e vargut dhe vazhdonte deri në mes, ku lidhej sahati, i cili futej në brez. Më vonë u futën në Shqipëri edhe marka të tjera të orëve të xhepit.

Arma. Arma mund të ishte armë brezi ose armë krahu. Armë krahu ishte çifte, pushkë, karafilja. Armë brezi ishte tapanxa, naganda dhe revole të markave të tjera. Në vend të armëve të zjarrit, në mungesë të tyre, përdoreshin armët e ftohta, siç ishin thikat, kamat, sakoret (sopat e vogël). Këto të fundit zakonisht i mbanin barinjët.

Qelesha. Punohej nga leshi, nga specialistët. Kjo ishte e bardhë, në formë cilindri, me fund të rrafshët për Dibrën. Djali po të mbushte moshën 15-16 vjeç duhet të mbante në kokë qeleshe.

Ashtu si në krahinë të tjera edhe në Sofraçan, veshja e grave e ka prejardhjen nga ilirët. Herët janë përdorur stolitë që përdornin ilirët. Veshja ka ardhur duke u përmirësuar. Janë futur në të elemente të rinj, që janë marrë nga fqinjët, sllavët, dhe nga turqit. Këto sende i sillnin emigrantët dhe tregtarët. Ashtu si fshatrat e tjerë të Grykës së Madhe dhe Bulqizës edhe Sofraçani ka pasur veshje karakteristike, krahinore për gratë. Kjo lloj veshje e përmirësuar dhe e kombinuar me veshjen e mëparshme iu përshtat klimës së ftohtë, terrenit malor dhe punëve të rënda, që ishte e detyruar të përballonte gruaja e kësaj krahinë, zakonisht të egër të kësaj krahinë, barrës së shpinës.

Veshja e grave ndahet në veshje të brendshme dhe veshje të jashtme. Në veshjen e brendshme hyjnë këmishat dhe të mbathurat.

Këmishat. Këmishat e grave bëhen nga pëlhurë kambriku, të gjata deri te laku i këmbës (te gjuri). Mëngët e saj janë mjaft të gjera dhe mund të shpërtheshin deri tek berryla gjatë punës. Ka një qafore të ngushtë, e cila mbërthehet nga një kopsë tek fyti. Në pjesën e përparme është e çarë deri afër kërthizës, shkon baras me lartësinë e kraharorit. Në të dy anët, tek shpatullat nën sqetull ka 5-7-8-10 kinda (copa) për çdo anë. Kindat fillojnë të ngushta, pastaj zgjerohen që i japin këmishës formë konike. Këmisha e nuseve të reja kanë deri 12 kinda në anë. Kështu, këmisha merr pamjen e një fustanelle. Këmishat në përdorim të përditshëm priten prej pëlhurë pambuku të zakonshme, beze. Këmishat e nuseve dhe të vajzave prej kambriku quhen petka hasi, kur ata janë bashkë me të mbathurat. Kur vajza vishet nuse dhe shkon në shtëpi të burrit, zakonisht duhet të ketë pesë palë petka, nga të cilat dy duhet të jenë petka hasi dhe tre palë petka nga pëlhura e zakonshme.

Të mbathurat. Priten të gjata deri tek koci i këmbës. Ato vijnë të gjera sipër dhe mbarojnë të ngushta tek këmbët. Kanë tune që përshkohen nga një rrip pëlhure që përdoret për t'i shtrënguar dhe quhet baq. Tuja e të mbathurave kalon në lartësinë e mesit. Baqi i të mbathurave shtrëngohet përpara. Në veshjen e brendshme të pëlhurës (që quhen të linjtat), te gratë e vajzat nuk ka ndryshime. Është me rëndësi të përmendim se gratë e kësaj krahinë kanë tradita shumë të mira për larjen e rrobave. Ato në të kaluarën përdornin me mjeshtri finjën për larjen e rrobave, ndërsa më vonë sapunin.

Qasha: Përbëhet prej stofi të ngjyrosur. Qashat e nuseve dhe te gratë e moshuara janë ngjyrë e zezë, ndërsa për vajzat ngjyrë e kuqe. Qasha vishet duke futur dy krahët në vendet e posaçme dhe mbulon shpinën e femrës nga qafa deri te laku i këmbës pas gjurit. Pjesa e shpinës së qashës është e paprerë, kurse në të dy anët nën sqetull, lidhet me pjesën e shpinës nga katër copa kinda të ngushtë, të cilët zbrasin poshtë, barazi me gjatësinë e pjesës së shpinës. Te kindat në të dy anët formohet nga një palosje pak a shumë e thellë. Rreth e qark qashës në formë kurore ngjiten gjalma, spika, tre copë ngjyrë të kuqe te gratë dhe ngjyrë e zezë të vajzat. Këto thuren nga gratë me fije leshi. Vendi ku bashkohen kindat anësore nën sqetull në pjesën kryesore të qashës mbulohen nga një spikë e kuqe në drejtimin vertikal. Kindat nën sqetull lidhen me njëra-tjetrën

me një kin tjetër. Në këtë lidhje vendosen kryq me kindet tre fije spika që marrin emrin kryqe. Gojë pas goje tregohet se qashat, dikur, përpara shumë vjetësh, kanë qenë të bardhë me pika të zeza dhe të gjata deri tek pupla e këmbës. Kjo duhet të jetë e besueshme se edhe në ditët tona në disa krahinë malore vishen qasha të bardhë. Kombinimi i ngjyrave kuq e zi tek qashat e grave dhe të vajzave disa e shpjegojnë se paraqesin ngjyrat e flamurit tonë kombëtar. Qashat i qepin disa gra specialiste për këtë punë.

Brezat. Përbëjnë element të rëndësishëm të kësaj veshje. Brezat janë të njëjtë, si ata që folëm për burrat. Një grua duhet të ketë të paktën tre breza. Një brez të kuq leshi, një brez të hollë Stambolli dhe një brez me lara. Breza veshin nuset, vajzat dhe gratë e moshuara. Ngjyra e brezit të gruas duhet të jetë e kuqe e ndezur, gratë e krahinës e quajnë bojë teli. Nuset dhe vajzat më tepër përdornin brezat me lara. Gjatë veshjes së brezit me lara nuset dhe vajzat duhet të kenë kujdes të kombinonjë ngjyrat e bardha. Brezat në të dy anët kanë tufa. Gratë në moshë më të madhe nuk veshin brez me lara të bardha, ata veshin brez me ngjyrë të kuqe të errët. Për gratë që mbajnë zi, ngjyra e brezit duhet të jetë mavi (ngjyrë manushaqe shumë e errët). Brezat i thurin e i punojnë vetë gratë në rashbuej. Brezin e ngjeshin përpara mbi këmishë në lartësinë e barkut dhe në shpinë brezi vjen mbi qashë.

Poshterka. Punohet në rashbuej prej fijeve të leshit të deles. Është e hollë, ngjyrë e zezë. Vendoset në pjesën e përparme të trupit, në lartësinë e brezit dhe lidhet rreth trupit me gjalmin e vutit të zi. Për së gjati duhet të arrijë deri te kupa e gjurit, plotësisht baras me qashën dhe me këmishën.

Mbulon gjithë pjesën e përparme të gruas dhe anash kalon mbi qashën. Gratë në moshë të kaluar si dhe ata që kanë zi mbajnë përshterka, kurse nuset e reja mbajnë përshterka prej cope basme pambuku kur punojnë, për të ruajtur pastërtinë e veshjeve të brendshme. Përshterkat për nuset dhe për plakat pothuajse u zëvendësuan me përshterka prej basme. Për plakat përdoreshin ngjyra e errët, ndërsa nuset basëm me ngjyra, të kuqe ose me lule.

Kjo e mori emrin përshtëmadhe.

Bakorja. Thurej me rashbuej prej fije leshi dhe pambuku, shkilet në vala vica. Tymni duhet pambuk i bardhë dhe indi prej leshi të zi ose të ngjyrosur i zi. Larat e bakores kombinoheshin të zeza dhe të bardha. Ata shkojnë paralelisht me njëra-tjetrën. Larat e bardha prej pambuku ishin më të ngushta, rreth 1 centimetër dhe me drejtim horizontal kundrejt trupit. Pambuku duhet të ishte i cilësisë së mirë. Gjalmi i saj ishte i thurur gjithnjë po me ngjyrat bardhë e zi. Bakorja lidhej me lartësinë e brezit dhe për së gjati ai duhet të arrinte deri afër kupës së gjurit, domethënë baras me gjatësinë e qashës dhe të këmishës. Për së gjeri bakorja ishte më e ngushtë, se përshterkat qëllimisht që të dukeshin anash turrat e këmishës së bardhë ndërmjet saj dhe qashës. Bakorë e thurura me pambuk të bardhë me lesh boje blu preferoheshin më shumë. Kishte edhe barkore pa lara, të bardha, të cilat i përdornin gratë në moshë mesatare. Zakonisht barkoret me lara quheshin barkore zonjash. Si duket, ky element i veshjes me bazë autoktone pësoi ndryshime.

Gryka. Ishte jelek pa mëngë. Vishej mbi këmishë, nën qashë dhe kapet prej brezit në anën e përparme. Gjatësia e saj arrinte deri në kërthizë. Për nuset dhe vajzat përbëhej prej basme të kuqe, me vija të zeza, kurse për gratë e moshuara basëm e errët e zezë ose me vija të verdha. Preferoheshin shumë gryka e jepekut, një lloj basme e jashtme. Gryka në pjesën e parme të kraharorit kishte dy fletë që paloseshin njëra mbi tjetrën dhe mbërtheheshin me kopsa të verdha metalike të vogla në krahu e majtë. Rreth qafës si dhe në krahu që mbërtheheshin gryka ishte e qëndisur me fije gajtani të zi. Qëndisja e saj rreth qafës kishte motive zbukurimi. Qafa e këmishës duhet të dilte pak mbi grykën e jepekut. Grykat e grave i qepin gra specialiste. Basmën dhe gajtanin ata i blinin të gatshme.

Jeleku me pafte. Përbëhej në pjesën e përparme prej cope të kuqe të errët me dy fletë, që mbërthehet në mes të kraharorit. Pjesa e pasme, shpina, përbëhet prej një cope më të dobët, zakonisht me lara të kuqe e të zeza. Jeleku afrohej me grykën. Jeleku ishte i qëndisur me gajtan të zi e me motive zbukurimi si rreth qafës, ashtu edhe në pjesën e përparme. Jeleku përdorej vetëm për nuse dhe vajza. Nuset e vishnin vetëm vitin e parë të nusërisë. Mbi jelek në kraharor mbërtheheshin tre palë pafte (gjashtë copë) pjesë metalike të rumbullakta në formë kupash me dimension rreth katër centimetra, mbi të cilën janë ngjitur para të vogla sermi me vargje me gjatësi rreth gjashtë centimetra.

etnografi



Pra, tre me një anë dhe tre në anën tjetër, që lidheshin bashkë. Kur nusja ecte, vargjet tundën dhe paratë japin tringëllimë e tyre metalike. Përdorimi i stringlave në veshjen e nuseve ka origjinën e vjetër, përveç zbulurimeve lidhej me besëtytnitë për largimin e shpirtit të këqinj. Kohët e fundit, në veshjen e krahinës në fjalë jelekët janë kufizuar shumë. Njerëzit e moshuar tregojnë se jelekët nuk janë elemente autoktoni i veshjes, por duhet të jenë marrë nga viset e tjera, siç do të tregojmë më poshtë. Në dasma e në gëzime jelekët i veshin edhe vajzat e pamartuara. Duhet theksuar se paratë që janë me mbishkrime janë vështirë të gjenden në kohët tona. Ata janë sjellë nga larg, nga vendet e lindjes, sidomos nga Stambolli. Zakonisht i sillnin tregtarët, bashkë me mallrat e tjerë.

Antaria. Nuk është element autoktoni i veshjes. Siç duket, është futur më vonë në kompleksin e veshjes së Grykës së Madhe dhe Bulqizës. Më tepër shërbente si element zbulurimi. Pritet si këmishë me krah, me doreza dhe me qafë të ngushtë, si ajo e këmishës së brendshme. Është e çarë përpara në kraharor dhe gjatësia e saj arrin deri në këthizë. Pritet prej pëlhure të mëndafshit.

E përdorin nusët dhe vajzat me ngjyrë të kuqe të errët, të ndezur ose ngjyrë trëndafil. Gratë e moshës mbi 30 vjeç e lart që kanë fatkeqësia të ndryshme e përdorin me ngjyrë të verdhë limoni ose portokalli. Gratë me moshë mesatare antarin e presin prej basme të bardhë me vija bojëqielli ose komplet bojë qielli. Antaria për çdo lloj moshë zëvendësonte mitanin dhe vishej në stinën e ngrohtë të verës.

Mitani. Përbëhej prej basme nga ana e jashtme dhe pëlhure nga ana e brendshme. Në mes dy shtresave mbushej me pambuk special ose lesh të butë të fiksuar me anën e qepjes. Funkcioni i tij kryesor ishte që të mbante ngrohtë trupin, prandaj vishet në stinën e dimrit. Kishte mëngë dhe gjatësia e tij arrinte deri në fund të barkut. Përpara ka dy fletë të palosura njëra mbi tjetrën dhe mbërthehet në kraharor e majtë, me kopsa metalike të verdha. Ishte i qëndisur me gajtan të zi e me motive zbulurimi në qafë. Gjatë pjesës së kraharorit ku bëhej mbërthimi, në bërrylat e krahëve si dhe në doreza kishte zbulurime me haxha dhe në fund të krahëve vendoseshin 6 ose 8 kopsa të verdha. Zakonisht haxhat ishin të qëndrueshme, prandaj edhe pasi grisët një mitan, ata mund të përdoren në një mitan tjetër. Mitanat zakonisht bliheshin të gatshëm, por kishte edhe gra që dinin t'i qepnin vetë.

Mitani i nuseve dhe i vajzave të rritura ishte i kuq ose trëndafil me vija të bardha ose të zeza dhe i grave të moshuara e me moshë mesatare me vija të verdha, me vija të zeza, ndërsa i grave të vjetra mitan i zi me vija të bardha. Për çdo nuse të re duhet patjetër një mitan jepeku (një lloj basme speciale) një mitan të kuq, një të verdhë dhe një të zi, kur gruaja të plakej. Mitanat e jepekut dhe grykat e jepekut në kohë të hershme i sillnin nga Stambolli, kohët e vona nga Dibra e Madhe. Në Dibër kishte edhe rrobaqepës (terzi) që qepnin e qëndisnin veshje të tilla sipas shijes së Grykës së Madhe e të Bulqizës.

Shamiat (Shamliat). Shamia ishte element autoktoni i veshjes së grave. Vajzat nuk mbajnë shami në kokë. Vajzat flokët i mbanin të gjata, të ndarë anash nga balli, gjatë mesit të kokës dhe të hedhura prapa krahëve. Nusët përpara disa vjetësh kanë mbajtur dy copë shamia të kuqe, të

zbuluruara me motive lulesh ose dy shami, një të kuqe e një të verdhë. Kishte shami të kuqe bojëgjaku, të verdha dhe ngjyra të tjera. Dimensioni i këtyre shamive ishte i ndryshëm 70x90, 80x90. Nusja mbante dy shami të tilla, të qepura njëra me tjetrën, një të verdhë poshtë dhe një të kuqe sipër. Këto ishin të tufëzuara. Për ta vendosur në kokë, shamitë qepeshin në njërin cep, pikërisht atë që bie në kokë dhe lidhen dy cepat anësore njëra me tjetrën. Në këtë mënyrë pjesa e shamisë që zë vend mbi kokë merrte formën e një kupë, ndërsa cepi i katërt varet mbi shpinë gjatë qashës. Shamitë gjithmonë duhet të ishin me tufa. Pas periudhës së shkurtër, rreth një viti të nusërisë, nusja i ndante shamitë dy bashkë dhe mbante në kokë vetëm njërin shami, atë të kuqen. Mund të mbante edhe shaminë bojë gjaku, ndërsa me kalimin e kohës dhe në raporte me moshën e gruas, mbante shaminë ngjyrë të verdhë, portokalli ose gjith arrë. Plakat mbanin shami bojë qielli të errët. Në shenjë zie, gratë ngjyen me bojë të zezë shamitë bojë gjaku ose përdorin shami të zeza.

Një shami bojë gjaku ose ngjyra të tjera, gjithmonë të tufëzuara me dimensione më të vogla, mbanin nusët ose vajzat, shami në brez, pikërisht në kraharor, aty ku ngjishet brezi dhe lidhet barkorja. Shamia e brezit palosej në formë cilindrike dhe vendosej përpara. Ajo ngulitet në brez ndër sjetulla, në të dy anët duke lënë varë tufat e saj anësore. Shamia e jepekut punohej në fabrikë me fije leshi të zgjedhur deve, të hollë në Stamboll. Kishin ngjyra të ndryshme. Brenda shamia ishte e zbuluruara me motive lulesh fantastike, sidomos trëndafilat etj. Lulet kishin ngjyra të ndryshme natyrore, shumë të gjera, të kombinuar në mënyrë artistike. Shamitë sipas ngjyrave përdorshin nga gratë. Shamitë e jepekut nuk mbaheshin në punë. Ata përdorshin zakonisht në raste dasmash, rugëtimesh, kur gruaja shkonte në gjini e në gëzime të tjera familjare. Në punë e në shtëpi mbante shami të tjera, të thjeshta prej pambuku ose prej mëndafshi. Nusja kur martohet, duhet të ketë të paktën tri shamia jepeku për t'i vënë në kokë dhe dy shami për t'i vënë në brez. Shamitë e kokës duhet të ishin në ngjyrë të kuqe, bojë gjaku dhe në të verdhë dhe këto duhet të ishin të dimensioneve 80x90 cm. Ndërsa shamitë e brezit duhet të ishin një e kuqe dhe një e verdhë 60x70 cm. Këto dy copë ishin të domosdoshme. Mund të kishte edhe të tjera. Për të vënë në brez nusja duhet të kishte edhe shami të tjera prej mëndafshi, gjithmonë sipas moshës. Shamitë e jepekut duhet të kombinohen me mitanin e jepekut, me grykën e jepekut ose me antarinë dhe jelekun me pafte. Ato duhet të kishin ngjyra tërheqëse, sidomos në ambientet e fshatit në mes të gjelbërimit. Shamitë e jepekut mendohet se u futën në veshjen e Grykës së Madhe e të Bulqizës si një element i ri në radhë të parë nën influencën e veshjes së grave të fshatrave të zonës malore rreth qytetit të Dibërës së Madhe dhe zëvendësuan shamitë e pambukut, që përdorte krahina.

Shamitë e jepekut përdorshin në fshatrat e krahinës Shkodër, në Zadrimë të Lezhës, në Gollobordë të Dibërës, në fshatrat e Rekës e të Strugës. Gratë e këtyre krahinave i përdorin në një formë tjetër.

Tiret e çorrapet. Tiret ishin pjesë e veçantë nga çorapat. Ato mbulojnë pulpën e këmbës nga koci deri poshtë gjurit. Në pjesën e poshtme tiret futeshin në qafën e çorapit dhe lidheshin me gjalmat e tyre. Në pjesën e sipërme nën gju, futeshin brenda tiret, këmbëzat e të mbathurave

në një thellësi 4-6 cm.

Lidhej tirkun me gjalmin e tij rreth pjesës nën gjurin dhe pastaj të mbathurat ktheheshin mbi tirk, duke i tërhequr afërsisht deri në mesin e pulpës së këmbës. Tiret dhe çorapet i punojmë vetë gratë dhe vajzat me fije leshi të tjerë hollë, të dredhur dhe i thurin me shtiza. Zakonisht për tiret dhe çorapet përdorej lesh i hollë e i butë, sepse tek tiret dhe çorapet vlerësohej më shumë aftësia e gruas në përpunimin e leshit. Nusët mbanin çorape të bardhë me thurje të dendur. Ndërsa tiret duhet të ishin gjithmonë të bardhë, mund të visheshin çorape të zinj me qafa të bardha. Çorapet vajzat i vishnin të bardha si nusët, ndërsa tiret ngjyrë të kuqe.

Opingat. Para disa vjetësh nusët mbanin opinga të verdha. Këto ishin prej sholle të hollë të regjur. I blinin në treg si shollë dhe pastaj i punonin vetë gratë, duke i thurur me retna lëkure rreth e qark. Njëpër rizë kalonin gjalmat e bardhë, të cilët, pasi kryqëzoheshin në shpinë të këmbës, lidheshin si dy fije paralele nën gju, në atë vend ku lidheshin edhe tirkun, duke kaluar në anën e pasme të pulpave të këmbës. Gratë e tjera të moshave të ndryshme si dhe vajzat mbanin opinga prej lëkure të lopës të paregjur. Edhe këto opinga i punonin vetë gratë me retna, njëpër të cilat kalonin gjalmat e bardhë, rreth e qark.

STOLITË E SENDET E ZBUKURIMIT

Gërshetat. Vajzat i mbanin flokët të lëshuara, ndërsa nusët dhe gratë i zinin gërshet, pasi i ndanin në të dy anët për së gjati kokës. Nusët e gratë lakmonin të kishin gërsheta sa më të gjatë e të mbushur, prandaj kur ndonjë grua e re nuk ka shumë flokë, thurte gërsheta me flokë artificialë. Gërshetat fillonin në të dy anët pas veshit dhe lidheshin me gjalmat të kuq trekëmbësh, të cilët i punojnë vetë gratë. Thurja e gërshetave bëhej duke i shtrënguar mirë flokët me gjalmin. Gjalmat vazhdojnë edhe pasi mbarojnë së thururi flokët duke thurur vetëm fijen e gjalmi të kuq. Këto tri fije të nusët e reja mbarojnë me tre tufa të bukura teli me ngjyrë të arit ose të sermit, të cilat përgatiteshin disa gra të specializuara. Te gratë që janë në moshë të re tufat thuren me fije leshi të kuq e të verdhë. Gratë e moshuara dhe plakat i mbajnë gërshetat pa tufa. Pas thurjes së gërshetave, të cilët dalin mjaft të gjatë, lidhen njëri me tjetrin sipas tufave dhe pastaj duke formuar një urë kthehen mbi supet e mbarojnë mbi shpinë. Këto lidhje të gërshetave shërbejnë për të mbajtur shaminë e kokës e shtrihen mbi qashen gjatë shpinës. Lidhja e gërshetave në shpinë mbaronte me tufat e tyre.

Unaza. Zakonisht nusët mbajnë gjashtë unaza metalike. Më shumë lakmojnë unazat e sermit me një gur të thjeshtë. Më përpara preferoheshin unazat që quheshin "myhyre Stambolli", të cilët, siç duket i sillnin nga Turqia. Kohët e fundit këto stoli u zëvendësuan me unaza të bukura. Nusët që kalojnë një kohë mbajnë nga dy unaza. Aktualisht përdoren unazat e floririt. Një unazë ose myhyr vjen në rastin e fejesës, ndërsa të tjerat kur martohen.

Vëthët. Vajzat përdorin vëthët që nga moshja 12 vjeç e më tej. Nusët edhe gratë i përdorin vëthët deri në moshën 30-40. Pas kësaj moshë zakonisht gratë nuk mbajnë vëthë. Vajzave ua shpojnë veshët që në vogël.

Vëthët e vajzave, vëthët e zakonshme të nuseve si dhe ata të grave përbëheshin prej paresh të vogla argjendi, të quajtura tetore. (Pare metalike turke, të cilat kanë një varg argjendi 6 centimetra të gjatë dhe varen në vesh me anën e një hallke teli prej argjendi. Veç këtyre nusët kishin edhe vëthët e nusërisë, të cilat përbëhen prej dy monedhash të vogla të arta (gjysmë napoloni ose çerek lire turke). Paret e floririt dy copë varen në një skelet filigrami të punuar me argjendar. Ky skelet kishte në anën e sipërme një grip prej argjendi. Këto lloje vëthësh nusët nuk i varim në vesh, por në gërshetin e flokëve afër veshit. Të dy vëthët bashkohen njëra me tjetrën me një varg (zinxhirë të hollë) të gjatë argjendi i cili kalonte mbas qafë mbi shpinën sipas shamive. Vëthët e nuseve quhen vëthë me varg dhe bënin pjesë në pajën e nusërisë. Nuk ishin elemente autoktonë të veshjes, por një element i ri, që, siç e tregojnë të vjetrit, futen bashkë me shamitë e jepekut.

Paret dhe vargu krahëqafë. Në kompletin e veshjes së nusës futet dhe vargu me para. Ky varg përdoret një copë ose tre varje. Ditën e martesës vihej mbi jelek me pafte. Nga njëri krah në tjetrin përpara kraharorit. Këto pare janë tetore të mëdha (pare të Turqisë) dhe lidhen me vargun. Në varg vendosen 10-12 copë tetore në një varg. Këto tringëllojnë shumë. Duhet tre varje me pare. Nga tringëllimi e zhurma që ata bëjnë mendohet se largoheshin xhindet (qoftë largu) dhe të këqijat e tjera që nusja të mos i shkelë. Nusja këto varje i

mbante jo më shumë se pesë ditë dhe kur kthehet për herë të parë nga prindërit e saj, pas martesës, nuk përdorshin më. Këto në të shumtën e rasteve, meqenëse ishin me pakicë, merren me qira nga gra që i kishin të tyret.

Përveç vargjeve më parë pjesë e veshjes ishte edhe vargu i sernës (argjendit) që vihej krahëqafë. Ky ka dy sumbulla që kryqëzohen. Njëra në shpinë dhe tjetra përpara në kraharor. Vargu kalon në dy supet mbas shpine nën sjetull dhe përpara. Varej sipas gjerësisë së kraharorit të nusës, por duhet të ishte të paktën dy metra.

Sikur del nga ky përshkrim i shkurtër, veshja e krahinës së Grykës së Madhe dhe e Bulqizës, ku përfshihet edhe Sofraçani, duke ruajtur bazën e saj të vjetër, ishte pasuruar gjithmonë në elemente të rinj dhe ka bërë një evolucion të dukshëm më shumë se veshja e çdo krahine tjetër të zonave malore. Ajo dallohet si për kombinimin harmonik të ngjyrave ashtu edhe për elegancën e formën gjithnjë në zhvillim. Në të nuk kishte elemente fetare. Në këtë evolucion dhe pasurim të veshjes së grave të këtyre dy krahinave kanë ndikuar disa faktorë ekonomik-shoqëror. Burrat e këtyre krahinave që në shekullin e XIX dhe më përpara shkuan në mërgim (refugjat) sidomos në Turqi dhe më shumë në kryeqytetin e kësaj perandorie, në Stamboll. Këtu ndikonin kushtet e vështira ekonomike, hasmëria dhe hakmarrja që i detyronin njerëzit, meshkujt të emigronin jashtë atdheut. Nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, numri i të mërguarve ka ardhur gjithmonë duke u shtuar. Shumë prej tyre qëndronin andej me vite të tëra, larg familjes e nuk fitonin gjë. Në mungesë të burrave gratë përballeshin vetë të gjitha punët e bujqësisë. Vetë merreshin me drejtimin e ekonomisë dhe vetë shisnin e blinin në Pazar. Gratë e Sofraçanit si të gjithë krahinës shkonin në tregun e Dibërës së Madhe. Ata jo vetëm shikonin nëpër dyqane mallra të rinj, por ata ishin në kontakt me popullatën e zonave të lindjes, me veshje të ndryshme karakteristike për gratë e moshave të ndryshme. Ata blinin mallrat e reja që dilnin nëpër dyqane dhe pasuronin veshjen e tyre. Kështu u zëvendësuan shamitë e pambukut me ato të jepekut, që ishin teknologjia më e përsosur për kohën.

Burrat në emigracion, duke u njohur me shkëmbimin e mallrave në dyqanet e vendeve të zhvilluara sollën prej andej pëlhura, shami, mitana dh elemente të tjerë të veshjeve, që ia përshatën dhe pasuruan veshjen e krahinave tona.

Për shembull, gjalmat e gërshetave që më përpara i punonin vetë gratë, u zëvendësuan me gajtanin e kuq që e blinin të gatshëm në treg. Çorapet filluan të zëvendësohen ato të leshit me çorape të bardha pambuku. Këto jo vetëm kushtonin më pak, por ishin më elegantë. Çorapet e pambukut më vonë u zëvendësuan me ata të najlonit, që ishin më rezistent dhe më estetikë.

Mjafton të përmendim vetëm kujdesin që tregojnë gratë për palosjen e qashës që ajo të qëndrojë drejt pa rrudha, sikur është e hekurosur. Ato, para se të flenë, e vendosin qashën nën dyshek së prapthi, me qëllim që ajo të ruajë formën e duhur. Bukuria e kësaj veshje ka ndikuar edhe në fshatrat e tjerë si në fshatrat Tërnovë, Smollik e Okshun. Veshja e krahinave të Grykës së Madhe dhe të Bulqizës, e njohur me emrin veshja e Grykës së Madhe është marrë si model i veshjes nacionale nga Ansambli Shtetëror të këngëve dhe valleve. Kohët e fundit veshja e rëndë zëvendësohet me veshje të lehtë, më të përshatshme dhe më të lirë për kohën. Ky zëvendësim u bë me ritëm të shpejtë, sidomos te moshat e reja, ndërsa te gratë e moshuara dhe plakat kanë hyrë elemente të ndryshme dhe kanë zëvendësuar pjesë të veçanta të kësaj veshje. Kështu, qasha është zëvendësuar me fustane prej stofi. Këpucët kanë zëvendësuar opingat. Tiret e çorapet kanë zëvendësuar çorapet e gjata.

Mitani i kanë zëvendësuar kostumet prej stofi, trikot e komplet prej lesh deveje.

Nusët dhe vajzat aktualisht vishen me rroba si të qytetit. Janë hequr shamia e kokës. Gërshetat janë zhdukur. Nusët dhe vajzat vijnë me flokë të prera dhe me kostume kohës.

Fillimisht ndikoi edhe mungesa e leshit të deles në kohën e tufëzimit të bagëtitë. Puna në kooperativën bujqësore nuk u linte kohë të lirë vajzave të punonin çorapet, tiret e elemente të tjerë të veshjes që kërkonin punë dore. Tregu u mbush me elemente të veshjes së lehtë dhe nga vetë izolimi i vendit tonë nga bota në treg nuk gjeje më shamia jepeku, mitana jepeku dhe breza Stambolli.

Këto dukuri zëvendësuan veshjen e rëndë të krahinës me veshjen e lehtë qytetare. Sot në Sofraçan edhe në krahinën e Grykës së Madhe është vështirë të hasësh gra me veshjen karakteristike të krahinës.

Një jetë në shërbim të çështjes kombëtare, arkiv i gjallë i historisë së Dibrës, sinonim i inteligjencës dhe urtësisë dibrane

Miftar Cami i Gjoricës

Nga AQIF ADEMI

I de ja për të shkruar për Miftar Camin ka qenë e hershme. Por, ja vjen një ditë, kur me krenari dhe përkushtim të hedh në letër jetën dhe veprimtarinë e intelektualit dhe historianit pasionant, Miftar Cami.

Miftar Cami vjen në mendjen e shqiptarëve si një filozof i mendjes dhe i dijes. Ai është bërë burim frymëzimi për të gjithë ne, për kohën që jetojmë. Duke rrefyer lidhjen në mes të individit të fortë dhe rrethanave psiko-historike, që e nxjerr atë në dukje, në një nga biografitë e tij Cvajgu zbulon një nga anët e panjohura të historisë. Ngjarjet e mëdha dhe të bujshme, ata që u japin drejtim kohëve në udhëkryq fatesh kolektive ndodhin në provincë. Gjithmonë periferitë shndërrohen në arena lufte, që përcaktojnë rrjedhat e historisë së popujve dhe kombeve.

Ndërkohë, burrat me zë të atyre fiseve të shquara kthehen në simbol të identifikimit të rrugëzgjdhjeve në kohë krizash e ndalesash historike. Këto përshtypje na shoqëronin ndërsa gjurmjoa rrjedhat në kohë dhe hapësirë të derës së madhe të Camëve në Gjoricë të Dibrës.

Një derë e madhe fisnikësh të trashëguar nga thellësia e shekujve, të lindur në ato fusha të begata, rrethuar me malet kryelartë, me Kërçinin dhe Stugovën për karshi, të paepur si kreshta legjendare, ku pinjollët e Camëve jetuan dhe luftuan duke u bërë njësh me fatet e atdheut dhe kombit.

Gjorica, vendi ku lindi dhe jeton Miftar Cami, është një fshat piktoresk i vendosur midis ujrave të lumit Drini i Zi dhe Zallit të Okshtunit, fshat me tradita të larta patriotike, historike e kulturore, u bë djepi, panteoni i pavdekësisë në udhëtimin e tyre simbolik drejt lavdisë.

Në këtë fshat janë zhvilluar betejat e Drinit. Lufta kundër pashait turk Hajredin Pasha dhe ushtrisë së tij. Të shkruash për Miftar Camin është përgjegjësi morale, sepse çdo sekuencë e jetës së tij është e mbarsur me ide të fuqishme që i shërbejnë çështjes kombëtare.

Camet kanë qëndruar si Prometej gjatë historisë së tyre. Shaban Cami, Fetë Cami, Mahmut Cami, Ramadan Cami patriotë dhe rilindas kombëtarë. Të gjithë këto trima janë vranë në luftë për mbrojtjen e trojeve dibrane dhe shqiptare kundër pushtuesve turq, serbë, austro-hungarezë, bullgarë, etj.

Eqerem Cami, bashkëluftëtar dhe bashkë-niciator për hapjen e shkollës së patë shqipe në Dibër të Madhe dhe rrethinë. Gjithmonë kanë luftuar në luftërat që kanë bërë dibranët për liri dhe pavarësi kombëtare. Disa prej tyre janë dëshmorë të atdheut si: Ahmet Cami, Ejup Cami, Fasli Cami, Musa Cami.

Origjina e familjes së Miftar Cami është nga fshati Selitë e Matit. Pas vdekjes së Skënderbeut apo diçka më vonë, shpërngulen dhe vendosen në fshatin Zogje të Grykës së Vogël, ku jetuan bashkë me fise të tjera të dëgjua si Markja, Leka, Lleshi, Daci, etj. Në këtë fshat kanë jetuar prijësi i Dibrës, Sali Markja. Gjatë lëvizjeve të mëdha Camet u vendosën në disa fshatra si Gjoricë, Sepetovë, Viçisht, Dibër të Madhe etj. Më vonë emigruan dhe u vendosën deri në SHBA.

Miftar Cami që në fëmijëri u brumos me idealet më të larta të atdhedashurisë dhe patriotizmit. Në mjedisin ku u rrit, ai u brumos me idealet më të larta kombëtare. Ai shquhet për inteligjencë, vizion, largpamësi dhe shumë kërkues në aktivizimin në mbrojtje të interesave kombëtare. Ky filozof popullor, ky arkiv i gjallë i historisë së Dibrës, që rrezaton në përditshmëri kulturë, inteligjencë, kurajo, qëndrësë, pasionin si studiues humanist, aktivist dhe organizator të aktiviteteve me karakter kombëtar, si: në Dibër dhe jashtë në Maqedoni, në trevat ku banojnë shqiptarë, në Strugë, Kërçovë, Tetovë.

Ai është skenarist, konsulent i veprave të ndryshme artistike, prezent në çdo aktivitet me karakter kombëtar që zhvillohen në krahinën e Dibrës, si në Maqellarë, Shupenzë, Peshkopi, Dibër të Madhe. Ai mban në memorjen e tij të gjitha krijimet artistike, sidomos ato për At-dheun, Flamurin, Kombin, që i interpreton me pasion dhe shpirtin e patriotit të palodhur për çështjen kombëtare. Për moshën që ka, Miftari zotëron inteligjencën e konakut të Dibrës. Kushdo që shkon në Gjoricë, qoftë politikan, historian, gazetar, emigrant, mësues, mjek apo njerëz të zakonshëm është e pamundur të mos takojnë Miftar Camin. Ndonëse në moshë, ai ishte në Kërçovë ku u promovua busti i Heroinës së Popullit, Hibe Palikuqi nga Dibra e Madhe, vranë në Shutovë të Kërçovës, gjate Luftës Nacionalçlirimtare. Në shenjë mirënjohje dhe respekti, e ftuan veteranët e luftës së Republikës së Maqedonisë. Miftari ishte konsulent i dokumentarit të promovimit për Heroinën Hibe Palikuqi. Qëndrimi i tij ishte në një nivel shumë të lartë. Atë që nuk e bëjnë politikanët, e bëjnë historianët e pasionuar si Miftar Cami. Në atë ceremoni, zoti Cami foli si europian, në dy gjuhë, me autoritetet e larta të shtetit maqedonas, të cilët kishin ardhur të festonin përvjetorin e fitores se popujve të Evropës kundër pushtuesve nazistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre.

Atë vazhdimisht e motivojnë për t'i evokuar dhe lartuar ngjarjet historike, luftërat që kanë bërë dibranët për pavarësi kombëtare. Kërkon vazhdimisht të eksplorojë nga afër ngjarjen dhe evente historike, si: kalanë e Sfetigradit apo shtëpinë ku ka jetuar babai i udhëheqësit të Turqisë moderne, Qemal Tataturkut, në Koxhaxhik. Merr pjesë vazhdimisht në promovimin e aktiviteteve që zhvillohen në Dibër e Madhe, në Maqedoni, si i ftuar nderi. Ai është vlerësuar me mirënjohje nga organizata e Luftëtarëve të Maqedonisë me qëndër në Dibër.

Miftar Cami është një dibran i dimensioneve të mëdha, me inteligjencën, zgjuarsinë e tij natyrale krijon atmosferë retrospektive historike, humor e seriozitet në të gjitha trevat e Dibrës pa kufi. Ai sot është në pension, por është nga ata burra që janë aktivë përherë dhe moshë nuk i ndalon, por rrezaton shpresë, besim, është kthyer në simbol të etikës, moralit, urtësisë, familjes dhe mençurisë dibrane. Ai, në vetvete është "institucion", se mbarit Universitetin e Dibrës, mendon mirë kur hyn dhe kur del. Një pjesë së jetës së tij e ka kaluar duke punuar si topograf në minierën e kromit në Bulqizë.

Miftar Cami, në një periudhë kohe të vështirë, në kohën e acarimit dhe të prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë e Titos, në rrethana shumë të vështira ka dhënë provën e tij morale, fizike dhe shpirtërore për interesat



më të larta të kombit, duke i thënë vdekjes "Ja ku jam!" dhe interesat dhe qëllimet e jetës kurrë nuk i tradhtoi. Kështu e kanë edukuar familja dhe të parët e tij: të rrezikosh jetën duke u ballafaquar me serbët agresorë nuk ka qenë aspak e lehtë, është me shumë se patriotizëm dhe sidomos kur sakrificën e lypin interesat më të larta kombëtare. Edhe pse gjithmonë ka qenë i rrethuar nga merimangat helmuese që dilnin natën nën dritën e hënës së zbehtë, duke vendosur shpesh herë jetën e tij në rrezik.

- E rëndësishme është të punosh për familjen, atdheun kombin, - thekson Miftari.

Të tillë e kam njohur, në këto rrethana e kam vlerësuar dhe jam i sigurt se shpreh konsideratën e dibranëve që flasin me simpati për këtë aktivist të çështjes kombëtare në të gjitha hapësirat dibrane kudo që jetojnë. Jeta dhe puna e tij shërbejnë si shembull frymëzimi për brezat e sotshëm dhe ata që do të vijnë më pas. Ai jeton në fshatin e tij të lindjes, në Gjoricë. Me kënaqësinë që i jep emri kryefamiljar e bashkëshort shembullor, prind i mirë i djemve dhe vajzave të tij, me kënaqësinë që të jep emri gjysh i mirë i nipërve dhe mbesave që e duan që shumë, që i do aq shumë, që shohin në portretin e tij njeriun në lartësinë më të madhe. Ai mbarë në vetvete të gjitha virtytet më të larta që i takojnë një njeriu, që ka luftuar për të jetuar vazhdimisht në pavdekësi me veprën që lë pas.

Le të jetë ky një shkrim modest një përforcim i kujtesës së dibranëve dhe pse jo, i të gjithë shqiptarëve se kush është Miftar Cami, ky dibran i madh i Gjoricës në Dibër, që me inteligjencën e tij, aktivitetet e tij patriotike që ka zhvilluar, ka ditur të gërshetojë interesat e tij personale me ato kombëtare. Të gjithë e vlerësojnë dhe e respektojnë si njeri me

Miftar Cami fjalën dhe besën e respekton. Kodi i tij moral: dashuri, mirëkuptim, dije, kulturë, përparim, edukim shpirtëror.

Komunikues me të gjitha moshat, armik i kompromisit, armik i hipokrizisë, syçelë e vigjilent, i buzëqeshur me miqtë, strateg në ide, me një kulturë universale për t'u admiruar dhe përkushtim maksimal për familjen dhe kombin.

vlera të larta. Nderohet nga bashkëshatarët e tij Parimet morale të Miftar Camit rrezatojnë vlera në hapësirat dibrane. Ai është sinonim i një misionari të spikatur, diplomat elegant i çështjes kombëtare. Një parim moral i tij me shumë vlerë që është prezantur gjatë gjithë jetës së tij është dashuria e madhe për vendlindjen, Dibërën e tij të dashur. Pengu i tij vazhdon të jetë ndarja e Dibrës në dy pjesë. Ai shpesh thotë: Po nuk u bashkuam, nuk më kalb as toka!

Miftar Cami fjalën dhe besën e respekton. Në vazhdim të kodit të tij moral, detyrave tij për kohën që jetojmë është shumë e qartë: dashuri, mirëkuptim, dije, kulturë, përparim, edukim shpirtëror. Mbjell farën e tolerancës dhe mirëbesimit. Ai ngelet në histori si intelektual i mendimit të qytetëruar, që nuk mposhtet nga dallgët e jetës, përdor fjalën e bukur si armë dhe respektimin e të drejtave njerëzore. Këmba e tij ka shkelur çdo hapësirë dibrane, duke qenë pjesëmarrës në të gjitha eventimet historike që ka kaluar e kalon treva e Dibrës pa kufi.

Për kohën që po jeton është optimist, pa asnjë ngjyrë pesimizmi dhe ngadalësie. Energjik në veprime, konciz në mendime, guximtar në iniciativë. Burrë i vendosur, me gen të dëgjuar, orator në të folur.

Në komunikim me njerëzit mbretëron arsyeja dhe logjika. Komunikues me të gjitha moshat, armik i kompromisit, armik i hipokrizisë, syçelë e vigjilent, i buzëqeshur me miqtë, strateg në ide, me një kulturë universale për t'u admiruar dhe përkushtim maksimal për familjen dhe kombin. Me Miftar Camin krenohet familja, Gjorica, Dibra pa kufi. Ai ngelet shembull i një personalitet për misionin e kryer: i shërbeu kulturës, zakoneve, traditave dhe është shembull frymëzimi për të gjithë.

Patriotët e Grykës së Vogël dhe lufta për hapjen e shkollës shqipe në Gjoricë

(vijon nga faqja 19)

Të shumtë janë familjet gjoricare që i kanë bërë një shërbim të çmuar arsimit siç janë ajo e Kurt Camit e Uke Camit në Viçisht, Haxhi Skënderit, Bajram e Miftar Camit, Sinan Lleshit, Jahe Dacit, Hajdar Shehut, Ramadan Merës(Gjoricë), Adraman Gjurës e Hysen Lilës(Çerenec), etj. Ato kanë 2 deri në 3 breza që fëmijët e tyre kanë kontribuar e vazhdojnë të punojnë në shkollat e Gjoricës e deri në Tiranë. Shembullin e tyre po e ndjekin familjet e reja si ato të Shukri Hajdarit, Shehat Lleshit, Fatos Muhos, Emin Ruçit, etj. duke ua trashëguar edhe fëmijëve të tyre profesionin e bukur e të nderuar të mësuesit.

Shkolla është pasuri kombëtare, Mësuesi vlera më e madhe e kësaj pasurie. Populli e ka dashur e respektuar mësuesin. Gjorica ka zgjedhur 3 mësues deputetë, Bukurije Lleshin, Tefta Camin e Moisi Camin, Gjorica ka 18 mësues të nderuar si qytetar nderi të

Komunës. Një mësuese për 10 vjet ishte ministre Arsimit 1976-1986 Tefta Cami. Tre shkolla nga zona e Gjoricës kanë emra mësuesish, si ajo e Çerenecit (Zenep Gjata), e Viçishtit (Fasli Cami) dhe e Gjoricës së Poshtëme (Haxhi Ademi), duke i përjetësuar ato e duke i bërë njëkohësisht të pavdekshëm.

Këto tregojnë vlerësimet, respekt, dinjitet e kulturë nga popullidhe strukturat zgjedhore të Gjoricës për punën e mësuesit, një shembull domethënës në Qarkun e Dibrës por mund të themi edhe në shkallë vendi. Kjo eksperiencë shumë e mirë dëshmon se Gjorica është arsimdashëse. Ajo ka pritur e përcjellë me gjenerata mësues nga gjithë Shqipëria. Ato gjetën në Gjoricë jo vetëm mikpritjen e bujarinë e popullit, por krijuan shoqëri e miqësi që vazhdon të ruhet edhe sot në gjeneratat e reja (brezat e rinj).

Në 90 vjetorin e saj shkolla e Gjoricës prezantohet me një kolektiv të ri me arsim profesional të kualifikuar dhe të apasionuar

për profesionin e mësuesit, të angazhuar me të gjitha energjitë në funksion të edukimit të brezit të ri.

Urojmë që si gjithnjë, shkolla e Gjoricës të jetë pararojë e shkollave të Grykës së Vogël, pse jo e Bashkisë Bulqizë dhe Qarkut të Dibrës.

Gjoricë më 20 nëntor 2015

1. Kristo Frashëri "Historia e Dibrës" faqe 215
2. Konsulli austriak August Kral Fondi Arkivi i Vjenës D12 F6, 1902
3. Arkivi i Shtetit Fondi Jashar Erebara 1/30.
4. Gazeta Pellazgu, 15 mars 1907
5. Haki Stërmilli "Dibra në prag të historisë". Tiranë 1940 faqe 43
6. Gazeta "Liria" e Selanikut 8 gusht 1909
7. Moisi Kamberi "Dibra në periudhën e Rilindjes Kombëtare" faqe 184 Tiranë 2012
8. Haki Stërmilli "Dibra në prag të historisë" faqe 66 Tiranë 1940.

tregim

Sa e zorshme të jesh i ndershëm...

Nga AHMET KAMBERI

Ishte viti 1995. Tre vetë pinin rregullisht kafe te Klubi i Peladhisë, të martën e të premten, në një orë të caktuar të mëngjesit. Në të vërtetë klubi ishte i Ymerit, në rrethruallin e Qendrës Spitalore "Nënë Tereza" Tiranë. Por meqenëse të tre ata: Saliu, Osmani dhe Agimi ishin peladhias, filluan ta quajnë tavolinën ku ata pinin kafënë "Klubi i Peladhisë". Ky, afërmendsh, ishte një klub lëvizës, sepse tavolina e tyre nuk mund të ishte gjithnjë e njëjta. Nuk shkoi shumë gjatë dhe klubit i doli emri. Meqenëse njëri nga anëtarët themelues ishte mjek, Klubin filluan ta vizitonin hallexhinj të ndryshëm, shokë e miq. Çudia ishte se, sipas një rregulli të pandryshueshëm të klubit, vizitorët nuk kishin të drejtë të paguanin; përjashtim bëhej vetëm për ndonjë peladhias të vjetër.

Disa ndjeheshin keq, por shumica e lavdëronte pa zë këtë soj rregulli. E keja ishte se Klubi ishte shumë lokalist. Nuk pranoheshin anëtarë të rinj, po të mos ishin nga Peladhia. Meqenëse, të tillë ishin vetëm me raste, Klubi mbeti vetëm me tre anëtarë. Kushdo tjetër që ulej aty, konsiderohej vizitor i nderuar. Ata e shfrytëzonin atë copëherë që mbledheshin, për të qarë hallet e veta, por edhe për t'u shtensionuar. Ai që, si rregull, sillte argumente të shumëllojshme për të diskutuar ose debatuar ishte Osmani. Ky, si më i moshuari që ishte, gëzonte edhe titullin Kryeplaku i Peladhisë dhe respektohej si i tillë.

Një ditë biseda u soll rreth një historie të padëgjuar të Osmanit. Ky na kishte shkuar një ditë më parë të merre pensionin dhe, kur vajti në shtëpi, kishte vënë re se i kishin dhënë më shumë para se ç'ishte pensioni i tij mujor. Kishte marrë rrugën i shkreti Osman, në atë pikë vape, se ishte fundi i korrikut, e drejt te shpërndarësi i pensioneve, që e bënte këtë punë në një barakë të improvizuar me dërrasa, ku të zihet fryma dhe i kishte thënë nëpunësit që shpërndante pensionet:

- Zotni, më duket se, gabimisht, më keni dhënë më shumë para se ç'më takojnë, - me të folmen e tij të butë, e cila e karakterizonte. Nëpunësi kishte ngritur kokën, i kishte hedhur një vështrim dyshues njeriut që po i dukej se donte ta poshtëronte dhe i përgjigjet pa e zgjatur:

- Po, pse? Ç'më kujton ti mua, mor gjysh? Mos po të dukem se paskam filluar të numëroj para dje, a si?

I trullosur, nga kjo përgjigje, Osmani

kishte nisur të justifikoj:

- Jo mor burrë, unë vërtetë nuk i numërova hollësisht, por me thënë të drejtën, m'u dukën më shumë se ç'marr përherë dhe nuk kam dëgjuar të na jetë rritur pensioni.

- Shko or xhaje, mos hash ndonjë pikë dielli kot, në këtë pisk vape, - ia kishte prerë me pezmë nëpunësi, numëruesi i pagabueshëm i parave, me damarë që i rrihnin në tëmtha, i skuqur e i mbuluar në djersë.

Çap - çup, çap - çup, i ngrati Osman, drejt e në shtëpi. Ulet edhe njëherë e i numëron përsëri paratë. Merr një cope letër dhe i shënon. Bën edhe ndarjen, sa mendonte se i takonin e sa ishte shuma e përgjithshme që kishte marrë. "Po ky pispuruqi më ka dhënë dyfishin e asaj që më takon, xhanëm, -tha me vete, i nxehur Osmani. "Ç't'i thuash kësaj?" Dhe hop e në këmbë. Përsëri merr rrugën, në piskun e vapës, e drejt e te numëruesi i pagabueshëm i parave.

- Or xhaje, mos të ka hyrë zekthi? - i a preu, i pagabueshmi numërues i parave, sa e pa Osmanin tek ia kishte behur në sportel.

- Jo mor zotni, ia kishte kthyer Osmani, nuk më ka hyrë zekthi, se përndryshe do të kisha marrë rrugët e Tiranës me vrap, porti më ke dhënë dyfishin e parave që më takojnë. Ja ku e ke edhe letërën ku kam bërë hesapin. Dhe i zgjat letërën ku kishte bërë llogarinë.

- Or xhaje! Po si ta thotë mendja vallë, se unë që e bëj këtë punë ka 10 vjet, nuk ditkam të bëj llogari dhe duhet të vish ti e të ma mësosh? Shko or burri i dheut e më lër rehat tani në hallet e mia, se nuk kam më nerva të të duroj. Janë gjithë këtë njerëz që po presin.

Ishte matur Osmani t'i kthente një përgjigje, nga ato të vetat, por kishte mbetur në mëdyshje. Ndërkohë, njëri nga pensionistët që priste edhe ai, i skuqur në fytyrë dhe i mbuluar nga djersa, i ishte drejtuar Osmanit:

- Mor burrë, a je i marrë a si? Ai, po të thotë se nuk është fillestar në këtë punë. Pash Zotin, Dreqin, a çfarë të duash ti, na lër të mbarojmë punë se po na bie të fiktë.

Dhe, Osman Kalë Peladhia, pa e bërë dysh, bishtin ndër shalë, e për te Vera. Rrugës na i thotë mendja të kthehej te Sali Sulejman Peladhia.

- Hajde dalim të të jap një birrë, -i thotë Saliu. Pas shumë kundërshtimesh, siç e kishte zakon ai, Saliu më në fund kishte pranuar ta lagte fytyrën me një birrë, me ç'rast ishte vënë në dijeni të ngjarjes, paksa të çuditshme; madje, të pabesueshme, po të

mos e dëgjoje nga goja e një njeriu të pazot të shtrembëronte qoftë edhe një fjalë të vetme, siç ishte Osmani.

Të nesërmen, ishte ditë e premtë, dita e Klubit. Osmani dukej ende i turbulluar.

- Ç'ke Osman, -i thotë Agimi, -sikur s'po më dukesh fort në qejf sot.

- Çfarë qejfi o burrë. Ja ta thotë ky tjetri, se ç'më ndodhi dje, se ia kallëzova krejt.

- Po, pse ky tjetri dhe jo ti vetë, zoti Osman?

Fjala zotëri, e pezmatonte shumë Osmanin, por Agimi që ia dinte këtë dobësi, nuk hiqte dorë nga kjo mënyrë drejtimi. Ajo provokonte gjithnjë diskutime, që përfundonin pa marrëveshje.

- Më qafsh, Agim, mos më thuaj më zotëri, ia ktheu Osmani me të lutur. Ta kam thënë njëmijë herë se kjo nuk më pëlqen.

- Po edhe unë ta kam përsëritur njëmijë herë, se zotëri, nuk do të thotë medoemos se je i pasur, ose ke ndonjë pozitë. Zotëri është cilido në hesapin e vet. A themi ne "çdo berr varet për këmbës së vet?" Ty, të vjen më mirë të të drejtohen: xhajë, xhaxha, gjysh a plak, në vend që të drejtohen me "zotëri a zotni", si të duash ti? -vazhdoi Agimi, -unë me "zotëri" i drejtohem gjithkujt, që prej një lypësi në rrugë e deri te Presidenti, të gjithë janë njerëz si unë e ti, gjithsecili është zot i vetvetes. Prandaj, më mirë mos u lodh të ma ndërrosh mendjen, se unë kështu do të të drejtohem gjithmonë. Dhe ta dish se me këtë të nderoj, nuk të përqesh. Po, ta quajmë të mbyllur këtë muhabet dhe të kthehemi te ajo që të paska ndodhur dje, e të paska lënë pa gjumë.

Ç'të bënte Osmani! Ai i donte shumë të dy klubsat tjerë. Ia nisi nga e para dhe e tregoi ngjarjen fije për pe, ndërkohë që Saliu, i cili e kishte dëgjuar atë një ditë më parë, vinte buzën në gaz herë pas here. Pasi e torën këtë ngjarje këtej e andej në formë shakaje, Agimi u përpoq ta qetësonte Osmanin, të cilit, qartazi, nuk i ishte hequr mërzia dhe pas disa shakash se ç'do t'i ndodhte kur të shkoste herën tjetër për të marrë pensionin, i tha:

- Mos e vra mendjen kaq shumë mor zoti Osman. Ato paratë e tepërta që ke marrë, mos i prish duke i dhënë birrë Saliut, po ruaji t'i kesh, se kushedi, mund të duhen. Po, shko e jepi një gjumë të mirë sonte se do t'ia gesh zgjidhjen kësaj pune.

Në këtë pike u mbyll muhabeti, se Agimi kishte për të marrë një grup studentësh në provim dhe secili shkoi në rrugë të vet.

Erdhi muaji tjetër dhe Osmani, zduq -

zduq e te baraka e pensioneve. Me ta parë në sportel, "numëruesi i pagabueshëm i parave", më t'i përmbledhësi skifteri pulës:

- Erdhe ti, mor plak bataçqi, do pensionin hë? Kujtove ti se do të na e hidhje? Po unë e mbaj mend shumë mirë që ty të kam dhënë dyfishin e pensionit muajin që shkoi. Unë jam specialist dhe s'mund të ma hedhin "rafinatot" e jo më një dokushdo si puna jote. Dhe, i pakënaqur se nuk e kishte shkrehur gjithë dufin, kishte vazhduar:

- Njeriu edhe kur gjen 1 lek në rrugë, përpiqet të gjejë se kujt i ka rënë dhe vrapon t'ia japë. Kurse ti, që na u hjekërke edhe si burrë serioz, more një pension mujor tepër dhe nuk të shkoi mendja se kjo do zbulohet brenda ditës, kur të numëroheshin paratë e dhëna. Dhe kishte përfunduar:

- Hajt! Firmos këtu që e more pensionin dhe thembrat nga majat.

Kjo e kishte tërbuar Osmanin dhe po mendohej si t'i përgjigjej këtij nëpunësi të pacipë. Ndërkohë, dy pensionistë që prisnin radhën, të cilët kishin qëlluar dhe në skenën e muajit të kaluar, thuajse me një gojë i kishin bërë titur këtij palo nëpunësi, që për të mbuluar dobësinë e tij po shfrynte si rrugaç:

- Si s'ke turp more! Po ne kemi qenë këtu, kur zotëria erdhi e të tha se i kishte dhënë para tepër. Porti e përzure si të ishte i metë.

Ndërkohë, Osmani kishte firmosur dokumentin dhe e kishte mbledhur pak veten. Kishte lënë penën dhe i ishte përmbledhur "specialistit", "numëruesit të pagabueshëm të parave":

- More pizeveng! Të mos më vijë turp prej këtyre burrave e grave që janë këtu e presin, t'i fus gërthecat në fyt e ti qis sytë si pordhë, -duke e theksuar fort këtë të fundit, -po faliu këtyre...Dhe ishte ndjerë i çliruar.

Osmani, vërtet ishte i moshuar, por kishte një trup aq të fuqishëm, sa nuk e kishte fare për gjë të bënte atë që i kishte thënë atij ditëzui, por më të fortë se fuqinë fizike ai kishte fuqinë e vetëpërmbytjes. Kishte dalë i lehtësuar nga baraka prej dërrase e shpërndarjes së pensioneve dhe kishte marrë fluturimthi rrugën për te Saliu, i ngazëlluar pa masë se kishte firmosur për pensionin që, për faj të një nëpunësi të paaftë, e kishte marrë "paradhënie" një muaj më parë.

I miri Osman, nuk kishte arritur ende të merre vesh, se kishte ardhur një kohë ku ndershmëria cilësohej si ves.

Tiranë, më 13.12.2015

Promovohet libri JEHONA E SHPIRTIT

Këto dite në një nga sallat e Muzeut Historik Kombëtar u promovua libri Jehona e shpirtit i poetit nga Zall-Dardha Përparim Luca me redaktor Iلمي Dervishi. Dashamirës të poezisë, poetë e gazetarë, studiues dhe familjarë ndoqën me interes e vëmendje diskutimet rreth librit të parë të autorit dikur shumë aktiv tani me aftësi të kufizuara.. Moderatorin Faik Khani, studiues dhe shkrimtar, ja jep fjalën prof. Gëzim Bara, një herësh dhe kontribues financiar i librit. Në diskutimin e tij shumë serioz Ramadan Topuzi foli për detajet në vlerat e librit. Mbresëlënëse ishte fjala e z. Elmas Lala, poetes Lindita Penga ardhur posaçërisht nga Lezha, Poetja Adivije Hoxha njëherësh organizatore dhe kryetare e shoqatës Para dhe tetraplegjikëve, dega Durrës. Petrit Tollja. krahas librit bëri dhe një falënderim publik që pa asnjë lloj pagese ju siguroi një karrocë invalidi të cila i mungonte. Me duartkrokite dhe entuziazëm

u prit përshëndetja e Lirie Rashës, artiste e merituar, drejtuar të pranishmëve dhe autorit e cila u lexua në sallë. Të bukura e me emocion ishin recitimet nga Dodona Qose, aktori Baram Torba si dhe dy vogëlushet, mbesat e autorit Anjeza Xhediku, e cila ishte shkëputur nga puna vetëm për këtë eveniment po kërkonte me ngulm të merre një autograf autorit. E kam patur mësues në shkollën fillore thotë e entuziazmuar, tani që vet ajo po mbron gradë shkencore për master. Poeti vlonjat Ilir Balili, ish kuadër disa vite në Dibër sollti emocione në fjalën e tij për librin dhe për vet autorin. Në fjalën e tij përshëndetëse të autorit, ndonëse me emocion përcollti te të gjithë emocione dhe mirënjohje për të pranishmit, për diskutimet dhe organizimin. Të pranishmit u ftuan për një kafe te bar-restorant "Ulqini" nga i vëllai dhe daja i autorit.

I. Dervishi



Prologu i romanit të ri të Agron Tufës, "Gurit të varrit ia rrëfej", botuar nga shtëpia botuese "Onufri"

Nga **AGRON TUFA**

Një pasdite maji të vitit që shkoi, rastisi të kaloja ndanë Parkut Rinia, përballë godinës së ish-Ministrit të Mbrojtjes. Një stuhë e shkurtër me rrebeshe shirash të dendur e kishte pastruar ajrin; asfaltet dhe trotualet e lara pasqyronin, si të bojatisura nën përshkënditjen e diellit, ca reflekse rozë në manushqë, sa të bëhej se po shkelje mbi bojëra ende të pathara.

Ndërsa çapitesha prajshëm trotuarit, ngjitur me bordurat e Parkut, më tërhoqën vëmendjen thirrjet e herëherëshme e monotone të dy djelmohave romë, të cilët, sapo afrohej ndonjë kalimtar, përsërisnin me radhë të njëjtën thirrje:

- Hajde lal, mall i mirë, mall i lirë...! Mall i mirë, mall i lirë...

Ndalova hapat dhe pashë se, mbi sipërfaqen e bordurës, në një gjatësi kund 5 a 6 metra, mbi një shtresë të tejudkshme plastmasi, qenë radhitur libra të vjetër gjithëfarësh. Edhe pa thirrjen e dy adoleshentëve romë, nisur nga shprehja ime e vjetër, do të kisha ndaluar, me siguri, të buburroja ndër ata tituj, edhe pse ka kohë që gjithë e më fort zhgënjehem nga librat e rastësishëm në rrugë.

Djaloshi romë nxitoi të më ndihmonte, duke më afruar herë pas here libra të trashë, që i mbante brenda ca kutive prej kartoni.

- Mos i nxirr një nga një, - i thashë, - nxirri të gjithë, shtriji në bordurë, se i shoh vetë.

- Pa shitur këta këtu, - arsyetoi ai që duhej të ishte më i madh, - nuk e nxjerrim mallin tjetër, se na prishet.

Tunda kokën dhe isha në të larguar, pasi kisha ndarë një Flober të veçantë ("Zonja Bovari" me përkthimin në gegnisht të Zekrija Rexhës) dhe, për nostalgji të fëmijërisë, "Legjenda dhe aventurat e Ulenshpigelit dhe të Lame Gudzakut" të Charl De Koster. Ndërsa po paguaja, pa u hëngër në pazar, djaloshi romë bëri një propozim të papritur:

- Po deshe ti, xhaxh, i hap të tre kutitë, ene shih... masanej i fus prapë në kuti unë. Si thua, t'i hap?

- Hapi... Po shpejt ama! - i thashë.

Të dy djemtë i radhitën librat në bordurë, duke u përpjekur të më vinin në dukje disa vëllime të një enciklopedie ruse. Por unë vazhdova të bredh me sy kopertinat, përgjithësisht tituj të njohur të letërsisë klasike, romane të vdekur socrealistë, disa fjalorë dygjuhësh, derisa u ndala para një libri me kopertinë të butë, të zezë, pa titull, duke menduar se titullin mund ta gjeja në faqet e brendshme. Vetëm pas shfletimit të dy faqeve bosh, ndesha në një shkrim të imët dore, të qartë e të kujdesshëm, disi të pjerrët. Mendova se mund të quë ditar dhe shfletova disa fletë të tjera. Nuk ndesha ndonjë datë. Ndonjë përkthim ndoshta...? Gjykoar nga dy a tre emra shqiptarë, ra dhe kjo gjasë. Nuk po e kuptoja natyrën e atij shkrimi me dorë, andaj, që të mos tërhiqja vëmendjen e djelmohave romë, e mbylla atë bllok të trashë shënimesh në trajtë libri dhe i pyeta:

- Sa ma jepni këtë?

- Një pesëmijëshe të vjetër merre, - foli shpërfillshëm flokëqethuri, që duhej të quë shefi i asaj dysheje adoleshentësh.

la zgjata këtij pesëmijëshen dhe e pyeta se nga i kishin marrë këta libra... dhe shtova:

- Unë i njoh prej shumë vitesh të gjithë bukinistët dhe shitësit e librave të Tiranës, por ju nuk ju kam ndeshur asnjëherë, - ndërkohë që po i bëja vend me vështirësi bllokut të zi në çantën time të krahut.

- E, më xhaxh... ashtu thue... por ene ata që njëfi ti, a e kanë pasë një ditë të parë? Kshu pra mo... ene na e kena nis isoj si ata, ditën e parë... e me kismet... - e la pa mbaruar ai fjalinë.

la bëra me dorë të avitej më afër dhe i thashë, me zë të ulët, siç thuhet rëndom sekretet:

- Nuk të pyeta kot se ku i keni marrë librat! Po t'i shohësh, të gjithë librat kanë në faqen



ISBN: 978-9928-186-85-0

254 faqe

Çmimi: 800 lekë

gurit të varrit ia rrëfej

3 dhe 17 vullën *Biblioteka personale T&L Mërtiri*. Shih... shih! E kjo do të thotë se të gjithë këta libra që po shisni ju, janë pjesë e një biblioteke familjare. Kush jua ka dhënë? - e pyeta ngulmueshëm, duke peshuar me këmbë mbi bordurë.

Djaloshi uli sytë dhe duke mermëritur, teksa mblidhte librat e nxjerrë nga kutitë, tha:

- Vallahi ne na i ka dhonë njeni t'i shesim dhe fitimin duhet ta ndajmë me të fiti-fiti... ma shumë nuk di unë.

Kur po largohesha, dëgjova të më thotë në mënyrë lutëse:

- Paj zotin, xhaxho, mos na denanco! E kena bukë goje na... Ça me bo?!...

Ditët në vazhdim më rrembeu leximi i atyre shënimeve. Ato përcillnin të vërteta të hidhura, të shkruara nën presionin e një tronditjeje të madhe, në formën e një rrëfimi që i drejtohej një njeriu të shtrenjtë, i cili, me sa duket, paskësh vdekur në një aksident rrugor. Rrëfimi në thelb, është një dialog i gjatë i një femre me një të vdekur në aksident, të cilit ajo i rrëfen të fshehtat që ka propozur në shpirtin e vet dhe, njëkohësisht, ky rrëfim është edhe përpjekja e kësaj femre (në këto shënime ajo e quan veten Lirika Mërtiri), për t'i shpjeguar të vdekurit pse ajo e pati të pamundur t'i përgjigjej dashurisë së tij, pse ajo e konsideronte veten të padenjë për të.

Në fillim pata menduar se, nëse autorja e panjohur e këtij dorëshkrimi është gjallë dhe banon në qytetin tonë (gjykoar nga disa reale dhe koordinata të qarta kohe e vendi), unë duhet të bëja çmos ta gjeja dhe t'ia ktheja bllokun e zi, duke qenë i vetëdijshëm për natyrën thellësisht intime e private për më tepër, të një shkrimi femëror. Dhe, kuptohet, nisur nga indiciet e dorëshkrimit, kërkimin e lokalizova në terrenin e mediave, për sa autorja e panjohur vetë na dëshmon se është gazetare; se formimi i saj është i tjetërsojtë; se puna e gazetares nuk i pëlqen dhe se këtë punë e sheh si të përkohshme.

Për fat të keq, asnjë prej miqve e mikeshave të mia që ka punuar në media në të njëjtën kohë kur del se ka punuar Lirika Mërtiri (ndryshe dhe autorja e dorëshkrimit), nuk e kujton një kolege me emër të tillë,

sado që e detajzova përshkrimin, me aq sa të japin dorë shënimeve e saj.

Kur përpjekjet e mia nuk dhanë rezultat, u detyrova, jo pa dhimbje, të humbisja disa orë për ditë të tëra mbi koleksionet vjetore të gazetave të përditshme, herë në Bibliotekën Kombëtare, herë në Institutin e Medias. Madje pata përshtypjen se disa herë iu afrova pothuaj fare afër. Them *pothuaj*, sepse midis viteve 1994-2001, kohë gjatë së cilës unë kam qenë me studime jashtë shtetit, ndesha 11 herë nënshkrimin, me trajtën gjysmake të autorësisë - *L. Mërtiri*, poshtë shkrimesh të ndryshme (kronika kulturore, intervista e dosierë). Në vjeshtën e vitit të vështirë 1997, kur autorja e shënimeve (vetëm nëse emri i saj i dorëshkrimit nuk është trillim), del se është kthyer nga Amerika ku ka qenë pjesë e një delegacioni me gazetarë, kemi një reportazh për bashkatdhetarët tanë emigrantë atje, të nënshkruar me inicialet L.M.

Përgjatë një viti nuk arrita dot ta gjeja autoren e këtyre shënimeve. Vetë shënimeve shtrihen papërcaktueshëm deri në vitet e para pas mileniumit, por se në cilin vit janë shkruar këto shënime, kësaj nuk ia qëllon dot, ngase autorja nuk ka shënuar diku asnjë datë viti.

Pata dhe një shpresë të shkurtër kur një i njohur im i hershëm i medias, duke ditur për kërkimet e mia, më mori rreth një muaj më parë në telefon dhe shpalli triumfalisht, jo pa krekosje:

- Eureka, or burrrë! Eureka!

- Çfarë ke gjetur? - e pyeta.

- Bash atë gazetaren e humbur, Lirika Mërtiri, që zotrore e kërkoni në qiell e ajo është hiç më pak se mësuesja e djalit tim në gjimnaz! - shpalli ai, pa e prishur tonin triumfues. - Po të duash, shkojmë nesër dhe e takojmë.

- Patjetër, të lutem...! - i thashë, - po çfarë moshe është?

- Dikund tek të tridhjetë e pestat më duket... një alamet biondine!

- Shkojmë, - i thashë dhe lamë vendin e takimit qysh në 7:30.

Vetë ai, para se të fillonte mësimi, ma nxori mësuesen në sallonin e gjerë katror

të shkollës.

- Ju njoh, zotëri, ju njoh, - tha ajo, ende pa u afruar, gjithë duke përtpur lehtë diçka të papërcaktueshme, - nuk është nevoja të prezantoheni, z. Tufa.

- Më bëhet qejfi, - i thashë, pa ia hequr sytë fytyrës së saj me një të kuqe si të irrituar.

- Punojmë me tekstin tuaj, - tha dhe shtoi: - na e morë shpirtin!

- Pse? - thashë, duke shkrëbyer habinë.

- Është shumë i vështirë për nxënësit... duke qenë pedagog, ju e keni matur shënjestrën për studentët... por niveli i gjimnazistëve... ju e dini... Besoj se për këtë keni ardhur.

- Epo...

- Dëgjoni, - më ndërpreu ajo, - teksti është shumë i mirë dhe, që ta dish, - uli zërin ajo, - me të përgatiten të gjithë mësuesit anembanë Shqipërisë... por ama, nxënësvë u japin një tekst alternativ tjetër, më të thjeshtë. Teksti juaj është pak i rëndë dhe të rëndë e bën aparati i papunuar mirë nga ana didaktike... Unë tani nuk kam kohë, se fillojmë mësimin. Por do të hartoj një pasqyrë me vërejtje dhe, nëse vini pas orës së pestë...

- Vij, patjetër, - shpreha gatishmërinë.

- Ah, jo, jo... - sot nuk bëhet, - reflektoi ajo, duke kontrolluar në ekranin e celularit të vet. - Kam ditëlindjen e babit sot...

- Babai juaj... Trajan Mërtiri... është gjallë!

- Mbush 87 vjeç babushi im sot... po për emrin gaboheni: e ka Xhevdet e jo Trajan.

- A ka qenë yt atë dy herë i dënua politikisht në burg... më saktë, i ridënua? Me sa di unë, atë e pushkatuan... Nuk është kështu?

- O, jo, jo... më duket se e ngatëroni. Nejsë... ia kam pak a shumë idenë me kë e ngatëroni... Por jo! Ai është ndër dy-tre veteranët ende të gjallë të Luftës Antifashiste në krejt lagjen tonë... si mund të ishte në burg një komunist i orëve të para?

- Ashtu? - thashë i çmeritur dhe me një shpresë të fundit, e pyeta zëpakë: - Emrin tuaj e kam ndeshur në artikuj të shumtë në shtyp... kur e keni lënë gazetarinë?

- Unë gazetare?! Qyqja! Jo mo vlla... asnjëherë nuk kam punuar gazetare unë... Shih mos më ngatëron me ndonjë tjetër.

- Me sa duket, - thashë zëshuar. - Epo, po vij ndonjë ditë tjetër, - shtova, duke i zgjatur dorën.

- Kur të duash, - tha, - ndërkohë vërejtjet do t'i kem bërë gati.

Ika i zhgënjyer krejt dhe as që kisha ndërmend të kthehesha më aty për vërejtjet e saj.

Duke mos gjetur mundësi tjetër e duke pasur një shpresë, jo pa baza tashmë, se autorja reale e këtyre shënimeve e ka fshehur emrin e saj të vërtetë pas një emri tjetër dhe, meqë kërkimet tona në media nuk e ndeshën asnjëherë emrin Lirika, vendosa ta botoj dorëshkrimin.

Në tekstin e shënimeve të dorëshkrimit nuk kam vënë dorë, përveç një epigrafi në hyrje, që m'u duk në funksion të rrëfimit. Mandej, rrëfimin vetëm sa e organizova në kapituj, e ndava në dy pjesë, ku në pjesën e parë lashë rrëfimin e saj, që i drejtohet të vetmit person të mundshëm, Arsenios së vdekur, ndërsa në pjesën e dytë lashë rrëfimin e Rita O., një divë e këngës së lehtë shqiptare, fatin e saj që kalon përmes një kalvari dhune e poshtërimi. Edhe këto zhvendosje i bëra në të mirë të *rrjedhshmërisë* dhe *unitetit* të rrëfimit, ku të përftoheshin dy linja kompakte të rrëfimit për fatet e dy femrave, krejt përkundër me shënimeve e autores anonime, që i përzien vazhdimisht ato në digresione të pëshqjelluara, çka do ta bënin konfuz e të vështirë leximin.

E fundit ndërhyrje ka qenë titulli. Mbete në dilemë për shumë kohë. Kisha shënuar në një fletë disa tituj provizorë, si "Aksidenti", "Skifterët me kobure", "Cisternat e zeza", madje dhe "Blloku i zi", por e gjykova më me vend të ruaja atë që nënvizohet shpesh në rrëfimin e dy femrave protagoniste (e që unë në tekst e kam veçuar me kursiv), pamundësinë për t'ia rrëfyer njeriu të gjallë përvojën dhe kumtin e tyre tronditës, përpos se *gurit të varrit*.